



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 2 dhe 3 QERSHOR 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA ODRŽANE
2. i 3. JUNA 2008. GODINE**

**Qershor – Juni
2008**

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtur më 16, 20 dhe 21 maj 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punën,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbartuese,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2007,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit,
9. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e Trasesë për ndërtimin e Autoudhës Morinë -Merdar dhe Prishtinë – Hani i Elezit si zonë me interes të veçantë publik në Kosovë,
10. Shqyrtimi i propozimit për nxjerrjen e një deklarate kundër shpifjeve të Carla del Ponte.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica održanih 16, 20. i 21. maja 2008. godine,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o radu,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o službenim statistikama,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izvršnom postupku,
6. Razmatranje finansijskog Izveštaja o Budžetu Kosova za 2007.godinu,
7. Razmatranje godišnjeg Izveštaja Agencije protiv korupcije,
8. Razmatranje Preporuke Komisije za zakonodavstvo i pravosuđe za izbor Narodnog advokata,
9. Razmatranje Predloga odluke Vlade Republika Kosova o proglašenju putne trase za izgradnju Autoputa Morina-Merdare i Priština-Hani Elezit zonom od posebnog javnog interesa,
10. Razmatranje Predloga za usvajanja Deklaracije protiv kleveta Carla del Ponte.

A g e n d a

1. Approval of the minutes of the plenary sessions held on 16, 20 and 21 May 2008,
2. Time for parliamentary questions,
3. First review of the Draft law on Labor,
4. First review of the Draft law on Official Statistics,
5. Second review of the Draft law on Execution procedure,

6. Discussion of the financial Report of the Kosovo Budget for year 2007,
7. Review of Annual Report of the Anti Corruption Agency,
8. Review of recommendation of the Committee on Legislation and Judicial in appointing the Ombudsperson,
9. Review of proposal-decision of Government of Republic of Kosovo in announcing the track in building the motorway Morinë –Merdare and Prishtinë - Hani Elezit as zones of special public interests in Kosovo,
10. Discussion of the proposal in issuing the declaration against defamation of Carla del Ponte.

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 2 dhe 3 QERSHOR 2008

Seanca filloi punën në orën 10,00.

Seancën e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesa e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në takimin e përbashkët me shefat e grupeve parlamentare, të mbajtur sot, vendosi që t'i propozojë Kuvendit heqjen e pikës 8 dhe të pikës 10, si dhe plotësimin me pikën shtesë - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozim vendimin e Qeverisë për aprovimin e buxhetit për vitin 2008 për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Materiali komplet është iu është shpërndarë deputetëve. Kërkoj deklarinimin e seancës plenare që me një votim formal të plotësohet rendi i ditës.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë kush është për këtë propozim të rendit të ditës? Faleminderit! A ka kundër? A keni kërkesën të flisni apo të votoni ju të dy që po e qoni dorën? 3 vota "kundër".

Deputeti Driton Tali, e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm, unë mendoj, në realitet propozoj që sot t'i kemi në agjendë edhe dy pika. Njëra është lidhur me vendimin e Qeverisë së Serbisë që më së largu deri më 5 qershor t'i krijojë apo formojë strukturat paralele në kuvendet komunale, mendoj edhe këshillat ekzekutive në ato komuna të Kosovës ku janë mbajtur zgjedhjet ilegjitime lokale të Serbisë, më 11 maj. Unë mendoj se Kuvendi patjetër duhet të reagojë dhe të ketë qëndrim ndaj kësaj çështjeje shumë serioze dhe të ndjeshme. Andaj, propozoj që sot ta diskutojmë.

Dhe pika tjetër, të diskutohen aligacionet serioze për involvim, marrëveshje të brendshme të ministrit të Ekonomisë, zotit Ahmet Shala, ish zëvendës drejtorit të AKM-së, në privatizimin e Feronikelit, ku si pasojë, pos të tjerave kemi edhe shitjen me çmim bagatellë të rrymës elektrike, e cila buxhetin e Kosovës po e dëmton rreth 40 milion euro. Faleminderit!

KRYETARI: Në bazë të Rregullës 23 pika 2, kërkesat për të hyrë ndonjë pikë në rend të ditës bëhen me shkrim.

Konstatohet se rendi i ditës me shumicë votash është miratuar, kundër kanë qenë 2-3 vota dhe ne vazhdojmë punën.

Pika e parë e rendit të ditës është:

- Miratimi i procesverbaleve të seancës plenare të mbajtur më 16, 20 dhe 21 maj 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se procesverbalet i seancave plenare të mbajtura më 16, 20 dhe 21 maj 2008 si dhe transkriptet për këto seanca iu janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në këto procesverbale?
Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

Unë do të filloj me një fjalim timin të shkurtër edhe lidhur me rendin e ditës, se mendoj se fuqia më e madhe e kushtetutshmërisë në një vend janë pikërisht njerëzit që jetojnë aty. Do të jem ekzakt në rend të ditës.

KRYETARI: Po ne e kemi votuar rendin e ditës.

NAIM RRUSTEMI: Do të jem ekzakt në pikën që po e diskutojmë. Pra, komunikimi me popullin medoemos duhet bërë, sidomos me rastet kur kemi të bëjmë me çështje shumë serioze, siç është te Ligji për festat zyrtare, i cili kishte të bëjë me relacionin mes etnisë, kombit dhe shtetit.

Si deputet i Kosovës, me shumicë votash nga rajoni i Drenicës dhe Mitrovicës, ju siguroj se edhe do të jem i drejtpërdrejtë dhe në momente të caktuara kundërshtues.

E para. Të nderuar deputetë,

Me rastin e votimit për Ligjin për festat zyrtare nga transkripti i dërguar deputetëve figuron se ka votuar edhe kolegu që në atë moment nuk ka qenë prezentë, pikërisht në të djathtën ku jam unë i ulur, zoti Ismet Beqiri.

E dyta. Para disa muajsh, në Kuvendin e Kosovës...

KRYETARI: Lus regjinë, le t'ia ndërpresë fjalën deputetit, sepse është jashtë rendit të ditës. Kush ka vërejtje në proces verbal, ka qenë pyetja. Transkriptin s'jemi duke e

votuar. Jemi në procesverbal, pyetja është për procesverbal. A ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Faleminderit!

Konstatohet se u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16, 20 dhe 21 maj.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Këtu ju njoftoj se në mbledhjen e Kryesisë për këtë pikë të rendit të ditës jemi marrë vesh që të gjitha pyetjet që kanë ardhur në Kuvend dhe i janë dorëzuar Qeverisë, ta harxhojmë gjithë kohën derisa t'i kryejmë të gjitha pyetjet që janë bërë, me përjashtim të pyetjeve për ministrat që nuk janë prezentë.

Nga seanca e kaluar janë bërë 13 pyetje për përgjigje me gojë, ndërsa në afatin e përcaktuar me Rregullore janë parashtruar 8 pyetje të tjera për përgjigje me gojë. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Deputetja Suzan Novobrdaliu, AKR, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar. Lus deputeten ta bëjë pyetjen

SUZAN NAVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet për të gjithë,

Jemi dëshmitarë të ngjarjes shumë të rrezikshme e cila ndodhi në rrugën “Bajram Kelmendi” në Prishtinë, në të cilën ka eksploduar bombola e gazit dhe pasojat e këtij shpërthimi i dimë të gjithë. Ministria e juaj, a u ka dhënë licencë, a i ka në mbikëqyrje dhe a është përgjegjëse për veprimtarinë e këtyre pompave në lokacione banuese, disa prej të cilave gjenden në mes të qytetit.

KRYETARI: Zotëri ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra,

Zonja deputete Novobrdaliu,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të nenit 20, paragrafi 1 të Ligjit të mbrojtjes së mjedisit, të neni 3, dhe të shtojcës 2, paragrafi 3, pika c, të Udhëzimit Administrativ për vlerësimin e ndikimit në mjedis, lëshon pëlqim mjedisor nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit, për të cilën kompania nuk ka pasur pëlqimin mjedisor.

Obligimet e mëturshme ligjore të operatorit për ushtrimin e kësaj veprimtarie, deponimin i gazit, janë për të pajisur nga organet kompetente të komunës me leje urbanistike sipas nenit 26 të Ligjit për planifikimin hapësinor dhe me lejen e ndërtimit sipas nenit 38 të Ligjit për ndërtim.

Pas ndërtimit të objektit, pala është e obliguar të aplikojë në Ministri për leje ekologjike, sipas nenit 22, paragrafi 1 të Ligjit të mbrojtjes së mjedisit.

Lidhur me masat e veçanta për mbrojtjen e mjedisit sipas nenit 27 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit pala është e obliguar të hartojë planin e intervenimit në rast të aksidentit ekologjik. Në planin e intervenimit në rast të aksidentit ekologjik bëhet analiza e rreziqeve të mundshme për aksidentin ekologjik dhe përshkrimi i masave parandaluese dhe masat e planit të tyre rehabilituese.

Organ kompetent, sa i përket mbrojtjes nga zjarri është Departamenti i Emergjencës të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë? Fjala e deputetes Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Meqë kryetarin e komunës së Prishtinës nuk mund ta ftojme në Kuvend, më intereson cilat janë masat konkrete të cilat Ministria, në bashkëpunim me komunën, i ka ndërmarrë në mënyrë që të njëjtat të vendosen jashtë qytetit në pajtim me ligjin.

KRYETARI: A ke përgjigje?

Fjala e ministrit Mahir Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, unë nuk kam përgjigje të veçantë, por ne sigurisht do të veprojmë sipas Ligjit të cilin e kam përmendur dhe në bashkëpunim me komunën e Prishtinës do ta bëjmë atë çka duhet të bëjmë.

KRYETARI: Faleminderit!

Kalojmë në pyetjen e dytë. Deputetja Gjylnaze Syla, AAK, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Kryeministri përgjigjen e ka bartur te ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala.

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA. Më vjen keq që s'është Kryeministri këtu, mbase s'i ka bërë detyrat e shtëpisë.

Pyetja ime ka të bëjë me rritjen e çmimeve jetësore, të bukës, të vajit, të pemëve e perimeve, të karburanteve e të tjera. Është faktike se këto çmime janë rritur diku 50%, diku 100%, për shembull, buka nga 20 centë është rritur në 40, vaji nga 80 centë në 1€ e 80 centë. Pyetja ime është se çfarë ka bërë Qeveria që të ndihmojë popullatën ta përballojë këtë inflacion? Cilat janë masat konkrete, tri masa, zoti ministër që i keni marrë, për t'i mbrojtur konsumatorët nga kjo rritje. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën. I keni 3 minuta kohë për përgjigje.

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje, zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që, po ashtu, në emër të Kryeministrit të Kosovës të përpiqem t'u përgjigjem pyetjeve tuaja, e nderuara zonja deputete, e cila sfidë ka përfshirë gjithë globin. Ne si Kosovë, duke qenë se varem nga importi, shumë vështirë e kemi që t'i përballojmë të gjitha, nëse mund të them, efektet negative që mund t'i sjellë ngritja globale e çmimeve, por megjithatë ne si Qeveri e kemi obligim dhe do të përpiqemi të bëjmë gjithçka që është e mundur që shtresat, të paktën ato më të goditurat, të mos goditen pa e ndjerë dorën e mbrojtur të Qeverisë.

Shtetet e ndryshme po përpiqen në forma të ndryshme të sfidojnë, nëse mund të them, ose të mbrohen nga kjo valë e ngritjes së çmimeve të karburanteve, të ushqimeve, të cilat janë si pasojë e masave që ka marrë Bashkësia Ndërkombëtare sa i përket reduktimit të CO dyshit. Ne si Qeveri konsiderojmë që kemi identifikuar disa nga masat, disa prej të cilave do merren në këtë vit, disa prej tyre do merren në vitin, ose në vitet që po vinë.

Në fillim të këtij viti janë duke u verifikuar gjithë kontribusit e pensioneve gjatë viteve të kaluara. Në fillim të këtij viti faktikisht dihet që kanë marrë 35 euro shtesë, kjo ka qenë një zotim që është bërë edhe më herët, por që po implementohet dhe ka filluar që nga pranvera e këtij viti të zbatohet.

Ne po shfrytëzojmë mundësinë e rritjes së pensioneve bazë për të gjithë përfituesit që do reflektojnë inflacionin akumulues dhe jemi duke punuar me Bankën Botërore për ta realizuar këtë në hapat sa më të shpejtë të mundshëm.

Në muajt në vijim, Qeveria në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë do hartojë një letër të bardhë, e cila do të shtrojë në mënyrë shumë serioze problemet, zgjidhjen e problemeve sociale, duke përfshirë rritjen e rrogave të shtresave më të gjëra, dhe të pensioneve, por edhe duke i adresuar invalidët e luftës, invalidët e tjerë të punës dhe çështje tjera për mbrojtjen sociale.

Jemi në proces të rishikimit të politikave fiskale dhe do përpiqemi që gjatë këtyre 2 muajve të ardhshëm dhe në MEF, përkatësisht me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve veç kemi identifikuar ...

KRYETARI: Zoti ministër, ke harxhuar kohën.

Zonja deputete, a ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Po, zoti ministër, çfarë masash janë këto? Unë t'i kërkoja konkret tri masa 1, 2 dhe 3. Tjetra, a keni bërë diçka ta stimuloni bujqësinë, në mënyrë që Kosova ta ketë bukën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Mund t'i përgjigjesh, zoti ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: Gjylnaze, unë i numërova katra, le t'i përsërisë tri pra, vetëm tri.

Konkrete është rritja, shqyrtimi i rritjes së pensioneve, dakord. Ne do ta bëjmë këtë në partneritet me partnerët tanë ndërkombëtarë, siç është Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID-i dhe institucionet e tjera. Letra e bardhë do të kryhet këtë vit dhe në politikat fiskale do të shqyrtohen mënyra se si t'i ndihmojmë këto. Nuk bëhet brenda dite dhe ne dëshirojmë të bëjmë diçka që do t'i qëndrojë kohës dhe jo ta bëjmë sa për ta bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputeti Hajdin Abazi, PDK, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zoti Alush Gashi. Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi

HAJDIN ABAZI: Zoti ministër, jemi dëshmitarë të gjithë se qendrat spitalore kanë probleme serioze me furnizim me barna dhe kjo kryesisht për shkak se furnizimi është i centralizuar. Duke qenë se edhe vetë jam dëshmitarë dhe kam vizituar disa qendra regjionale spitalore, jam ballafaquar me këtë problem. Prandaj pyes se a keni ndonjë strategji ju si Ministri për të gjetur ndonjë zgjidhje për ta decentralizuar furnizimin, ashtu që këto qendra spitalore t'i kenë barnat në kohë të duhur dhe ashtu siç ju duhen atyre?

KRYETARI: Zoti ministër, urdhëro, e ke fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, i nderuari zoti deputet!

Deponimi, distribuimi, disperzimi i barnave esenciale janë tri hallkat kryesore të organizimit të sistemit farmaceutik publik.

Ministria e Shëndetësisë këto tri hallka i ka organizuar në bazë të akteve nënligjore, Udhëzimit Administrativ 11/2007. Momentalisht, deponimi, distribuimi i barnave është i centralizuar dhe menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë. Në vendet me buxhet të kufizuar, siç është vendi ynë me buxhet më se modest, centralizimi i prokurimit dhe distribuimit të barnave është mënyra me të cilët tentohet të arrihet efekt maksimal si në çmim, çmime më të leverdishme të barnave, ashtu edhe në distribuim uniform dhe të drejtë e të paanshëm të barnave në të gjitha strukturat e vendit.

Decentralizimi i buxhetit të kufizuar të barnave nuk siguron efekte pozitive në sigurimin e barnave më të lira dhe me kualitet më të mirë, as nuk siguron që distribuimi i tyre do të bëhet në mënyrën më të drejtë. Përkundrazi, efekt i vetëm i decentralizimit tani në këtë formë të financimit të barnave nga lista esenciale mund të jetë rritja e shpenzimit të koston për procedura të prokurimit dhe vonesat e konsiderueshme për shkak të mungesës së kuadrit të profesionalizuar në nivele lokale të sistemit shëndetësor për ta bërë këtë punë, si dhe rritjen e çmimeve. Këtë çështje Ministria e Shëndetësisë e ka diskutuar në mënyrë të hollësishme me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe me Bankën Botërore dhe Banka Botërore e ka financuar një studim ku është ardhur në përfundim se madhësia e vendit tonë e mundëson një koordinim nga një qendër. Ne sikur të vendosim, atëherë duhet të vendosim që t'i rrisim shpenzimet edhe për 7 depo tjera në vend, që t'i risim shpenzimet për 7 menaxhime, që t'i bëjmë së paku për 7 spitale, nëse bash së paku mendohet në 7 rajone, por nëse dëshirojmë që kjo të bëhet në 30 komuna, atëherë kjo

duhet të rritet për 30 herë. Ne jemi të gatshëm që të marrim në konsideratë rekomandimet, vendimet e Kuvendit, por problemi është esencial se në vendin tonë vetëm për dializë edhe citostatikë shkon krejt buxheti i shëndetësisë për medikamente. Vetëm për këto 2 pozicione ne na nevojiten më se 11 milion euro, 11 milion euro ne i kemi të gjitha. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Kalojmë në pyetjen tjetër.

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputete, e keni fjalën për të bërë pyetjen.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër, keni paralajmëruar reformat fiskale, zvogëlimin në paga - nivelet pra të tatimit, por edhe të korporatave. Mua më intereson, sa do t'i kushtojë kjo Buxhetit të Kosovës.

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje, Gjylnaze,

Unë më parë e përmenda që gjatë shqyrtimit të politikave fiskale jemi duke shqyrtuar edhe reformën që mos t'i godet me të varfrit. Të gjithë gjashtë skenarët që janë përgatitur, gjashtë sish, asnjëri nuk afekton buxhetin, përkatësisht jemi përpjekur që çfarëdo ndryshimi përbrenda politikave fiskale të ruajë neutralitetin buxhetor. Prandaj, njëri nga propozimet që është dhënë për zvogëlimin e taksave në pagë, zvogëlimin e taksës në korporatë, rritjen e vogël të TVSH-së dhe rritjen e vogël ose të konsiderueshme të akcizës, në aspektin buxhetor do jetë e balancuar, kështu që këtë e kemi matur saktë. Shifrat, nëse dëshironi ju si deputete, në momentin kur Qeveria i vendos, natyrisht, që do të jenë publike, por nëse ju dëshironi si deputete, jeni e mirëseardhur për t'i analizuar detajisht. Pra, efektet buxhetore janë neutrale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Keni pyetje shtesë, deputete? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, tani e kuptova që në pyetjen e parë ju në të vërtetë ishit përgatitur për këtë të dytën. Pyetja ime ishte konkrete. Sa do t'i kushtojë kjo buxhetit. Unë dua ta kem tani shifrën se kjo më siguron që këto reforma do të jenë të suksesshme. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Mbase s'më ke kuptuar. Çdo ndryshim i politikave fiskale duhet të ruaj qëndrueshmërinë fiskale. Ne nuk kemi të drejtë të emitojmë para, andaj i vetmi mekanizëm në dorën tonë është politika fiskale dhe në fund të vitit emitimi i letrave me vlerë. Kështu që çfarëdo ndryshimi, ne përpiqemi të ruajmë neutralitetin buxhetor, pra që të ketë qëndrueshmëri buxhetore, ndërsa në të njëjtën kohë të lirohet

biznesi në mënyrë që baza tatimore të rritet dhe inkasimet me rritjen e bazës tatimore të rriten dhe në të njëjtën kohë të luftohet informaliteti.

Ndërsa, në aspektin e të hyrave nuk do të ketë ndryshime buxhetore ose, eventualisht, sipas kalkulimeve tona, do të ketë rritje diku për afro 10% karshi me gjendjen ekzistuese, pa marrë parasysh zbritjet që do t'i kemi. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Pyetja e radhës, deputeti Armend Zemaj, LDK, pyetje për ministrin e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Zoti deputet, e keni fjalën. Regjia, fjalën ia kaloni deputetit Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Zoti ministër,

Pyjet e Kosovës janë resurse kombëtare të cilat duhet mbrojtur, ruajtur dhe zhvilluar për të mirën e vendit dhe gjeneratat e tashme dhe të ardhshme, në mënyrë që të kemi biodiversitet dhe zhvillim ekologjik të qëndrueshëm.

Ministria që ju drejtoni është institucioni kompetent që ka juriduksion mbi pyjet e Kosovës, andaj edhe përgjegjësia për kujdesin e tyre është e juaj. Në këtë kontest, dikur komuna e Deçani ka qenë vendi i njohur për nga pasuria pyjore, por vitet e fundit imazhi i këtyre pyjeve ka ndryshuar në mënyrë drastike për shkak të prerjeve të paligjshme të pyjeve në mënyrë të vazhdueshme në një hapësirë që shtrihet nga Bjeshkët e Strelcit, Gryka e Deçanit e deri mbi Zharre, te Kosharja mbi fshatin Botushë.

Zoti ministër, sa jeni në dijeni për atë që po ndodhë në atë trevë, dhe nëse jeni të informuar, atëherë çfarë keni ndërmarrë konkretisht, ju si ministër, dhe dikasteret që ju drejtoni për parandalimin e kësaj dukurie të tmerrshme të shkatërrimit të kësaj treve.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputeti Zemaj,

Është e vërtetë se problemi i prerjes së pyjeve është një problem akut, i cili do zgjidhje të shpejtë. Mirëpo, këtu unë mendoj se për zgjidhjen e këtij problemi duhet të veprojnë edhe mekanizma të tjerë të shtetit dhe këtu unë mendoj në gjykatat, në radhë të parë, por pse jo edhe policia.

Ne, si Ministri, për ruajtjen pyjeve kemi roje të pyllit dhe unë dua të jap disa shifra në komunën tuaj për vitin 2007 dhe për tremujorin e parë të vitit 2008.

Për vitin 2007 në komunën e Deçanit fletëparaqitje për kundërvajtje ka pasur 315, ndërkaq fletëparaqitje për vepra penale 174, do me thënë këto në lidhje me pyjet janë. Ndërkaq, janar – prill 2008 fletëparaqitje për kundërvajtje kanë qenë 169, kurse për vepra penale 46. Kjo nënkuptohet se rastet e shkatërrimit të pyjeve janë raste recidive, ndaj të

cilave nuk merren masa të rrepta që ata të disiplinohen. Prandaj, keqbërësit vazhdimisht përsërisin veprat e tyre. Në vazhdë të kësaj, unë dua të theksoj se pikërisht në regjionin e Deçanit ndodhin edhe rrahje të rojeve të pyllit, ka pasur 13 raste të sulmeve ndaj personave zyrtarë, ku fatkeqësisht në shumicën e këtyre rasteve kanë kërkuar edhe ndihmë mjekësore.

Pastaj, ka pasur edhe demolim të 2 automjeteve të Agjencionit të Pyjeve të Kosovës dhe ndaj këtyre personave masa që ndërmerren janë shumë të lehta ose fare nuk ekzistojnë.

Prandaj, për këtë qëllim ne jemi në bisedime dhe jemi në fund të përgatitjes së një memorandumit me Ministrinë e Brendshme, në mënyrë që të ngritet një task forcë, e cila në çdo moment do t'ju delte në ndihmë rojeve të pyllit dhe njëkohësisht jemi në bisedë edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor që lëndët të cilat janë nëpër gjykata të bëhet zgjidhje e shpejtë e tyre, sepse as 30% e rasteve të lëndëve që janë nëpër gjykata për një vit të caktuar nuk zgjidhen, por njëkohësisht edhe masa që merren janë shumë të lehta. Prandaj, unë mendoj që këtu, përveç Ministrisë së Bujqësisë, përkatësisht Agjencionit të Pyjeve, për ruajtjen e pyjeve duhet të aktivizohen edhe mekanizmat e tjerë të shtetit që i përmenda më sipër.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti deputet, ke pyetje shtesë. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Sigurisht, ministër që qytetarët i presin këto masa, sepse vetëm këto vitet e fundit, niveli i ujit në komunën tonë është në rënie drastike pikërisht nga prerja e pyjeve që ka ndodhur, sidomos viteve të fundit. Ajo çka është më e keqja, zotëri ministër, që nga njëherë transporti ilegal i atyre të mëdhenjve, nuk po flas për ata të vegjlit, veprat kundërvajtje bëhen në përcjellje të Shërbimit Policor të Kosovës, këtë e them me përgjegjësi të plotë. Edhe më e keqja është se aty ku ka pasur djegie të pyjeve të qëllimshme, menjëherë nga Ministria, po flas për mandatin e kaluar, ka dalë në tender ajo pjesë, zotëri ministër. Prandaj, duhet të kem parasysh se kjo ndodhë në lidhje direkte edhe me zyrtarë nga Ministria e uaj, këtë e them me përgjegjësi të plotë. Pjesa ku është bërë djegia, menjëherë pas një kohe të shkurtër ka dalë edhe në tender, kishe janë dru të vjetra edhe është bërë prerja totale, pa kurrfarë kriteri. Prandaj, unë e kam edhe vetëm një pyetje shtesë: A do të ketë ripyllëzim të kësaj treve gjatë këtij mandati që ju e drejtoni?

KRYETARI: A ke përgjigje, zoti ministër? Fjalën e ka ministri, Idriz Vehapi.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Për ato që kanë ndodhur në vitet e kaluara unë nuk kam përgjigje për ato, sepse nuk kam informacione të sakta dhe s'jam kompetent. Për atë çka do të ndodhë në të ardhmen, ne planifikojmë që në komunën tuaj në sezonin tetor – nëntor të këtij viti t'i pyllëzojmë rreth 20 hektarë, ndërkaq për vitet e tjera sipërfaqet do të rriten. Problemi është gjithnjë se edhe për ato pyllëzime duhet të përkujdeset dikush, sepse edhe këto pyllëzime drejtpërdrejtë janë të atakuara prej keqbërësve që janë raste recidive. Kjo do të ishte përgjigja ime.

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës. Deputeti Naser Rugova, LDD, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Zoti deputet, e ke fjalën!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri ministër i Shëndetësisë, është e ditur se spitali rajonal i Mitrovicës është në pjesën veriore të qytetit, ku nuk kanë qasje qytetarët shumicë të këtij rajoni. Shërbimet shëndetësore të nivelit dytësor për tërë këtë rajon ofrohen në një objekt të improvizuar të Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare atje, i cili as për së afërmi nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat e mëdha të popullatës atje. Duke e ditur se në programin qeveritar qyteti i Mitrovicës nuk është përmendur fare, a keni ju si Ministri plan konkret për ofrimin e përkujdesjes shëndetësore dytësore për qytetarët shumicë të regjionit të Mitrovicës? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar i Kuvendit!

Mua kjo pyetje në Ministri nuk më ka ardhur, por është një prej preokupimeve tona në Ministrinë e Shëndetësisë, sepse sa i përket shëndetësisë, Prishtina si kryeqytet, dhe Mitrovica, si qytet i madh, janë dy qendra tashmë një kohë të gjatë qendra universitare. Në qytetin e Mitrovicës ekzistojnë fakultete më se 20 e sa vite dhe, në vitet e fundit, me ligjin tonë dhe me nënshkrimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, pas një paneli atje është formuar edhe një universitet publik. Andaj, duke u bazuar në realitetin në terren, ne kemi bashkëbiseduar me kryetarin e qytetit të Mitrovicës dhe kemi ardhur në përfundim për atë që botërisht dihet se sa vite një pjesë e madhe e qytetarëve të Mitrovicës nuk kanë qasje në spital.

Puna e parë që kemi ndërmarrë menjëherë është që objektet shëndetësore të spitalit të Vushtrrisë i kemi hapur kemi, mundësuar që një numër i mjekëve nga Mitrovica të vijnë aty dhe, nën dy, e kemi shikuar mundësitë e gjetjes së donacioneve që në Mitrovicë të rriten kapacitetet spitalore. Me propozim të qytetit është ardhur në përfundim se ish kazerma e Armatës, e cila ka qenë e shndërruar në Spital Marokien, që ajo fillimisht të rinovohet dhe, duke ju falënderuar donacionit nga Qeveria Norvegjeze diku prej 2 milion eurove, për këtë vit do të funksionalizohen 2800m² spitalore dhe gjatë përpilimit të buxhetit për vitin 2009 ne do të sigurohemi që mjetet e tjera për zhvillimin e reparteve të tjera të sigurohen për vitin e ardhshëm. Nëse këtu e përmendim edhe çështjen e decentralizimit, që do të vjen, do të rrumbullakohet këto ditë me projektin e pranuar nga ne, të zotit Ahtisari, atëherë këto 2 spitale të qytetit do të bashkëfunksionojnë dhe ne, si Ministri, jemi shumë të përkushtuar që për ngritjen e kuadrit të japim prioritet për specializime, si në vend, edhe jashtë, dhe të mundësohet një qasje optimale, e cila këto vite me të vërtetë ka probleme shumë të mëdha jo vetëm në Mitrovicë, por aty graviton një pjesë e madhe e vendit tonë. faleminderit për pyetje!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja është administruar më 12 maj 2008. Deputet, a ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit! Ka qenë edhe deklaram i kryetarit të qytetit të Mitrovicës, por edhe të zyrtarëve të tjerë që tendenca që spitali rajonal të kompensohet me mbulimin e shërbimeve shëndetësore të nivelit sekondar në spitalin e Vushtrrisë, që gjithashtu është donacion, nuk qëndron. Qeveria, institucionet e Republikës së Kosovës dhe konkretisht Ministria e Shëndetësisë duhet të fokusohet që të bëjë zgjidhje optimale, adekuate konform kërkesave të qytetarëve të qytetit të Mitrovicës, që të bëhet zgjidhja në qytetin e Mitrovicës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka zoti ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ne në Ministrinë e Shëndetësisë pajtohemi plotësisht me konstatimin se objektet aktuale dhe kapacitetet e Vushtrrisë janë të dizajnuar që të ofrojnë shërbime për komunën e Vushtrrisë, ndërsa përcaktimi është i singertë dhe i plotë dhe ne do ta funksionalizojmë edhe një spital në Mitrovicë në të mirë të shërbimeve mjekësor për gjithë qytetarët e vendit. Ju përkujtoj se me decentralizim, sipas Ahtisarit, një pjesë shumë e madhe kompetenca, që do të thotë edhe hapjen e menaxhimit të spitaleve, licencat, e të tjera, do të jenë nën kompetencë lokale. Prandaj, ne me përkushtim të plotë do ta funksionalizojmë një spital me kapacitete të mjaftueshme.

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës, përsëri nga deputeti Naser Rugova, për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zoti Idriz Vehapi. Zoti Rugova, e keni fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Ditëve të fundit ka qenë shqetësues lajmi, jo vetëm në media të shkruara dhe elektronike, për hyrjen në Kosovë të sasive të mëdha të produkteve ushqimore me afat të skaduar. Pasojat për shëndetin e qytetarëve nga produktet e tilla ushqimore tashmë dihen. Këto zhvillime po e rrisin trendin e ekonomisë informale dhe po i dëmtojnë shumë prodhuesit vendorë. Çka keni ndërmarrë ju, si Ministri, për parandalimin e këtyre trendeve tejet të dëmshme, në radhë të parë për shëndetin e qytetarëve, por edhe për prodhuesit vendorë.

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari deputet Rugova,

Është e vërtetë se pas 19 shkurtit, në pjesën veriore të Kosovës janë shkaktuar probleme sa i përket hyrjes së mallrave dhe ato me origjinë bimë dhe shtazore, përkatësisht mallrat të cilat shërbejnë për ushqim.

Ne, si Ministri, në këto dy pika kemi pasur gjithsej 8 inspektorë, veterinarë dhe fitosanitarë, nga 4 në të dy pikat. Prej atij momenti, prej datës 19 shkurt, këtyre inspektorëve në pikat kufitare iu ka pamundësuar puna dhe krejt ajo çka këta mund të bëjnë mund të bëjnë inspektimin e mallrave të cilat i hasin në terminal në Mitrovicë.

Dhe, përveç kësaj, të gjitha mallrat tjera të cilat hynë nga territori i Serbisë, pavarësisht prej asaj se posedojnë deklarata sanitare, inspektorët janë të detyruar që të marrin mostrat dhe ato mostra të kontrollohen në laboratorët përkatëse dhe malli i cili merret për analizë nuk guxon të shpërndahet derisa nuk kthehen rezultatet.

Këtu, deri në datën kur ju keni bërë pyetjen, unë dua të konfirmoj se janë inspektuar gjithsej 111 ngarkesa, prej të cilave janë marrë prej secilës nga një mostër dhe janë asgjësuar 28. 800 kilogram ushqim me origjinë shtazore.

Janë konfiskuar gjithsej 244 gjedhe të gjalla, të cilat janë hy ilegalisht në territorin e Kosovës si dhe janë konfiskuar 1967 pula, të gjitha këto mallra të cilat kanë hyrë kontrabandë në Kosovë. Ne, vazhdimisht, brenda mundësive që kemi, bëjmë përpjekje që mallrat të cilat hynë nga territori i Serbisë në pjesën veriore, ato të cilat inspektorët tonë i kapin, ato inspektohen në laboratorët gjegjëse dhe të gjitha konfiskohen dhe procedohen në procedura të mëtejme.

Kemi në kohë të fundit një rast ku është tentuar të futen rreth 107 krerë dele kontrabandë, të cilat janë hasur nga inspektorët tanë për rrugë dhe ato ka 2 javë që gjenden në karantinë dhe presim vendimet të cilat duhet të merren.

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Unë e kam një koment të shkurtër. Duke i parë vetëm statistikën e këtij 20 ditshi të fundit, konsiston se mbi 30 mijë kilogram, 30 tonë ushqime që janë produkte ushqimore të konsumit të përditshëm të qytetarëve, do të thotë kanë hyrë në formë jo të rregullt dhe Qeveria e Kosovës, në radhë të parë, qoftë me vendime politike, qoftë me mekanizma institucional duhet të përkujdeset dhe ta mbrojë qytetarin e vet nga këto trende që mund të kenë pasoja të paparashikueshme, mos të flasim për prodhuesit vendor që janë rrëzuar për tokë nga kjo qasje edhe qeveritare, por edhe nga mbizotërimi i ekonomisë informale në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I njoftoj deputetët, deputeten Drita Kadriu, Naim Rrustemi, i ka 2 pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, edhe deputetja Suzana Novobrdaliu ka një pyetje për Kryeministrin, për të cilën Kryeministri ia ka adresuar përgjigjen ministres së Drejtësisë. Pasi ministrja nuk është këtu, nëse doni t'i lexoni, po i lexojmë në fund të kësaj pike të rendit të ditës.

Po Kalojmë te pyetja e 12, deputetja Suzana Novobrdaliu, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaqi. Edhe kjo do të duhej të shtyhej pasi nuk është Kryeministri këtu dhe nuk e ka adresuar përgjigjen te asnjë ministër.

Deputetja Suzana Novobrdaliu, pyetje për Kryeministrin e Republikës, por Kryeministri e ka adresuar përgjigjen te ministri i Arsimit, zoti Enver Hoxhaj. Lus deputeten, nëse do, le ta lexojë pyetjen!

SUZANA NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Para disa javësh, në një nga mbledhjet e Qeverisë, përveç tjerash keni raportuar edhe për Programin BRAINGAIN, apo Mbledhje e Trurit të Inteligjencës, dhe më se 130 CV janë regjistruar në këtë databazë. Disa janë nga kosovarët që janë duke i ndjekur studimet jashtë Kosovës, e disa nga kosovarët që kanë mbaruar më herët studimet jashtë Kosovës, e që punojnë nëpër institucionet e shteteve të huaja perëndimore me përvojë të gjatë demokratike.

Meqenëse Kosova është shtet i ri dhe nuk është njohur nga shumë shtete ashtu siç është paraparë nga Qeveria, pse nuk po e strukturori këtë databazë dhe nuk filloni ta akumuloni diturinë e kosovarëve jashtë vendit, për të cilën mendoj se Kosova ka nevojë.

KRYETARI: Zoti ministër, a keni përgjigje?

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti kryetar,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,

Zonja deputete, ju faleminderit shumë për një pyetje të tillë! Qeveria e Kosovës ka iniciuar programin BRAINGAIN, i cili në fazën aktuale ka mbi 168 kandidatë. Të gjithë këta kanë shkallën e magjistrisë ose të doktorit të shkencave, të cilët punojnë dhe jetojnë në vendet e ndryshme të botës. Si e përmendët edhe ju, BRAINGAIN, nënkupton edhe kthimin e turirit po edhe atë se çfarë thirret në Bashkimin Evropian, si qarkullim i trurit. Qëllimi i ynë, si Qeveria e Kosovës, është që mbi të gjitha, këtyre të rinjve t'iu mundësojmë që të integrohen në nivel të pushtetit qendror, në nivel të pushtetit lokal, mirëpo edhe në agjencitë publike.

Ne, besojmë se deri në fund të muajit korrik do ta dorëzojmë raportin final se si ka qenë e vendosur në mbledhje të Qeverisë dhe pastaj Zyra e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shërbimeve Publike do të bëjnë përpjekje që këta ekspertë, të cilët jetojnë jashtë Kosovës, vërtet t'i integrojmë në strukturat tona qeverisëse.

Qëllimi kryesor i këtij Programi është jo vetëm kthimi fizik, sesa shfrytëzimi i potencialeve dhe ofrimi i mundësisë që këta të rinj të kthehen në Kosovë dhe të kontribuojnë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Përndryshe, një program i tillë ka si qëllim madhor që të kemi menaxher në procesin e shtetndërtimit, njerëz të cilët janë në gjendje ta bartin Kosovën karshi sfidave të reja të cilat na presin.

Unë shpresoj që në një seancë të ardhshme do të jetë mundësia që t'ju informojmë edhe më detajisht rreth rrjedhjes së programit BRAINGAIN.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Ministër!

Zonja deputete, a ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Suzana Novobrdaliu.

SUZANA NOVOBRDALIU: Sa veta mendoni t'i punësoni deri në fund të vitit?

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

ENVER HOXHAI: Aktualisht, zonja deputete, jemi në fazën e përmbylljes së analizës. Pasi ta kemi një studim të detajishëm dhe studimi është, mbi të gjitha, i karakterit pragmatik, ku ne na intereson emri dhe mbiemri i kandidatit, shkalla e ngritjes profesionale, interesi i tij i ushtrimit të ekspertizës në Kosovë. Besojmë se gjatë këtij viti do të jemi në gjendje që të dalim me të dhëna paraprake, meqë ky do të jetë një relacion edhe individual mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kandidatit, kështu që nuk varet shumë prej asaj se sa ne do të jemi në gjendje të punësojmë në këtë vit, ose sa do të kenë kohë këta njerëz, që vërtet të involvohen në proceset, të cilat e presin Kosovën në të ardhmen.

Qëllimi ynë, si Qeveri e Kosovës, është që ta bëjmë atë që e kanë bërë shtetet e tjera. Sa për informatë, e kemi edhe një proces, i cili do të ndihmohet edhe nga UNDP-ia, nëse ka ekspertë të tillë të cilët vërtet Buxheti i Kosovës nuk është në gjendje që t'i paguajë. Ne jemi të interesuar që të kemi edhe mjete shtesë, ku nuk e përjashtoj mundësinë që edhe në konferencën e donatorëve të kërkojmë mjete shtesë me qëllim që këta të rinj ose të reja të paguhen sa më mirë me qëllim që ta ndihmojnë Kosovën.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Pyetja e radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin apo zëvendëskryeministrin ose ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zoti Enver Hoxhaj. Zoti deputet, e keni fjalën!

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër, sipas të dhënave të publikuara kohë më parë, në vitin shkollor 2007/2008, rreth 10.000 nxënës kanë braktisur shkollat. Nga arsyet kryesore të cilat bëjnë që nxënësit ta lënë shkollën, pos atyre ekonomike, u kuptua, janë edhe perceptimi i disa prindërve edhe të rinjve se shkolla nuk krijon ndonjë avantazh në punë dhe për nevoja të familjeve për të përfshirë fëmijët, sidomos djemtë në punë të fermave private.

Pyetja është kjo: Cili është plani strategjik i Qeverisë, respektivisht i ministrisë suaj për t'iu qasur këtij problemi dhe këtyre argumenteve për mosvijimin e fëmijëve në shkollim? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër Hoxhaj, e keni fjalën.

ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!"

Të nderuar deputetë,

Ju faleminderit vërtet për një pyetje të tillë. Në vitin 2004 ka pasur 4.141 nxënës që e kanë braktisur shkollën, përderisa në dhjetor të vitit 2007 ka pasur 9.031 nxënës sipas statistikave tona që e kanë braktisur shkollën. Gjendjen që e kemi aktualisht nuk mund

ta përcjellim me të dhëna, por shpresoj se deri në fund të muajit korrik do të kemi të dhëna më precize.

Më lejoni t'i përmend disa masa konkrete të cilat synojnë ta adresojnë problemin e braktisjes së nxënësve nga shkolla, meqë çështja është pak më komplekse. Ndër të tjera, ne bëjmë përpjekje që përmes ndërtimit të shkollave të reja edhe në fshatrat e vogla dhe të izoluarat të Kosovës, t'iu mundësojmë nxënësve që të kenë hapësirë shkollore. Së dyti, në disa nga komunat, në bashkëpunim me kryetarët e komunave kemi arritur që të ketë transport, meqë largësia nga shkolla deri në vendbanim është njëra prej arsyeve kryesore, ndërsa pyetja e juaj konkrete se cili është relacioni i arsimit me ekonominë, kur është fjala tek arsimi i mesëm, ne vetëm gjatë këtij viti kemi hedhur disa projekte të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e shkollave profesionale, të cilat shkolla profesionale do të synojnë pikërisht t'i adresojnë nevojat e një shtrese e cila është e interesuar që të arsimohet sa më shpejt dhe të kyçet në ekonomi.

Ju e dini që ndër prioritet tona është që edhe në qytetin e Pejës ta kemi një shkollë të mirëfilltë ekonomike, e cila shkollë ekonomike do të adresojë kërkesat e tilla. Në Gjakovë, ku trendi i rritjes së braktisjes së nxënësve është jashtëzakonisht i madh, jemi në bisedim e sipër me kryetarin e Komunës që ta gjejmë një profil të shkollës. Do të thotë, qëllimi kryesor është se si të kemi shkolla të mesme profesionale të cilat ju mundësojnë që këto të reja dhe këta të rinj vërtet të mos braktisin shkollën.

Ndërsa, paralelisht dhe në rrafshin vjetor jemi duke bërë një studim, i cili studim i shpjegon shkaqet, arsyet, trendet dhe i cili do të përcillet me një regjistër të saktë se cilat familje ballafaqohen me fenomenin e braktisjes së nxënësve nga shkolla dhe cila është arsyeja themelore pse kjo ndodhë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë? Deputeti Driton Tali, pyetje shtesë.

DRITON TALI: Kam një koment të vogël. Këtë statistikë e kam marrë nga një studim që ju e keni publikuar, ministria e juaj, shpresoj. Sidoqoftë, unë u ndala në dy argumente, zoti ministër, do me thënë i atij se shkolla nuk krijon avantazh në punë. Mendoj se këtu duhet bërë reforma të mirëfillta në Kurrikulin e shkollës, sidomos në mënyrën e të ligjëruarit, të mësimdhënies, që mos të jetë monotone, por të jetë interesante edhe edukuese. Kurse, sa u përket nevojave të familjarëve për të punuar fëmijët në fermat e tyre, unë mendoj se ne nuk jemi duke e zbuluar shtetin. Çdo shtet merr masa rigorozë ndaj prindërve të papërgjegjshëm, të cilët e flirtojnë ardhmërinë e fëmijëve të tyre për ndonjë interes minor momental, andaj edhe ne nuk duhet të jemi shumë të butë ndaj këtyre fenomeneve, do me thënë duhet të marrim masa rigorozë ndaj këtyre prindërve të pandërgjegjshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Mendoj, ishte koment. Sigurisht që edhe për këtë çështje duhet të respektohet dhe të zbatohet Ligji. Ligji arsimin fillor e parasheh të obligueshëm dhe të detyrueshëm në një formë.

Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrin apo ministrin e Transportit dhe të Posttelekomunikacionit. Ministri nuk është këtu momentalisht që të përgjigjet, andaj a mund të presim pak?

Mirë, ju faleminderit!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi. Këtu ka pasur të përgjigjet zëvendëskryeministri Kuçi, por edhe ai nuk është këtu.

Kalojmë te deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputete, e keni fjalën! As deputetja nuk është këtu!

Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin apo zëvendëskryeministrin, mirëpo këtu përgjigjen ia kanë adresuar ministrit të Arsimit. A doni që ta parashtroni pyetjen? Deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Pyetja për ministrin e Arsimit u amortizua, zoti kryetar, këtë desha ta them. Kam një pyetje tjetër, mbase është përzier atje në administratë, që i drejtohet Kryeministrit apo zëvendëskryeministrit dhe ka të bëjë me atë pikën, të cilën tentova ta inicioj sot në mëngjes, do me thënë me qëndrimin e Qeverisë ndaj vendimit të qeverise serbe për te krijuar apo formuar këto strukturat paralele, do me thënë kjo pyetje pret në rend. Tjetër pyetje nuk kam unë, më sa e di. Nëse doni, këtë pyetje do ta bëjë, por le të më jepet minutazhi.

KRYETARI: Ministri i Pushtetit Lokal, e keni fjalën! Mirë, atëherë vazhdojmë. Ju faleminderit!

Deputetja Edita Tahiri, pyetje për ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, zotëri Mahir Yagcilar.

Zonja deputete, e keni fjalën.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve,

Pyetja ime është për zotin ministër Yagcilar. Fjala është për Parkun nacional në Prevallë. Zotëri ministër, a jeni të njoftuar me situatën e fundit me Parkun nacional në Prevallë, e cila ka të bëjë me realizimin e një projekti të ndërtimit, të të ashtuquajturit Fshat turistik “Prevalla” si dhe të projektit “Kampingu veror”. Nëse po, çfarë masash keni ndërmarrë për parandalimin e këtyre projekteve të paligjshme, si dhe a janë bërë vlerësime për dëmet që i janë bërë Kosovës dhe komunës së Prizrenit në aspektin e ruajtjes së ambientit, të pasurive natyrore, turistike e kulturore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Ministër, e keni fjalën!

MAHIR YAGCILAR, MINISTËR: Ju faleminderit, i nderuari Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuara deputete Tahiri,

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është njoftuar me rastin e ndërtimeve që janë bërë në Parkun nacional, respektivisht në Fshatin turistik “Prevalla” dhe me situatën në “Kampingun veror” në Prevallë.

Ekipi nga Ministria i ka bërë vizitë dy lokacioneve të përmendura. Sa i përket lejes, lokacioni i Prevallës për realizimin e projektit të Fshatit turistik është bërë në bazë të planit rregullativ të Prevallës, i cili është përgatitur nga Kuvendi Komunal në Prizren dhe është aprovuar nga Ministria me Vendimin nr. 06/2464,1, të datës 4. shtator të vitit 2006, me të cilin ishte miratuar ky plan rregullativ dhe janë dhënë kushtet të cilat duhet të respektohen gjatë realizimit të projektit.

Bazuar në raportin e Ekipit nga Ministria dhe të dhënave nga Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prizrenit, deri me tani në këtë lokacion janë lëshuar 38 leje të ndërtimit nga Komuna e Prizrenit. Në këtë raport thuhet se ndërtimet e bëra deri më tani posedojnë leje ndërtimi. Mirëpo, gjatë ndërtimit nuk janë respektuar kriteret e dhëna me leje dhe me plan rregullues. Në këtë rast, nuk janë respektuar vija rregullative, gabariti, etazhiteti dhe materializimi ashtu siç janë paraparë me plan rregullues. Përkohësisht është ndërprerë dhënia e lejeve për ndërtim.

Mësohet se në Bordin e drejtorëve të Kuvendit Komunal të Prizrenit është marrë vendimi për rishikimin apo revidimin e planit rregullues, ekzistues dhe ndërrimin e emërimit “Fshat turistik” dhe ky vendim pritet të miratohet në Asamblenë komunale.

Arsye për revidimin e këtij plani është koeficienti i lartë i ndërtimit dhe numri i madh i shtëpive të parapara me planin ekzistues, çka rezulton që ishte jashtë të gjitha rregullave dhe kriterëve që i përkasin një zone të shpallur si Park nacional.

Lidhur me “Kampingut verior”, ky ishte një projekt i përkohshëm, i cili aktualisht menaxhohet nga kompania private...

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, a keni pyetje shtesë?

EDITA TAHIRI: Zoti ministër, ju vetëm treguat që keni bërë një lloj monitorimi të gjendjes. Pyetja ime është: Çfarë masash keni ndërmarrë apo çfarë masash keni ndërmend që të ndërmerrni? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, edhe njëherë ju faleminderit!

Një prej takimeve të para që e kam pasur si ministër, ka qenë takimi me kryetarin e Komunës së Prizrenit, ku biseduam edhe për këto çështje. Pastaj, kanë qenë edhe disa takime, mund të them edhe në nivele tjera, dhe besoj që së shpejti do të formohet një komision i përbashkët mes Ministrisë dhe Komunës së Prizrenit, dhe sigurisht se do të dalim edhe me propozime edhe për “Fshatin turistik”, por gjithashtu edhe për “Kampingun veror”, i cili është një kamp i përkohshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Hydajet Hyseni, pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Urdhëro, fjalën e ke zoti deputet!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Pyetja në të vërtetë është e karakterit ndërministror, por i drejtohet ministrit të Pushtetit Lokal, dhe është afërsisht kjo: Sa dhe si kompensohen përfaqësuesit e zgjedhur të pushtetit lokal, këshilltarët dhe asambleistët, qysh po i quajmë, sa janë të bazuara ankesat e tyre për nivelin tepër të ulët të kompensimit, dhe nëse kjo është e vërtetë, si shpjegohet kjo? Sa ndikon kjo në angazhimin e tyre në një punë me peshë dhe përgjegjësi shumë të madhe? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtar të Kabinetit qeveritar,

Çështja e pagës së stafit politik nëpër komuna është rregulluar me Udhëzimin administrativ nr. 08/2008, të datës 27.02.2008, të bazuar në Rregulloren 2001/19 dhe Rregulloren 2007/30.

Gjithë kësaj pune paraprake, pra deri në nënshkrim, kalim nëpër Kabinetin qeveritar dhe nënshkrim nga ana e Kryeministrit, i ka paraprirë një punë ndërministrore, shumë drejt, pra nuk kemi qenë sponzorues, por bashkëpunues për këtë Rregullore, dhe përveç përfaqësuesve të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, përfaqësuesve të Ministrisë së Shërbimeve Publike, kanë qenë edhe disa kryetarë të komunave. Pastaj, në muajin prill Asociacioni i komunave ka mbajtur, gjegjësisht Bordi ka mbajtur një takim dhe i ka adresuar këto shqetësime, të cilat kanë ardhur nga komunat e Kosovës, dhe me datën 26.05. kjo ka arritur në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kemi mbajtur një takim me Bordin e Asociacionit të komunave, e kemi adresuar këtë çështje tek Ministria për Ekonomi dhe Financa, ngase ka refleksione buxhetore dhe duhet të harmonizohet. E kemi adresuar pastaj tek Kryeministri dhe presim se kjo çështje do të jetë në rendin e ditës në njërin prej mbledhjeve të ardhshme të Qeverisë dhe do të shikojmë se cilat janë mundësitë. Dëshira jonë është që edhe në këtë rast të kemi përgjigje pozitive, në rast se lejojnë mundësitë. Tani për tani, kjo është përgjigja.

KRYETARI: Ju faleminderit! Ka pyetje shtesë? Nuk ka. Ju faleminderit! Vazhdojmë. Deputeti Hydajet Hyseni, pyetje për ministrin për Kthim dhe Komunitete, zotin Boban Stankoviq.

HYDAJET HYSENI: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe kjo pyetje është e karakterit ndërmënor dhe nuk do të dëshiroja të kuptohet si drejtim drejtpërdrejt Ministrisë dhe ministrit që posa ka filluar mandatin, është çështje e një afati më të gjatë.

Pyetja është vijuese: A ka Qeveria një pasqyrë për gjendjen e të dëbuarve nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja dhe çka ka ndërmarrë ajo për zgjidhjen apo, së paku, zbutjen e problemeve të shumta me të cilat përballen ata? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti ministër!

MINISTAR BOBAN STANKOVIĆ: Poštovani predsjedniče,
Poštovani narodni poslanici,
Poštovani kolege i ministri,

Na vaše pitanje šta je sa izbeglim i raseljenim licima iz Bujanovca, Medvedje i Preševa, mogu vam dati veoma kratak odgovor. Nažalost, Ministarstvo za zajednice i povratak nije nadležno po ovom pitanju, jer izbegle i raseljene sa ovog prostora tretura Koordinaciono telo za jug Srbije i UNHCR Srbije i Kosova.

Ministarstvo za zajednice i povratak, nadležno je isključivo za raseljene i izbegle sa prostora Kosova u bivše republike Jugosllavije, kao što su Srbija, Makedonija, Crna Gora i tako dalje.

Svi raseljeni i izbegli iz ovih opština koji žele da se vrata u svoje domove, moraju se obratiti Koordinacionom telu za jug Srbije i sva soja prava ostvariti preko tog tela.

Ministarstvo za zajednice i povratak nema nikakvih kontakata sa ovim telom Republike Srbije, iz prostog razloga što oni ne priznaju institucije sistema Kosova i ne žele nikakvu saradnju po ovom i po drugim pitanjima što se tiče povratka raseljenih iz Medvedje, Preševa i Bujanovca. Koliko mi imamo informaciju, ovim pitanjem se takođe bavio UNHCR sve do 2003.godine, tako da preciznije podatke po ovom pitanju možete potražiti kod UNHCR. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Zoti deputet, keni pyetje shitesë? Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni - Kaloshi.

HYDAJET HYSENI: Unë e falënderoj ministrin për përgjigjen, edhe pse jo e plot, por e sinqertë. Por, një defekt i madh del në shesh edhe njëherë. Ministria jonë është Ministri për Komunitete dhe Kthim. Problemet e qytetarëve janë ekuivalente edhe problemet vetë janë ekuivalente, duan edhe trajtim adekuat.

Prandaj, pyetja ime është: Eventualisht, çka planifikon Qeveria të ndërmarrë për të normalizuar qasjen e saj ndaj këtij problemi vërtet të ndjeshëm dhe të madh? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Të nderuar deputetë, pyetjet që nuk patën përgjigje, a doni t'i lexoni? Ju njoftoj se pyetjet kalojnë edhe në seancën tjetër. Nëse nuk vijnë në seancën tjetër, nuk kanë përgjigje, shkojnë në BULETIN.

Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar, unë një pyetje për të cilën mendova se ministri i Pushtetit Lokal, të paktën, apo zëvendëskryeministri, do të më përgjigjej, disi u përzie dhe u keqkuptuam, u la anash. Unë do ta bëja këtë pyetje, gjersa pyetjen për ministrin për Transport do t'ia lë zotit ministër ngase është teknike dhe nuk do të doja që ta pyes tjetërkënd për atë pyetje. Por, këtë pyetje që ishte në agjendë, do të doja ta bëja.

KRYETARI. Urdhëro, parashtroje!

DRITON TALI: Të nderuar të pranishëm, nga se Kuvendi nuk ka qëndrim, të paktën deri më tani, atëherë ndoshta ekzekutivi ka në lidhje me vendimin e Qeverisë serbe të artikuluar nga ministri për Kosovën, zoti Sllobodan Samarxhiq, më 26 maj në Graçanicë, i cili deklaroi se më së voni brenda 10 ditëve, do me thënë deri më 5 qershor, do të formohen kuvendet komunale në ato komuna ku serbët më 11 maj kanë votuar në zgjedhjet lokale. Sipas tij, është shumë e rëndësishme ...

KRYETARI: I vazhdohet koha për diskutim deputetit Driton Tali!

DRITON TALI:... sipas tij, është shumë e rëndësishme që të krijohen kuvendet dhe këshillat ekzekutive, trupat të cilat do ta marrin qeverisjen e re lokale. Andaj, pyetja është kjo: Çfarë do të bëjë Qeveria, nëse një hap i tillë do të ndërmerret, e që sipas të gjitha gjasave, do të ndërmerret? A do të ndërmarrë diçka konkrete Qeveria së bashku me UNMIK-un, apo do të vazhdojnë edhe më tutje me deklaratat, derisa Qeveria e Serbisë vepron e papenguar në vazhdimësi dhe kundër ligjit?

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministri Ramë Manaj e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës ka qëndrim për këtë çështje edhe sot, edhe më herët. Për Kosovën dhe institucionet e saj, pra edhe për Qeverinë e Kosovës, përpjekjet e tilla janë jovalide, janë të papranueshme, janë të pazbatueshme.

Qëndrimi i Qeverisë së Kosovës ka qenë edhe para mbajtjes së zgjedhjeve dhe fatmirësisht është në akord të plotë me qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare. Unë po përkujtoj se edhe UNMIK-u zgjidhjet i kishte shpallë paraprakisht jovalide dhe të papranueshme. Sot, post-festum, po ashtu janë të papranueshme jovalide dhe nuk prodhojnë asnjë efekt juridik.

Edhe përpjekjet për ndërtim, respektivisht për implementim të rezultatit të këtyre zgjedhjeve, duke bërë përpjekje që të ndërtohen strukturat udhëheqëse në komuna do të

jenë të papranueshme dhe të tilla që nuk prodhojnë efekte juridike. Duket se janë një provokim i radhës për marketing politik të brendshëm në Serbi. Ju faleminderit!

KRYETARI. Ju faleminderit, zëvendëskryeministër! Ke pyetje shtesë? Fjalën e ka Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti zëvendëskryeministër, me gjithë respektin, por sipas të gjitha gjasave një vendim i tillë do të implementohet nga Qeveria serbe dhe mendoj se ne, por edhe Kuvendi duhet të kemi qëndrime konkrete pak më të ashpra për ta implementuar Ligjin dhe Kushtetutën, të cilën e kemi votuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mund të përgjigjet zëvendëskryeministri Ramë Manaj.

RAMË MANAJ: Nuk është çështja e ashpërsisë, është çështja që përpjekjet e tilla nuk do të jenë të implementueshme në Republikën e Kosovës dhe, thjeshtë, institucionet mbi bazën e këtyre zgjedhjeve nuk janë valide, janë të papranueshme dhe nuk do të mund të implementohen.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjala është për deputetin Naim Rrustemi. Doni të bëni pyetjen?

KRYETARI: Urdhëro, e keni fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit! Pyetja ime është në funksion të transparencës, me fjalë tjera, t'i drejtohem edhe opinionit publik. Çështja është te burgu i Mitrovicës. Çështja: me datën 19 shkurt 2008, një ditë para se të largohen punëtorët nga Gjykata e Qarkut dhe ajo Komunale në Mitrovicë, me urdhër të drejtorit të Burgut të Mitrovicës u bartën të burgosurit nga Burgu i Mitrovicës për në burgjet e tjera të Kosovës, konkretisht në Burgun e Dubravës.

Me datën 19 shkurt, punëtorëve shqiptarë të burgut u është thënë mos të shkojnë në vendet e tyre të punës dhe prej kësaj date punëtorët më nuk u kthyen në vendet e tyre, por u transferuan nëpër burgje të tjera të Kosovës.

Bartja dhe transferimi i të burgosurve është bërë ndaras në baza etnike. Janë transferuar vetëm të burgosurit shqiptarë dhe punëtorët shqiptarë nuk janë lejuar që të punojnë në vendet e tyre të punës në Burgun e Mitrovicës.

KRYETARI: Ju lutem, pyetja nuk është regjistruar. Ju e dini se i keni 2 minuta kohë dhe bëjeni pyetjen brenda afatit që e keni me Rregullore të punës!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Drita Maliqi... Më falni, fjala e Naimit vjen pas pyetjes së deputetes.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Jam e obliguar, edhe pse pyetja ime është e parashtruar për zotin Kryeministër, zotin Hashim Thaçi, mirëpo shpresoj që zëvendëskryeministri për momentin që është prezent, ka marrë leje të më përgjigjet në këtë pyetje. Pyetja është kështu: Vazhdimisht nëpër deklaratat tuaja keni deklaruar se do të qeverisni mirë dhe do t'i respektoni ligjet në fuqi dhe se nuk do të bëni spastrime në shërbyesit civil. Mirëpo, në praktikë po ndodh kundërta, siç është rasti në Kuvendin Komunal të Gjilanit. Kryetari i Kuvendit Komunal të Gjilanit, që vjen nga partia e juaj, përkundër PDK-së, sepse janë në koalicion, më falni zoti zëvendëskryeministër...

KRYETARI: Pyetja nuk mund të zgjatë më shumë se një minutë. Më falni, se unë gabova kur ceka 2 minuta, por koha për pyetje është një minutë. Pra, respektojeni kohën! Ju lutem, pyetjet i adresohen ministrit dhe të gjitha materialet i dërgohen ministrit përkatës.

Fjalën e ka Naim Rrustemi për ta bërë pyetjen. Një minutë kohë e keni. Respektojeni kohën!

NAIM RRUSTEMI: Unë do ta bëj pyetjen që nuk munda ta lexoj paraprakisht. Pyetja: A është bërë dorëzimi i burgut me instruksione apo me dijeninë e ministres së Drejtësisë dhe çka keni ndërmarrë deri më tani që të kthehet autoriteti i institucioneve legjitime të Republikës në institucionet e Shërbimit korrektues - ndëshkues të Kosovës, si pjesë e sistemit unik të drejtësisë në Republikën tonë, të përcaktuar me ligjet në fuqi. Kjo ishte pyetja paraprake.

Do të vazhdoj me pyetjen e dytë: Sfondi, që nga data, (aq sa më takon, më duhet të ngutem), që nga data 20 shkurt 2008 organet e judikaturës në Mitrovicë, Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut, si dhe Prokuroria Komunale dhe e Qarkut të Mitrovicës, me lokacion në pjesën veriore të qytetit, nuk janë duke funksionuar nga se organet kompetente vendore dhe ndërkombëtare, UNMIK-u, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor dhe organet e sigurisë, kanë ndaluar, pezulluar ofrimin e transportit për në vendet e tyre të punës, e që...

KRYETARI: A ka deputetë të tjerë që duhet t'i lexojnë pyetjet e tyre, sepse keni të drejtë me Rregulloren që t'i lexoni.

Esat Brajshori, ju nuk keni pyetje, andaj nuk mund të ta jap fjalën.

Unë po pyes për deputetët, të cilët kanë bërë pyetje. Unë nuk i kam në shënimet e mia, nuk të kam të regjistruar për pyetje kësaj radhe. Këtë do ta marrim parasysh në seancat e ardhshme. Luljeta Shehu, as ju nuk keni pyetje.

Drita Kadriu ka pyetje, Suzana Novobrdaliu, ka bërë pyetjen, Drita Maliqi, ka bërë pyetjen. Ju lutem, një minutë e keni për pyetje dhe nuk ka më pyetje të tjera.

Një pauzë prej 15 minutash dhe vazhdojmë pastaj seancën.

Pas pauzës, mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë.

KRYESUESI SABRI HAMITI: Thërras deputetët t'i zënë vendet e tyre, që të mund ta vazhdojmë punën.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punën

Në bazë të Rregullës 35. 1 të Rregullorës së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë Projektligjin.

Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsedavajući,
Poštovani zamenici Premijera,
Poštovani ministri,
Dame i gospodo, narodni poslanici,

Kao što već verovatno većina od vas zna, Nacrt zakona o radu je već bio u prošloj Vladi Kosova 2006. godine. 2007. godine je bio u Parlamentu i tada je iz Parlamenta povučen po preporuci nekih domaćih i stranih eksperata na dodatnu doradu.

Trenutno je na snazi Uredba 2001/27, koja sigurno ne ispunjava taj širok spektar potreba koje su utvrdjene za dobar zakon o radu i ova uredba konkretno ima 28 akata ili 28 amandmana, dok bi ovaj novi Nacrt zakona o radu sadržao 104, što samim tim i znači da je prošireno to samo delovanje Nacrta zakona o radu.

Još jedna stvar koja je vrlo bitna, je da ovaj Nacrt zakona o radu ima preporuku od strane Medjunarodne organizacije rada ILO-a, koji sigurno shvatite da je vrlo bitan i vrlo odgovarajući faktor koji može preporučiti sam jedan ovakav nacrt.

Svrha ovog zakona je da reguliše prava, obaveze i odgovornost nalogodavca i zaposlenih u okviru radnih odnosa i da osigura:

1. Ispravno sprovođenje sporazuma i preporuka Medjunarodne organizacije rada ili ILO,
2. Učvršćivanje rada Inspektorata za rad za eliminisanje ilegalnog tržišta za radne odnose sa naglaskom na sivo tržište rada,

3. Kreiranje balanca za osiguranje prava i interesa izmedju nalogodavca i nalogoprimaoca,
4. Izbegavanje negativnih posledica na radne odnose i eliminaciju mnogih nepravdi u procesu rada, a posebno u privatnom sektoru,
5. Stvaranje optimalnih uslova za interes za stvaranje organizacija koje se zalažu za interese zaposlenih i interese njihovih poslodavaca, i
6. Unapredjivanje drugih prava i beneficija iz radnog odnosa.

Samim tim, usvajanje ovog Nacrta zakona o radu će doprineti u znatnome, i ovo bi bila kao jedna osnovna baza, i ova baza bi doprinela sprovođenju ostalih sekundarnih zakona, kao što su:

- Zakon o Inspektoratu o radu,
- Zakon za osiguranje i zaštitu na radu,
- Zakon za povećanje zapošljavanja i zaštitu zaposlenih,
- Zakon za zaštitu žena,
- Zakon za prava i slobodu organizovanja sindikata,
- Zakon za evidenciju zaposlenih,
- Zakon za zapošljavanje stranih državljana kao i ostali zakoni koji regulišu određene segmente iz polja rada i zapošljavanja.

Poštovani narodni poslanici,

Kao što sam rekao, ovo je možda jedan od najbitnijih zakona koji postavlja temelj daljeg funkcionisanja našeg društva, a znamo da društvo ne može biti funkcionalno ukoliko zakoni na kojima radna snaga i radna klasa ima svoja zaštićena prava.

Prema tome, znam da ćete imati puno pitanja i znam da ćete imati puno sugestija i zato osoblje Ministarstva za rad i socijalnu politiku, tehničko osoblje Pravne službe je stalno na vašem raspolaganju da unutar radnih grupa Parlamenta doprinesemo daljim konsultacijama i pravljanju jednog zakona koji će stvarno biti osnova za buduće. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Hap debatin për diskutimin e ligjit në parim. Fjalën e ka Teuta Hadri, besoj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Urdhëroni, zonja Teuta!

TEUTA HADRI: Po, në emër të Grupit Parlamentar. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Projektligji i punës përbën një bazë të mirë për rregullimin e marrëdhënies së punës në Kosovë për sektorët që i përfshinë në vete.

Ky ligj ka qenë tepër i domosdoshëm kur dihet se kjo fushë deri më tani është mbuluar nga një Rregullore e UNMIK-ut 2001/27, që është përbërë vetëm prej 28 neneve në tërësi.

Ky fakt tregon se ka pasur zbrazëtira të theksuara në këtë fushë dhe në shumicën e rasteve ka pasur edhe shkelje drastike të të drejtave të punëtorëve.

Rëndësia e Projektligjit qëndron në faktin se ky projektligj, që e kemi para vetes, është një ligj bazik dhe sistemor për fushën që e rregullon.

Megjithatë, ky projektligj ka paqartësitë e veta, sepse nuk e ka bërë të qartë dallimin për kategoritë që i përfshin në vete. Këtu, në projektligj, thuhet se me të nuk rregullohen marrëdhënia e punës dhe beneficionet në shërbimin civil të Kosovës, ndërsa në anën tjetër, flitet për pagesat e kujdestarive dhe punën shtesë në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit.

Dihet mirëfilli se, tani për tani, në Kosovë, këta sektorë, sipas Rregullores 2001/36 bëjnë pjesë në kategorinë e shërbyesve civilë. Prandaj, mendoj se gjatë punës dhe përpunimit të tij në Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, do t'i eliminojmë këto paqartësi.

Në praktikën e deritashme është krijuar një diskriminim ndërmjet lehonave që punojnë në shërbimin civil të Kosovës dhe atyre në sektorin privat apo publik, për arsye se lehonat në sektorin civil, pushimi i lehonisë për tre muajt e dytë, nga gjithsej gjashtë muaj që ka pushimi i lehonisë, u paguhen nga një fond i veçantë – i ndarë në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, sipas një aneksi të Kontratës kolektive që pushimi i lehonisë të paguhet vetëm në sektorin civil. Mendoj se ky është një diskriminim i hapur, që është krijuar dhe Projektligji që sot kemi para vetes eliminon këtë padrejtësi të madhe dhe të pakuptimtë.

Meqenëse, së shpejti, përgatitet edhe Ligji për shërbyesit civilë, si ligj i veçantë, ku te kjo kategori përfshihen të gjithë ata që kanë marrëdhënie pune: në arsim, shëndetësi dhe shërbime tjera civile, besoj që edhe brenda këtij ligji do të ketë mirëkuptimin e rëndësisë së tij.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e pranon këtë projektligj si të veçantë dhe duke u përgatitur në bazë të standardeve ndërkombëtare do t'i korrigjojë të metat e tij, si anëtarë që jemi në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hadri! Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka fjalën deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra dhe kolegë deputetë,

Ky projektligj rregullon krijimin e marrëdhënies së punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, krijimin e kushteve dhe standardeve më të mira të punës, mbrojtjen e të drejtave ekonomike- profesionale, sociale për punonjësit, avancimin dhe zhvillimin e dialogimit social ndërmjet partnerëve social, eliminimin e formave të diskriminimit etnik, racor, fetar, gjinor, politik, kulturor, sindikal, si dhe çështjet tjera të rëndësishme nga marrëdhënia e punës në Kosovë.

Projektligji parasheh shfuqizimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 e cila rregullore ka përcaktuar që shërbyesit civilë janë të gjithë ata shërbyes civilë që marrin paga prej buxhetit të konsoliduar të Kosovës, kurse me këtë projektligj, që ka një qasje të re të rregullimit, nuk parashihet që marrëdhëniet e shërbyesve civilë të rregullohen me këtë ligj, sepse Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Shërbimeve Publike kanë hequr të punësuarit e arsimit dhe të shëndetësisë, të cilët do të përfshihen me këtë qasje të re të këtij ligji për punën.

Është nevojë imediate që të kemi një ligj bazik dhe sistemor të punës në Kosovë, që mundëson eliminimin e dukurive të shumta të kundërligjshme, të cilat janë të shprehura në marrëdhëniet e punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në aspektin e përgjithshëm, Projektligji i punës është në pajtim me konventat ndërkombëtare të punës dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por për t'i plotësuar kriteret më të specifikuara ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, nga ky ligj bazik dhe i përgjithshëm, konsideroj se duhet nxjerrë edhe ligje tjera më specifike, si për shembull:

1. Ligjin për mbrojtje në vendin e punës,
2. Ligjin për të drejtat e sindikatës,
3. Ligjin për organizatat publike dhe
4. Ligjin për librezat e punës, të cilat duhet të kenë strukturimin elektronik.

Megjithëkëtë, çështjet që adresohen nga ky projektligj i punës, janë:

- Rregullimi dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin privat dhe publik,
- rregullimi dhe përcaktimi i orarit të punës, pushimeve dhe mungesa e nga puna,
- rregullimi i mbrojtjes dhe sigurisë në punë,
- rregullimi i kompensimit të pagës dhe benificionet tjera për të punësuarit,
- përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës,
- rregullimi i lirive dhe të drejtave sindikale, si dhe çështjeve tjera të rëndësishme, duke përfshirë edhe ato çështje administrative.

Projektligji, në përgjithësi, ka 15 kapituj dhe 104 nene, të shkruara mirë dhe të strukturuar në mënyrë të drejtë.

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Projektligjin për punë në lexim të parë në nëntor të vitit 2006, me rekomandime që disa dispozita të caktuara të rishqyrtohen dhe Projektligji

është shqyrtuar nga Komisioni i Shëndetësisë, Pumës dhe Mirëqenies Sociale të Kuvendit të Kosovës me përkrahjen e ekspertëve të lartë ligjorë nga Sllovenia dhe me përkrahjen e Institutit Nacional Demokratik, por për shkak të implikimeve të larta buxhetore që parashihen rreth 23 milion euro në vit, ka mbetur i papërfunduar dhe tani, edhe një herë, në legjislaturën e tretë, i është kthyer Kuvendit të Kosovës në shqyrtim.

Për këtë projektligj nuk është paraparë kostoja buxhetore në kornizën afatmesme për 3-4 vjetët e ardhshëm, prandaj mbetet që në rishikimet e brendshme të buxhetit të Kosovës të plotësohen obligimet ndaj këtij projektligji.

Për këtë projektligj janë mbajtur dëgjime publike në mandatin e kaluar, është punuar në grupe të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe disponojmë me shumë materiale nga profesionistët dhe përfaqësuesit e organizatave publike, private që dëshirojnë të kontribuojnë për ta kompletuar Projektligjin për punën.

Duke ditur rëndësinë e këtij projektligji, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrah në parim dhe ne do të japim kontributin tonë në përpunim të mëtejshëm të këtij projektligji.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hulaj! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, e ka fjalën deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Kemi përpara një projektligj për punën, që parimisht është i mirëseardhur.

Unë kam disa vërejtje parimore. Ka shumë shprehje joprofesionale. Ka shumë gabime drejtshkrimore. Në të tri gjuhët janë tri versione që nuk mund të tolerohen assesi dhe këto duhet unifikuar, sepse është fjala për një ligj që do të aplikohet në një vend të caktuar.

Emërtimi nuk është adekuat, sepse nuk është fjala për Ligjin për punën, se puna është një fenomen socio-ekonomik e tjera, por për marrëdhënien e punës. Marrëdhënia e punës është raport juridik ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit e në raportin juridik përcaktohen autorizimet dhe obligimet e aktorëve, prandaj krejtësisht është fjala për marrëdhënien e jo për punën dhe kjo do të duhej rishikuar dhe riformuluar.

Ky ligj do të duhej të ishte themelor, ju lutem, për marrëdhënien e punës, e më pastaj të pasonte një numër i konsideruar i akteve që do t'i specifikonin fushat që janë më të veçanta.

Në këtë ligj thuhet se nuk rregullohen marrëdhëniet e punës në KFOR, por kjo është qesharake. Dihet fare mirë se KFOR-i është një institucion politik-ushtarak ndërkombëtar

dhe janë këto rregulla elementare, prandaj nuk do të duhej të thuhej fare, sepse është edhe e ditur, apo për Korin diplomatik, e tjera.

Në nenin 1, paragrafi 2, thuhet, ndër të tjera, po e zëmë që “në vendin tonë dhe kategoritë tjera specifike”, po cilat janë ato? Kurrësi nuk mund të jetë kjo shprehje e referateve politike. Ky është ligj, dokument, këtu duhet precizuar në mënyrë koncize dhe nuk mund të lejohet shprehja e tillë. Ka edhe shprehje tjera të tilla dhe këto në praktikë do të paraqitnin probleme.

Te kontrata kolektive, nuk mund të jetë Qeveria indiferente dhe indolente, po e zëmë, apo e përjashtuar. Qeveria kudo duhet të jetë një nga aktorët e kontratës kolektive – përfaqësuesit e punëdhënësve, të punëmarrësve edhe Qeveria, sepse tek e fundit, kush do ta implementonte, pos ekzekutivit.

Nuk është thënë as në paragrafin 5 dhe as në fund, kur flitet për atë paktin social.

Te paragrafi 1, neni 4. Ju lutem, thotë: “I punësuarit gëzon të drejtën për pagë, mbrojtje dhe siguri në punë, pushim vjetor dhe pushime tjera”. Do të thotë, kjo është konform me atë që u tha pak më parë. Cilat pushime? Nuk bën kështu dhe kjo duhet të plotësohet dhe të koncizohet.

Bie fjala, te paragrafi 3. Ju lutem, pjesë – segment po e them “të punësuarit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndërmjet përfaqësuesve të tyre gëzojnë të drejtën për informim dhe deklarim të qëndrimeve të veta për çështje esenciale”. Cilat janë çështjet esenciale? Meqë, këtu vjen në shprehje interpretimi i mundshëm- arbitrar, nuk është kjo esenciale. Kjo është esenciale, hapen konteste e tjera, që kushtojnë shumë.

Në nenin 9, “Themelimi i marrëdhënies së punës për shtetasit e huaj rregullohet me ligj të veçantë”. Sipas kësaj do të duhej të bënim shumë ligje, që s’ka nevojë. Me 2-3 dispozita kjo do të mund të rregullohej këtu, në këtë ligj dhe do të evitohej mundësia dhe nevoja e bërjes edhe të një ligji tjetër. Fundi i fundit, është parimi i reciprocitetit dhe janë disa rregulla të ILO-s që është Organizatë Ndërkombëtare për Punën dhe ato do të duhej inkorporuar dhe me këtë do të zgjidhej edhe kjo çështje.

Në nenin 12, thuhet: “në rast të kalimit të pronësisë apo të funksionimit të një ndërmarrjeje”, ekziston një ligj i cili quhet Ligji për organizatat biznesore. Ky term ekziston vetëm për ndërmarrjen që quhet biznes personal, ndërmarrje e biznesit personal. Për kompanitë dhe për korporatat nuk ekziston termi – ndërmarrje. Prandaj, do të duhej, gjithmonë, ligjet që kanë të bëjnë me njëri -tjetrin që preken, të harmonizohen shprehjet dhe të mos krijohen shprehje të ndryshme se pastaj paraqiten edhe probleme serioze të interpretimit.

Pra, këtu do të duhej të thuhet “organizatë biznesore” që është shprehje gjenerike dhe i përfshin të gjitha. Sikur të mbetej “ndërmarrje” do të ishte fjala vetëm për biznesin personal dhe ne e dimë fare mirë që është biznesi personal e sa janë organizata tjera të formave, sidomos shoqëritë aksionare.

Ju lutem, neni 20, paragrafi 1, “në raste të jashtëzakonshme me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste tjera të domosdoshme”, kjo është shprehje që nuk ka nevojë të komentohet në cilat raste tjera të domosdoshme. Ato duhet taksativisht, sipas enumeracionit të përcaktohen.

Thotë, bie fjala, te paragrafi 3 i nenit 20: “Inspektori i punës e ndalon punën jashtë orarit”. Kjo do të ishte një zgjidhje shumë e volitshme për ata dhe për ato që abuzojnë edhe me ligjin edhe me të drejtat themelore të punëtorit. Domethënë, do të kishin abuzuar, do të kishin tejkaluar të gjitha normat dhe inspektori në instancën e fundit do ta kishte ndaluar. Kjo nuk duhet të mbetet kësisoj. Ato akte duhet të sanksionohen, sepse do të ishte favorizim i paligjshëm dhe i parregullsisë.

Neni 33, paragrafi 3, thotë mirë “i punësuar nuk mund të heqë dorë nga e drejta e shfrytëzimit në pushimin vjetor”. Kjo është në rregull. Paragrafi 4 do të duhej të binte, sepse është i panevojshëm, sidomos kur thuhet “marrëveshja për heqje dorë” e tjera do të ishte nule. Natyrisht, kur thuhet nuk ka të drejtë, atëherë nuk do të mund të bënte marrëveshje të tillë dhe marrëveshja e tillë do të ishte e papranueshme, domethënë nule do të ishte dhe s’ka nevojë- është pleonazëm – tautologji.

Te neni 47, paragrafi 1 “femra e punësuar gjatë kohës së shtatzënisë dhe lindjes ka të drejtë për pushim lehonie prej së paku 6 muaj”. Me ligj precizohet 6 muaj, jo të paktën. Dhe askund nuk thuhet më pastaj, e tjera.

Te neni 47, paragrafi 6, termi “adaptues” duhet të zëvendësohet me “adoptues”. Është adoptim kur e pranon fëmijën, ndërsa adaptim kur e bën meremetim këtë sallë.

Ju lutem, te neni 66, paragrafi 3, thuhet “në qoftë se një grup i punëtorëve do ta shkaktonte një dëm, e në qoftë se nuk do të mund të konstatohet se kush është fajtor, atëherë proporcionalisht në mënyrë ekuivalente duhet ta kompensojnë”. Do të ishte krejtësisht zgjidhje e papranueshme, abuzive dhe arbitrare sidomos në disfavorin e atyre që nuk do të ishin fajtorë apo do të ishin më pak fajtorë. Dhe, ta marrim një rast, po e zëmë se nga një dispozitë mund të flitet shumë por shkurt, sepse është me rëndësi kjo për praktikën. Po e marrim se grupi prej 5 vetave, njëri le ta ketë pagën 1.000 euro, tjetri 700 euro, tjetri 200 euro e kështu me radhë, a do të ishte korrekte dhe humaniste që të paguhen proporcionalisht edhe ata që do të kishin pagën 5 herë më të ulët, sepse supozohet apriori se përgjegjësia e tyre do të ishte 5 herë më e ulët, prandaj do të duhej riformuluar- ka rregulla për zhdëmtimin dhe termat ku thuhet “me dashje, a paramendim”, këto nuk mund të qëndrojnë, meqë ka terma adekuat sa i përket zhdëmtimit në procedurë.

Te “dialogu social”, është dhënë njëfarë formulimi krejtësisht i paqartë dhe i pakuptueshëm që krijon konfuzion referuar kontratës kolektive. Edhe këtu përjashtohet Qeveria dhe do të duhej të inkludohej Qeveria, sepse ajo duhet të jetë një nga aktorët e bërjes së kontratës e më pastaj edhe e implementimit të kontratës.

Te neni 93, ku janë për caktuar masat disiplinore të mundshme, nuk është thënë edhe – largimi nga puna. Largimi nga puna do të ishte një ndër masat disiplinore për shkelje të rënda disiplinore. Sepse, tamam do të ishte sikur të mos kishte të drejtë për ta larguar punëtorin e papërgjegjshëm, të pandërgjegjshëm, të padisiplinuar e që do të shkaktonte ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Smaka, a harxhove kohën, a ke mendim përmbyllës, të lutem? Ia jepni edhe një gjysmë minute, apo një minutë.

RIZA SMAKA: Ju lutem, te neni 96, ekziston Ligji për Inspektoratin e Punës.

KRYESUESI: Rezume, zoti Smaka, sepse e keni harxhuar kohën.

RIZA SMAKA: Po, rezume se tash përfundon kjo. Ju lutem te neni 96, ekziston Ligji në fuqi- në aplikim 2002/9 për Inspektoratin e Punës, e këtu janë dhënë disa formulime që me këtë ligj nuk do të mund të ndryshohej ai ligj, sepse është ligj i veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nejse, ju mund të mos deklarojeni, por s'e the a jeni për a kundër?

(Ndërhyrje – pa kyçe të mikrofonit)

Pra, je deklaruar në fillim. Mirë, faleminderit! Fjalën e merr, në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

të çmuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për punën. Ka qenë nevojë imediate e hartimit të një ligji bazik dhe sistemor, në mënyrë që të rregullohet në bazë ligjore krijimi i marrëdhënies së punës, marrëdhënia e punës në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, krijimi i kushteve dhe konditave më të mira për punë, sigurisë në punë, të drejtave ekonomike, sociale, profesionale të punonjësve, avancimi i dialogut social në mes të partnerëve social dhe eliminimin e të gjitha formave të mundshme të diskriminimit, si dhe eliminimin e dukurive të shumta të kundërligjshme që janë përditshmëri në marrëdhëniet e punës në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit në Kosovë.

Ky projektligj adreson edhe çështje të tjera tejet të rëndësishme që përfshinë, qoftë sektorin publik apo atë privat.

Por, sa do të jetë shkalla e zbatimit të këtij ligji në praktikë, është një dilemë e madhe dhe edhe nga Deklarata financiare që ka ardhur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave paraqiten paqartësi bile edhe rrezeqe, i kanë quajtur ata.

Po e citoj Deklaratën financiare:

“Në buxhetin e aprovuar për vitin 2008 kostoja shtesë buxhetore prej 560.000 eurove nuk është përfshirë dhe si e tillë paraqitet e pafinancuar”.

“Edhe kostoja shtesë”, po citoj, “e Projektligjit të punës për vitin 2009-2010 nuk është e planifikuar dhe e përfshirë në projeksionet e buxhetit 2009-2010, sikurse që nuk janë planifikuar as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve të periudhës 2008-2010”.

Po citoj prapë: “Në rast të mungesës së mjeteve buxhetore”, thotë Deklarata financiare më tutje, “nga ana e institucioneve që ndikohen me këtë ligj për financimin e koston shtesë, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të rekomandojë dhe të sigurojë burimin e financimit, në të kundërtën, ligji do të ketë vështirësi gjatë zbatimit”.

Po ashtu, ka edhe konfuzitet sa i takon opinionit të përafrimit të këtij ligji me legjislacionin e BE-së.

Po e citoj Deklaratën e Agjencionit për Integritet Evropian të Qeverisë së Republikës së Kosovës: “Projektligji i punës nuk mbulon të gjitha aspektet e legjislacionit evropian, por është i kufizuar vetëm në disa prej tyre”. Atëherë, është nevojë imediate që të hartohen edhe ligje konkrete derivative të cilat i mbulojnë aspektet e dikastereve të caktuara dhe të cilat kanë, bile së paku përafrim me *acquis communautaire* dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e përkrah në parim këtë projektligj, me sugjerimet dhe vërejtjet që i potencuam, e që duhet të merren për bazë nga grupet punuese dhe Komisioni funksional, si dhe kontributin tonë do ta japim gjatë procedurave të amendimit të këtij projektligji.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari kryesues, zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Sot po shqyrtojmë Projektligjin për punën, i cili i përcakton të drejtat e personave që janë të punësuar në sektorin privat.

T’ju them të drejtën, unë më me dëshirë do të kisha diskutuar sot për strategjinë e Qeverisë për punësim, duke marrë parasysh shkallën rekorde të papunësisë në Kosovë, por, si duket, kjo qeveri nuk e ka këtë lloj strategjie, prandaj ne po e diskutojmë sot projektligjin.

Një gjë dëshiroj ta sqaroj që në fillim. Ky ligj nuk e trajton papunësinë. Ky ligj nuk e trajton lartësinë e pagave të punëtorëve. Ky ligj nuk do të kontribuojë në rritjen ekonomike në Kosovë dhe ky ligj nuk e përmirëson situatën e pensionistëve.

Ky ligj, të nderuar kolegë, është një tentim nga Qeveria që t'i bëjë njerëzit të mendojnë se Qeveria është duke bërë diçka për punëtorët dhe është pjesë e strategjisë mediale që e zhvillon Qeveria. Por, në të vërtetë, situata ekonomike vetëm sa po ashpërsohet, vende të reja të punës nuk ka, produktet ushqimore po shtrenjtohen, gjendja sociale po keqësohet.

Qeveria pretendon që me këtë ligj do t'i zgjidhë këto probleme, por kush e lexon këtë ligj, do të gjejë më shumë dogmë, definicione për terma teorike se sa zgjidhje praktike të problemeve që ka Kosova. Kush mendon që me terma teorike dhe referenca në konventa do të përmirësojë gjendjen e tanishme të papunësisë, nuk ka pjekuri politike.

Të mos keqkuptohemi, ne jemi për mbrojtjen e vërtetë të punëtorëve, por jemi kundër demagogjive.

Standardet e mbrojtjes në punë nuk arrihen nëse ne e aprovojmë këtë letër, ato arrihen nëse e zbatojmë në praktikë.

Le të na tregojë ministri sot, këtu konkretisht, se cilat janë avantazhet e këtij ligji krahasuar me rregulloren që e kemi pasur. Jam e bindur plotësisht se nuk do të jetë në gjendje ta shpjegojë, sepse Qeveria nuk ka koncept për zgjidhjen e problemeve dhe në vend të zgjidhjeve konkrete - sjell këtë ligj.

Raporti i fundit i UNDP-së për paralajmërimin e hershëm tregon qartë brengat e njerëzve. Sipas këtij raporti, njerëzit ankohen se nuk kanë punë, se nuk kanë sigurim shëndetësor dhe nuk kanë perspektivë për punë. Këto janë probleme prioritare që duhet të trajtohen. Ato, këtu, nuk trajtohen.

I nderuari ministër,

Ju lutem, na tregoni statistikën, sa ndërmarrje i keni gjobitur që nuk i kanë lajmëruar të punësuarit? Ose, sa nga ato janë gjobitur, nëse nuk kanë pasur kontrata pune me punëmarrësit? Ligji për këtë ekziston, por nuk zbatohet. Njerëzit punojnë pa kontrata dhe stazhi i punës nuk u ecë, kontributet pensionale dhe tatimore nuk përmbushen. Kjo i dëmton punëtorët dhe buxhetin. Me çfarë neglizhence iu keni qasur kësaj çështje, tregon edhe fakti se në definicionin për punëdhënësin e përcaktoni se – punëdhënësi, sipas këtij ligji, është vetëm ai që i paguan paga punëtorit. Sipas kësaj, punëdhënësi që nuk paguan paga ose që ka punësuar njerëz në të zezë, nuk ka obligim t'iu përmbahet detyrimeve të këtij ligji.

Për punë provuese, ky ligj parasheh një afat prej 3 muajsh dhe verifikimi i suksesit në punë do të bëhet nga një komision i veçantë. Paramendoni, një punëdhënës duhet të ngritë komision të pavarur që të vlerësojë nëse punonjësi që është në punën provuese i ka kryer punët në mënyrë të suksesshme. Këtë dispozitë do ta adhurojë ekonomia.

Pastaj, kemi absurditet tjetër në nenin 16, ku kontrata e kufizuar mund të jetë maksimalisht 12 muaj, e zgjatur deri në 36 muaj dhe, pas kësaj, përjetësisht. Këtë luks nuk e kanë momentalisht as shërbyesit civil. Edhe kjo dispozitë do të adhurohet nga ekonomia sikurse edhe dispozita e radhës e cila përcakton se java e punës është maksimalisht 5 ditë. Ka edhe dispozita të tjera, por koha e kufizon.

Zonja dhe zotërinj,
Ky ligj ka ndikim direkt në ekonomi.

Grupi Parlamentar i Aleancës është për një ligj të punës, por kërkon qasje tjetër, qasje serioze.

Ne kërkojmë që Qeveria të përgatisë një memorandum me sqarime se si do ta financojë këtë ligj dhe çfarë impakti ky ligj do të ketë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Atëherë, ne do të deklarohejmë lidhur me përkrahjen e këtij ligji. Tani për tani, nuk e përkrahim në parim.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Gjylnaze. Në emër të Grupit “7+”, fjalën e merr deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Kolege poslanici, deo kabineta,

Ja govorim u ime Grupe „7+“ a takodje i u ime predsednika Komisije, koja je funkcionalna za ovaj zakon – Komisija za rad, zdravlje i socijalnu negu.

Komisija je, prije nego što je stigao ovaj zakon ovde, imala jednu raspravu i zauzela stav da će se angažovati kako bi ovaj Nacrt zakona bio bolji i da će raditi ono što može kao komisija da uradi i da će organizovati javne debate, da će napraviti jedan dijalog sa sindikatom, sa poslodavcima, sa onim zainteresovanim stranama, prije svega sa većim kompanijama. Takodje ćemo angažovati i eksperte da bi napravili jednu bolju analizu za ovaj zakon. Znači, ovaj zakon je jedan od bazičnih zakona, osnovnih zakona i mislim da je i u prethodnom mandatu bio prošao prvo čitanje, ali je nakon toga zaustavljen zbog nekih problema, odnosno budžetskih implikacija.

Ja bih danas, znači onima koji su ponudili ovaj zakon – predlagačima, postavio jedno pitanje, jer ćemo imati nekoliko dilema koje su pojedini poslanici ispred svojih grupa izneli, posebno iz LDD i još nekih drugih, a to su dileme jer ovaj Nacrt zakona ima budžetske implikacije. Mora vlada jasno da se odredi da li će, ukoliko se usvoji ovaj zakon, moći da ga pokrije. Ona to ne garantuje u memorandumu objašnjenja, u kojem se navodi da ovaj zakon od prilike u naredne 3 godine ima oko 14-15 miliona dodatnih troškova budžetske implikacije.

Bez amandmana, a možda će neki amandmani možda će zahtevati dodatne implikacije. Istovremeno tražimo i od Komisije za budžet koja bi trebalo u početnoj fazi, znači nakon prvog čitanja, da da svoje mišljenje – da li ovakav ponudjeni zakon može da ide i da se

ne dogodi ono što se dogodilo sa zakonom o profesionalnoj orijentaciji i zapošljavanju osoba sa ograničenim sposobnostima i da nakon našeg rada u Komisiji, taj zakon zaustavljen zato što ima budžetske implikacije, ne preko amandmana, to je vrlo malo, nego u ponudjenom osnovnom zakonu ima budžetske implikacije.

Znači, to je jedna dilema sa kojom smo suočeni i koju moramo imati u vidu prije nego što Komisija zaista započne da radi i prije nego što Komisija uključi i angažuje ljude eksperte, organizuje javne debate jer ćemo pozivati ljude i da to ne bude sutra kao zakon je uradjen a kod drugog čitanja da se zaustavi jer ne može da se prebrode ti rizici koje navodi i sam ponudjač zakona.

Osim ovoga, zakon će naići na problem u realizaciji odredjenih stavki, ako bude i usvojen, zato što u ovom trenutku mi nemamo fond za zdravstveno osiguranje i u opšte fond zdravstveni, sa kojim bi se moglo sklapati neki odnosi prilikom porodijskog odsustva, bolovanja i tako dalje.

Ovde još jedan problem je što ovaj zakon može da bude zaustavljen u onim sverama gde nije još definisano da li su javni službenici – civilni službenici obuhvaćeni ili nisu. Ovde stoji da nisu. Od prilike 74 ili 75 hiljada koliko ima Kosovo civilnih službenika, nego će to biti regulisano nekim drugim zakonom. Medjutim, interpretacija Ministarstva za rad i socijalu, govori da iz ovoga su izuzeti radnici obrazovanja i zdravstva, i tu moramo imati jasnu sliku da li su ovi radnici u obrazovanju i zdravstvu službenici – civilni službenici ili nisu. To je bitno znači, zato što možda najveći broj budžetskih implikacija pada na ove radnika jer je to taj dodatni rad – rad noću, rad u vreme praznika, posebno u zdravstvu i tako dalje, i porodijsko odsustvo koje je takodje vezano i koje mora biti definisano.

Inače, zakon je uradjen u skladu sa evropskim zakonodavstvom, mada u izveštaju odnosno mišljenju koje daje Agencija za evropske integracije stoji da nije kompletan. Nije kompletan zato što su potrebni novi zakoni jer evropsko zakonodavstvo ovu oblast reguliše sa još drugim dodatnim zakonima, što će verovatno ova vlada da ponudi.

Kada je u pitanju ovaj zakon, on je uradjen u tom skladu i mislim da su uzeti zakoni iz okruženja, iz Hrvatske, Slovenije a možda iz Srbije, ne znam, i da ovaj zakon nije loše uradjen ali postoje odredjeni rizici na koje treba da se odgovori.

U svakom slučaju, Grupa „7+“ će ovaj zakon u načelu podržati, a Komisija, kojom rukovodim i na čijem sam čelu, dati sve od sebe da napravi jedan bolji zakon koji je zaista potreban Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin SLS nuk është paraqitur askush. Fjalën e merr deputetja Mimoza Ahmetaj.

(Ndërhyrje)

Më falni, tani paraqitet Radmila Vujoviq, besoj në emër të SLS'së.

RADMILA VUJOVIĆ: Uvažena gospodo,
Parlamentarna grupa SLS, u načelu podržava prvo razmatranje Zakona o ragu, s tim što će iskoristiti pravo da prema realnim potrebama, kroz Komisije, dostavi primedbe i sugestije. Hvala!

KRYESUESI: Falënderoj zonjën deputete! Në listë e pata deputeten Mimoza Ahmetaj. Urdhëroni, zonja deputete.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuari zoti zëvendëskryeministër,
I nderuari ministër,
Të nderuar deputetë,
Ligji për punën është një ligj më se i domosdoshëm për rregullimin e raporteve punëdhënës dhe punëmarrës, gjë që i ka munguar shtetit tonë deri më tani.

Me këtë ligj rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga puna dhe marrëdhëniet e punës në Republikën e Kosovës, në pajtim me konventat ndërkombëtare.

Në përpilimin e Ligjit kanë marrë pjesë ekspertë të ndryshëm, njohës të kësaj fushe – çështjes së punës.

Për hartimin e ligjit janë marrë për bazë ligji kroat dhe ligji slloven i punës.

Duke analizuar ligjin, dalin disa të mira që vijnë nga ky ligj, duke u nisur nga fakti se gratë shtatzëna kursehen nga orari i zgjatur i punës, nënat me fëmijë me nevoja të posaçme, gjithashtu, do të kursehen nga ky orar i zgjatur, pastaj nuk do të bëjnë punë të vështira që e dëmtojnë shëndetin e nënës dhe fëmijës. Pjesë e mirë e këtij ligji është edhe shfrytëzimi i pushimit të lehonisë edhe për nënat të cilat i adoptojnë fëmijët njëjtë sikurse nënat që lindin si dhe mundësitë që pushimi i lehonisë të shfrytëzohet edhe nga i ati, por në kushte të caktuara, domethënë në raste të braktisjes së foshnjës nga nëna ose vdekjes së nënës, si dhe mundësisë që në tremujorin e dytë i ati, domethënë, ta shfrytëzojë pushimin e lehonisë në vend të nënës.

Ajo, që mendoj do ta plotësonte këtë ligj është edhe mundësia që nënës, në marrëveshje me punëdhënësin, t'i takojnë përveç 6 muaj sa janë me ligj të garantuara atij t'i takojnë edhe 3 muaj pushim pa pagesë ose të punojë me orar të shkurtër deri sa fëmija të jetë 9 muaj ose 1 vit. Një gjë e tillë do të kishte efekt të dyfishtë pozitiv. Në njërën anë, numri i lindjeve, që ka shënuar rënie viteve të fundit në Kosovë, do të rritej, duke ditur se Kosova prinë me natalitet të lartë në Evropë dhe që është pjesa më vitale e shtetit tonë, si dhe efekti tjetër, do të ishte se gratë, edhe ashtu të pakta që janë të punësuar, nuk do të ndërpresin marrëdhënien e punës e që, jo rrallë, e kanë bërë një gjë të tillë për shkak të kushteve të pavolūtshme të pagesës së pushimit të lehonisë.

Vetëm sa për krahasim, shumë nëna, sigurisht, nuk e kanë harruar që në Serbi, për shembull me lindjen e tretë shteti iu ka mundësuar nënave pushim të lehonisë deri në 3 vjet me të vetmin qëllim të rritjes së natalitetit në vend.

Ligji ua ndalon punën personave më të rinj se 18 vjet ose iu lejohet personave më të rinj se 18 vjet të punojnë vetëm punë të caktuara që nuk do ta dëmtojnë shëndetin e fëmijëve.

Me ligj, gjithashtu, obligohet punëdhënësi të krijojë kushte të sigurta të punës për punëmarrësin, të mos ekspozojë punëtorin në kushte të rrezikshme apo ta informojë paraprakisht atë për rrezikun në punë.

Ligjin e bën të mangët mungesa e sigurimit shëndetësor që Kosova ende nuk e ka.

Gjithashtu, me këtë ligj, nuk do të duhej të bëhej kategorizimi i punëtorëve apo të veçoheshin kategoritë që i përfshinë ligji dhe ato që nuk përfshihen në të siç janë: shërbyesit civil, të punësuarit, të emëruarit dhe anëtarët në TMK, si dhe çështja e punëtorëve arsimorë, shëndetësorë dhe punëtorëve në gjykata.

Në ligj do të duhej të ndalohej përdorimi i dhunës fizike në vendin e punës, ashtu siç ndalohet ngacmimi seksual në nenin 6. pika 7. Rastet e tilla të dhunës fizike në punë nuk janë të pakta. Një rast të tillë e kemi pasur kohë më parë kur drejtoresha menaxhuese e Termokosit, zonja Fllanza Pula është sulmuar fizikisht me çekan në vendin e punës nga kryearkëtari i po kësaj kompanie, zoti Liman Limani.

Ligji ka implikime buxhetore si dhe paqartësi kur është puna e pagesës së pushimit të lehonisë, domethënë 3 muajt e dytë, që është 70% nga paga e të punësuarës e që bie në Fondin e Sigurimit Shëndetësor, duke ditur se fondi, si i tillë, nuk është themeluar dhe nuk dihet statusi i tij në ndikimin e buxhetit të Kosovës.

Do të shtoja edhe diçka. U bënë vërejtje edhe në lidhje me rritjen e varfërisë, rritjen e papunësisë. Do të thosha që nivelin e papunësisë në Kosovë nuk e ka rritur kjo qeveri për pesë muaj. Nivelin e lartë të papunësisë, nivelin e lartë të varfërisë deri në 50%, nivelin e varfërisë ekstreme deri në 15% , ashtu siç e vlerësojnë organizmat ndërkombëtar e kemi gjetur ne të lënë trashëgim nga Qeveria e kaluar.

Në parim, e përkrahim ligjin, me të drejtë që brenda Komisionit ta amendojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur zonja Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues! Unë besoj se kolegët e mi do të pajtohen që arsyeja që jemi këtu është për ta bërë një ligj më të mirë. Esenca e këtij projektligji, të nderuar deputetë, është se ligji duhet të jetë i mirë për ekonominë dhe t'i kontribuojë rritjes së punësimit. Kjo është esenca e ligjit. Kjo ishte vërejtja ime. Faleminderit!

KRYESUESI: Me nder qofsh, zonja deputete! E merr fjalën Myrvete Pantina, deputete e LDK-së.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me qëllim të eliminimit të dukurive të shumta të kundërligjshme, të cilat janë dukuri të përditshme në marrëdhëniet e punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, mendoj se është më se i nevojshëm miratimi i Projektligjit të punës.

Edhe pse mendoj që ky projektligj është mjaft përmbajtjesor, megjithatë ka hapësirë për të bërë plotësime dhe ndryshime.

Për mua, një pyetje e madhe do të ishte se, a do të mund të implementohet ky ligj, duke pasur parasysh implikimet buxhetore që i sjell ky projektligj në zbatimin e tij.

Një vërejtje konkrete e kam për nenin 11. Ky nen ka të bëjë me përmbajtjen e kontratës së punës. Në kuadër të pikave që përfshihen në kontratën e punës, mendoj se duhet shtuar edhe një pikë, e kjo do të ishte: Korrigjimi i pagës me normën e inflacionit të paparashikuar, që mund të shfaqet gjatë periudhës për të cilën është nënshkruar kontrata, meqë një inflacion i tillë zhvlerëson pagën reale. Një problem të tillë e kemi edhe ne aktualisht, me të cilin ballafaqohemi edhe ne në këta muajt e fundit dhe kjo natyrisht se ndikon në zhvlerësimin e pagave të gjithë atyre që e kanë kontratën për periudhën e caktuar kohore.

Do të ndalem edhe te neni 60, ku thuhet se “i punësuar ka të drejtë të kompensimit të pagës gjatë kohës së pushimit mjekësor”, por me këtë nen, nuk jepet sqarimi se kush e paguan kompensimin në këtë rast.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Unë kam një vërejtje të vogël që t’ju tërheq vëmendjen se është leximi i parë dhe ekzistojnë 4-5 komisione që do të merren për lexim të dytë. Ju kisha lutur, të diskutoni në parim. Fjalën e merr deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje zëvendëskryeministër,

Përsëritje, zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë për bazë Projektligjin që është ofruar sot për punën dhe duke ditur rëndësinë që ka Projektligji sidomos për klasën punëtore e cila për çdo ditë në mënyrën më të vrazhdët po shfrytëzohet nga punëdhënësi, duke punuar me orar enorm, duke punuar gjatë kohës së natës, duke punuar gjatë festave, duke punuar pa ndonjë pagë të siguruar me asnjë ligj dhe duke pasur parasysh se nuk e din fare se kur do t’i përfundojë marrëdhënien e punës, sepse shumica e kanë të parregulluar marrëdhënien e punës, po i ngrit vetëm disa nga këto çështje, mirëpo paraprakisht, desha t’i qartësoj disa çështje që

u dëgjuan këtu në Parlament, le të mos pretendohet, sepse Projektligji e rregullon në mënyrë decisive çështjen e marrëdhënies së punës dhe të drejtat e punëtorëve, çështjen e kontratave, çështjen e orarit të punës, pastaj ligji nuk pretendon ta rregullojë sigurimin shëndetësor, sepse nuk e ka për objekt, nuk pretendon të rregullojë sistemin e pagesave, sepse duhet të ketë ligj të veçantë për paga, nuk pretendon të ketë zhvillim ekonomik, sepse nuk është i hartuar për çështjen e zhvillimit ekonomik dhe për çështjen e zvogëlimit të papunësisë, prandaj ta kemi të qartë objektin për të cilin po nxjerrët projektligji mendoj se në mënyrë të qartë rregullon natyrisht me disa plotësime që duhet të bëhen në komisionin funksional.

Ku janë tri çështje që mendoj, duhet t'i kemi parasysh. Është çështja e ndarjes së drejtë për të cilat kategori flet projektligji. Është e vërtet se nëse e marrim e lexojmë si Projektligj, të gjitha parimet, të gjitha dispozitat ligjore që janë, janë përafërsisht, të mos të them, plotësisht të njëjta me atë të administratës publike, kurse jashtë, sipas këtij ligji, mbetet komplet administrata publike që, ndoshta, ka kuptim sepse shërbimi civil është paraparë si kategori kushtetuese dhe natyrisht se duhet të ketë ligj të veçantë. Mirëpo, atëherë, do të duhej që më në mënyrë specifike t'i përshtatet kategorisë së punëtorëve të cilët do të kenë kontrata me punëdhënësit nëpër organizata private.

Kjo çështje, domethënë, është me interes të qartësohet që në fillim apo me rastin e amendimit.

Çështja tjetër, me interes, janë masat ndëshkuese të parapara. Është fat se projektligji ka paraparë masa ndëshkuese, mirëpo masat ndëshkuese janë pak sa të paqarta. Fillon me 100 euro, përfundon me 35.000 euro dhe gjatë leximit të masave ndëshkuese përmenden nenet 15, 16, 18 dhe rend me nga 20 e 30 nene që nëse dalim në përfundim – masat ndëshkuese janë paraparë pothuaj për të gjitha dispozitat ligjore për të cilat është nxjerrë projektligji.

Këtu duhet të kemi një specifike të veçantë, sepse në këtë mënyrë do të ishte e pamundshme që ky projektligj të implementohet.

Prandaj, me rastin e hartimit, sponsori ka qenë dashur t'i ketë parasysh fushat në të cilat më tepër preken apo shkelen të drejtat e punëtorëve. Masat ndëshkuese që janë paraparë për një kategori të caktuar për fëmijët, për shtatzënat e kështu me radhë, janë kategori të cilat, ndoshta, sa i përket sistemit privat apo organizatave ku ato themelojnë marrëdhënie pune janë më pak të shkelura, sepse ashtu-kështu nuk kanë mundësi të lidhin kontrata, sepse kontratat kalojnë përmes autoritetit tatimor dhe ato nuk lejohen. Prandaj, këto masa kanë qenë dashtë të parashihen për organizatat ku shkelin drejtpërdrejt çështjen e orarit të punës, çështjen e pagesës, çështjen e punës pa kontrata e kështu me radhë dhe masat ndëshkimore të jenë shumë më të larta.

Çështja e Inspektoratit, edhe tash është e rregulluar në njëfarë mënyre, mirëpo, masat i kanë paraparë vetëm me dënim me gjobë që kjo nuk i shkon për shtati këtij projektligji, sepse masat ndëshkimore nuk duhet të jenë vetëm në aspektin e gjobave. Duke marrë parasysh se këto kompani e shfrytëzojnë shumë fuqinë punëtore, janë në gjendje t'i paguajnë edhe ato gjoba për të cilat, nganjëherë mund të merr vendim ndonjë autoritet

për t'i dënuar. Gjrobat duhet të parashihen edhe të shoqëruara me masat tjera, ku duhet t'iu merret leja e punës, t'iu ndalohej puna për një kohë të caktuar dhe kjo do të ishte çështje që do të shkojë në interes të ligjit për t'u bërë më i implementueshëm.

Edhe një çështje tjetër. Është mirë që projektligji duhet të ketë parasysh edhe mënyrën e drejtimit. Është shumë mirë që është paraparë të kenë organizatat punuese komisione disiplinore dhe komisione të ankesave që s'i kanë pasur deri më tash, mirëpo tani nuk po e rregullojnë çështjen në mënyrë shumë të drejtë se kujt duhet drejtuar pas përfundimit të këtyre dy ankesave. Nëse mbetet vetëm brenda organizatës punuese fati i punëtorit, dihet që në start, do të jetë vendim i cili është marrë nga organi punëdrejtues dhe vendimi përfundimtar do të jetë i njëjtë. Pra, duhet të jetë i qartë organi të cilit duhet drejtuar në të ardhmen.

Dhe, krejt në fund, që të mos u marr shumë kohë, më vjen mirë që në projektligj është paraparë edhe sigurimi i pagës minimale, në një bashkëveprim me qeverinë e Kosovës, në bashkëveprim me Sindikatën dhe me organin punëdrejtues, mirëpo do të ishte shumë e qartë të bëhet një krahasim me një amendament që të mos jetë kjo në aspektin gjeneral, sepse nuk është njëjtë sikur punëtorët të cilët punojnë 5 ditë në javë dhe sikur që punëtorët do të punojnë 6 apo 7 ditë në javë, sepse ky ligj, apo projektligj këtë po ua rregullon.

Prandaj, në parim e përkrahim këtë projektligj dhe shpresojmë që Komisioni funksional do t'i ketë parasysh këto ndarje dhe këto çështje që i ngritëm. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Kemi edhe pesë deputetë që donë të flasin. Fjalën e merr deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit !

Përshëndetje të gjithëve,

Ligji i punës, si quhet ky ligj, është një variant tani shumë i mirë, sepse në të kaluarën - mandatin e kaluar ishte ligj i keq, prandaj edhe u kthye aty ku e kishte vendin. Është një ligj i përputhshëm me të gjitha ligjet e ngjashme të Unionit Evropian lidhur me mbrojtjen e punëdhënësit dhe të punëtorëve. Prandaj, modeli i huazuar është nga një vend që ka treguar sukses kur është në pyetje relacioni i punëdhënësit dhe rregullimi i të drejtave në punë sikur që është ligji slloven, nga i cili është marrë modeli.

E dyta. Dikush e quajti ligj bazik. Mund të ishte edhe ligj bazik nëse ky vërtet do të rregullonte të gjitha marrëdhëniet e punës dhe nëse do të plotësonte dëshirën dhe kërkesën e punëdhënësve dhe punëmarrësve. Mirëpo, ky ligj, nuk është i tillë, sepse nuk përfshin një sektor të rëndësishëm, të mos them, sektorin më të madh sikur që është sektori buxhetor, domethënë, punëmarrësit nga buxheti – që marrin paga nga buxheti dhe punësohen në sektorin e administratës publike.

Ministri tha se me ligj përfshihet sektori i shëndetësisë dhe disa sektorë tjerë. Unë mendoj se me këtë ligj nuk mbulohen të gjithë pjesëmarrësit në Kosovë.

Ligji, gjithashtu, nuk e parasheh një sektor që është specifik për kërkesat tona dhe do të vjen gjithnjë më shumë në shprehje, e këta janë të punësuarit në formë institucionale në tregun e lirë të punës jashtë vendit. Këtë sektor gjithnjë e kemi lënë pas dore dhe ky sektor në të ardhmen do të jetë një sektor që do të na interesojë dhe duhet të përfshihet në këtë ligj.

Ligji ka mjaft të meta, që dikush edhe i tha. Vetë titulli, mbase duhet të korrigjohet ose të plotësohet e të quhet një ligj bazik dhe gjithëpërfshirës.

Ndërsa, ka edhe të meta tjera terminologjike, sidomos kur këto edhe tingëllojnë në formë banale. Si shembull do të përmend nenin 7 pika 7 dhe nuk do ta elaboroj. Pastaj, kur është fjala për të drejtat e prindërve. Të drejtat prindore janë të barabarta për të dy gjinitë dhe terminologjikisht këtu nuk thuhet në këtë formë. Ndryshe është rregulluar e drejta prindore ose atërore në ligjet e ngjashme të punës në rajon sikurse që është rregulluar edhe pushimi i lehonisë në formë shumë më të mirë se sa që është rregulluar në Kosovë. Nëse duhet të jemi të barabartë me shtetet këtu në rajon ose të kemi ligje të sakta, atëherë, të paktën, duhet ta dimë se pse ne kemi dallime dhe dihet se këtu është ekonomia dhe çmimi i këtij ligji.

Sa i përket termave të tjera që më pengojnë sigurisht një ndër to është termi i përsëritur disa herë dhe është fjala "hendikep" për fëmijët me aftësi të kufizuara". Unë e kisha lutur Ministrinë për çështje të Punës të mos gabojë në këtë terminologji që tani nuk përdoret.

Ka nevojë për debate publike ndërmjet të parlamentarëve dhe grupeve të interesit, siç janë: punëdhënësit, punëtorët, të rinjtë, gratë dhe të moshuarit. Ka nevojë shumë edhe për konsultime profesionale që ligji të jetë, vërtet, një ligj bazik dhe funksional dhe në interes të të punësuarve.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina! Fjalën e merr deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për rëndësinë e këtij ligji nuk do të flas, sepse të gjithë e dimë se rëndësia është shumë e madhe dhe Kosova ka nevojë për një Projektligj, tash po them dhe në të ardhmen Ligj për punë.

Unë i kam disa vërejtje. Për shembull në nenin 26 pika 1, është puna e natës, kur orët e punës ndërmjet orës 22 dhe 06, që këtë lidhësen "dhe" e kisha hequr dhe e kisha bërë "deri në ora 06".

Te pushimi i lehonisë, mendoj se kishte me qenë mirë të shtohet një nen. Është neni 47 dhe të thuhet "të parashihet edhe orari i shkurtuar për lehoninë".

Pastaj, e kam një vërejtje në nenin 54 – "Lajmërimi për paaftësinë e përkohshme për punë", ku thotë se "i punësuarit është i obliguar që në afat prej 3 ditësh nga dita e fillimit

të paaftësisë ta njoftojë punëdhënësin”. Mendoj se është një afat shumë i shkurtër. Ta zëmë, për shembull, nëse ka aksident komunikacioni, ku i aksidentuari nuk e di a është i aftë a jo dhe që i nevojitet një kohë e arsyeshme që ta dijë a është i aftë a i paaftë. Për këtë arsye, mendoj se 3-ditshi është afat shumë i shkurtër.

Pastaj e kam një vërejtje në nenin 70 pika 2. Thotë “Deklaratën për ndërprerjen e njëanshme të kontratës, i punësuari ia dorëzon punëdhënësit me shkrim brenda 30 ditësh nga dita e njohjes së fakteve për shkak të cilave shkëputet kontrata”. Do të thotë “nga dita e njohjes së fakteve”, kjo të fshihet. Të mbetet vetëm afati 30 ditësh- pa ditën e njohjes së fakteve për shkak të cilave shkëputet kontrata.

Gjithashtu, mendoj se e ka mangësi edhe sigurimin shëndetësor. Vërejtjet tjera që i kam, nëse në kohë vërej edhe ndonjë, do t’i jap me shkrim. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Para se t’ia jap fjalën deputetit të fundit që do të flasë, që është Ibrahim Makolli, thërras deputetët të hyjnë në sallë, sepse do ta votojmë ligjin.

Urdhëroni, zoti Makolli, mund ta merrni fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, sepse ministrat, si duket, nuk po e shohin të arsyeshme të jenë këtu me ne kur debatohen çështje të tilla,

Të nderuar kolegë,

Nuk do të flas për rëndësinë e ligjit, të cilin e kemi para veti dhe, po ashtu, nuk do të jap vërejtje në nene të caktuara, por po flas vetëm në aspektin e refleksioneve që ka shkaktuar mungesa e një ligji të tillë në Kosovë, me abuzimet me të drejtat e punëtorëve, sidomos të atyre të punësuar në sektorin privat por edhe në atë publik. Pra, për shkak të një mungese të një legjislacioni të mirëfilltë në fushën e ndërtimit të marrëdhënies së punës në Kosovë vazhdimisht shkelen të drejtat e punëtorëve, sidomos mungesa e kontratave të punës të cilat, pothuaj se në sektorin privat ka mungesë të madhe dhe abuzime të tjera që ndodhin. Në të vërtetë në këtë fushë ka dështuar një nga institucionet më të rëndësishme që do të duhej të merrej me këtë çështje e që është Inspektorati i Punës. Në këtë ligj po flasim për 5 ditë të punës dhe 2 ditë të pushimit, por jam shumë i vetëdijshëm që në shumicën e vendeve të punës në Kosovë nuk ka asnjë ditë të javës pushim dhe ka orar që është i tejzgatur, sepse kështu janë të detyruar të gjithë ata të cilët janë të punësuar në këta sektorë.

Ajo që e bën të mangët këtë ligj, natyrisht, është mungesa e mekanizmave për ta implementuar dhe për ta mbikëqyrë, sidomos në sferën e ndërtimit të marrëdhënies së punës në mes të punëmarrësit dhe punëdhënësit, sikur që është edhe mungesa ose pavendosmëria për t’i zbatuar me saktësi detyrat të cilat janë para Inspektoratit të Punës.

Besoj, të gjithë ata të cilët kanë njohuri për të punësuarit, sidomos në sektorin privat, në masë të madhe janë të vetëdijshëm për shkeljet e të drejtave të punëtorëve, për mungesën e kontratave të punës dhe për më tepër në atë sektor punëdhënësit i japin vetes të drejtë

që të punësojnë dhe t'i largojnë nga puna të punësuarit, pa ndonjë bazë ligjore, por vetëm sipas tekeve të tyre.

Prandaj, një ligj i tillë, çfarë e kemi para veti, është shumë i domosdoshëm por që në radhë të parë kërkon edhe krijimin e mekanizmave të efektshëm për ta implementuar në praktikë dhe për t'i marrë përfundimisht në mbrojtje të gjithë të punësuarit në këta sektorë.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli. Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për të folur rreth këtij ligji në leximin e parë. Unë i thërras deputetët të hyjnë në sallë për të votuar. Lus edhe regjinë që t'i thërrasë ata me zë më të lartë atje ku janë, që deputetët të kthehen në sallë. Kërkoj evidencën prej kujdestarëve për deputetët dhe e dua numrin.

Meqë tash kemi kuorum, thërras regjinë të bëhet gati që ta votojmë në parim Ligjin që e diskutuam – Ligjin për punën.

Në sallë kemi 63 deputetë dhe bëhuni gati për ta votuar ligjin. Votojmë tani.

49 deputetë janë “për”, 7 janë “kundër”, 3 abstenojnë dhe kalon ligji në parim.

Në bazë të rregullave 23 pikë 7 dhe 35 pikë 4 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integrime Evropiane.

Komisionet duhet që në afatin prej 2 muajsh nga ky shqyrtim – shqyrtimi i parë, t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime.

Kolegë të nderuar, pushimi i drekës është deri në orën 15
Faleminderit!

KRYETARI: Lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre.
Prezentë janë 63 deputetë, kështu mund t'ia fillojmë seancën.

Fillojmë me pikën e radhës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. Ftoj zëvendëskryeministrin që ta prezantojë Projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë.

Projektligji për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës ka për qëllim t'i përcaktojë parimet themelore dhe të krijojë kornizën ligjore për organizimin dhe prodhimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës.

Krahas të arriturave bashkëkohore në këtë fushë dhe unifikimit të terminologjisë si dhe të përmbushjes së zbrastësirave ligjore në fushën e statistikave zyrtare ky projektligj përcakton kornizat kryesore për grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare në Kosovës, andaj e dikton nevojën që para jush të prezantojmë për miratim në parim Projektligjin për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj përkufizon çështjet që kanë të bëjnë me statistikat zyrtare si parimet themelore të udhëheqjes së statistikave zyrtare: organizimin, pozitën, punët dhe koordinimin e sistemit të statistikave dhe institucionit qeveritar, Agjencisë Republikane të Statistikave në Kosovë si bartëse institucionale e statistikave zyrtare.

Njëherësh Projektligji rregullon statusin dhe financimin e ARS-së, pra Agjencionit Republikan të Statistikave. përgjegjësitë dhe detyrat, pozitën e kryeshefit ekzekutiv të ARS-së, pozitën, përbërjen, organizimin dhe përgjegjësitë e Këshillit statistikor, pastaj përfshinë masat planifikuese, programuese dhe zbatuese të statistikave zyrtare, grumbullimin e të dhënave statistikore, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave statistikore e të tjera.

Ky projektligj është miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në prill, saktësisht, më 10.4.2008 dhe sipas procedurës së përcaktuar i është dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim.

Projektligji përbëhet prej 12 pjesëve me gjithsej 50 nene. Pjesa e parë e këtij projektligji përmban 2 nene ku përfshihet dispozitat e përgjithshme në të cilat është shpjeguar qëllimi i hartimit të këtij projektligji si dhe përkufizimet që sqarojnë termat e përdorura në projektligj.

Pjesa e dytë e këtij projektligji përfshinë parimet themelore të statistikave zyrtare si parimin e relevancës, parimin e paanshmërisë dhe objektivitetit, parimin e besueshmërisë, parimin e përdorimit racional të mjeteve financiare e publike, kosto-efektivitetin, parimin e pavarësisë profesionale, parimin e përputhshmërisë, parimin e transparencës, parimin e fshehtësisë statistikore dhe parimin e shfrytëzimit të dhënave individuale ekskluzivisht për qëllime statistikore.

Pjesa e tretë, përfshinë 8 nene ky hynë dispozitat lidhur me organizimin, pozitën, punët dhe koordinimin e sistemit të statistikave zyrtare, si dhe përcaktohen bartësit e

statistikave zyrtare, statusi dhe financimi i Agjencionit Republikan Statistikor, përgjegjësitë dhe detyrat e ARS-së, emërimi dhe detyrat e kryeshefit të Ekzekutivit të ARS-së, përbërja dhe emërimi i Këshillit statistikor, detyrat e këshillit, organizimi, zbatimi i statistikave zyrtare nga autoritetet tjera.

Pjesa e katërt përbëhet prej 6 neneve që përfshinë dispozitat për masat planifikuese, programuese dhe implementuese ku përcaktohet programi i statistikave zyrtare, përmbajtja e programit, plani vjetor i agjencionit, hulumtimet statistikore, raportimi për zbatimin e planit vjetor si dhe aktivitetet e jashtëzakonshme statistikore.

Pjesa e pestë, përbëhet prej 6 neneve që përfshinë dispozitat për grumbullimin e të dhënave të Agjencionit Republikan të Statistikave ku përcaktohen burimet e të dhënave, e drejta në informim, obligimi i dhënies, mosdhënia e informatave të sakta, qasja në të dhënat administrative si dhe kërkimet pilot.

Pjesa e gjashtë, përmban 2 nene që përfshinë përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave statistikore dhe përcaktojnë përpunimin e të dhënave statistikore si dhe dokumentimin dhe rregullimin e këtyre të dhënave.

Pjesa e shtatë, përmban 3 nene që përfshinë dispozitat për regjistrat statistikorë, shfrytëzimin e të dhënave nga regjistrat statistikorë dhe standardet e klasifikimit të këtyre regjistrave.

Pjesa e tetë, përmban 4 nene në të cilat përfshihen dispozitat lidhur me shpërndarjen dhe shfrytëzimin e të dhënave statistikore ku përcaktohet shfrytëzimi i këtyre të dhënave, qasja në të dhënat statistikore, kalendari i publikimit të dhënave dhe përpunimi i veçantë i këtyre të dhënave të fituara nga bartësit e statistikave zyrtare.

Pjesa e nëntë, përmban 9 nene që përfshinë dispozitat lidhur me fshehtësinë dhe ruajtjen e të dhënave statistikore ku përcaktohet fshehtësia e të dhënave të dhëna nga burimet publike, shfrytëzimi i të dhënave të fshehta, qasja në të dhëna të fshehta, kërkimet shkencore, regjistrimi e shfrytëzimi shkencor i këtyre të dhënave, shpërndarja e të dhënave të fshehta, masat mbrojtëse si dhe përgjegjësia e personave që përdorin të dhënat statistikore individuale.

Pjesa e dhjetë, përmban 2 nene që përfshinë dispozitat lidhur me bashkëpunimin statistikor ndërkombëtar ku përcaktohet aplikimi i standardeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë statistikor.

Pjesa njëmbëdhjetë, përmban 3 nene ku përfshihen dispozitat ndëshkuese që përcaktojnë shkeljen e fshehtësisë, shfrytëzimin joligjor të dhënave dhe sanksionet administrative.

Pjesa dymbëdhjetë, përmban 3 nene që përfshin dispozitat kalimtare dhe përfundimtare dhe që përcaktojnë se pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji në afatin 6 mujor duhet të bëhet emërimi i anëtarëve të Këshillit, kryeshefit ekzekutiv pastaj përcakton faktin,

obligimin se Qeveria e Kosovës miraton aktet nënligjore për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin këtij ligji, si dhe ndryshimet në legjislacion me hyrjen në fuqi të tij.

Projektligji është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007 në hartimin e tij kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucionet e rëndësishme të përcaktuara me nenin 32 të kësaj rregulloreje.

Projektligji ka formën dhe përmbajtjes, si dhe strukturën standarde që përdoret për projektligjet që hartohen nga institucionet qeveritare të Kosovës dhe është në pajtim me standardet, marrëveshjet, konventat dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe është i përafshuar me dispozitat e detyrueshme të *acquis communautaire*.

Miratimi i këtij projektligji paraqet një mundësi në drejtim të rrumbullakimit të legjislacionit në sferën e statistikave, duke përfshirë në vete çështje nga statistikat vitale si statistikat e karakterit gjeneral deri te statistikat e karakterit më të kufizuar, por gjithsesi të nevojshme për një funksionim sa më të mirë të shtetit dhe shoqërisë kosovare.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju propozoj që ta miratoni në parim këtë projektligj.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti Kryetar,
Zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë.

Projektligji për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës në shqyrtimin preliminar të bërë në Komisionin funksional parlamentar ka marrë dritën jeshile për miratim në parim gjatë leximit të parë në seancën plenare.

Pastaj në frymën, përkatësisht në rrjedhën e saj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe kemi nxjerrë disa konstatime.

Projektligji mundëson ofrimin e statistikave të nevojshme zyrtare për shtetin, administratën dhe publikun e gjerë. Projektligji mundëson të dhënat e besueshme statistikore për situatën administrative demografike, ekonomike sociale, shëndetësore dhe për ambientin dhe të dhënat të cilat ndihmojnë politikat programore për zhvillimin e vendit.

Në 12 kapitujt e Projektligjit hetohet se ka një përcaktueshmëri dhe lidhmëni logjike dhe një komunikim të mirë të brendshëm në 50 nenet me vërejtje për një stërngarkim, ndoshta, në pikat shpjeguese duket se janë tejzgjatura dhe herë-herë nuk e kanë kuptimin

e plotë të shpjegimit të materies, por janë çështje që do të mund të korrigjohen gjatë punës së mëtutjeshme.

Projektligji ka ndikime buxhetore, por janë ndikime të përballueshme sipas skemës të paraqitur për këtë vit dhe për 2 vjetët e ardhshme dhe mendohet se këto përballime do të bëhen përbrenda buxhetit Ministrisë përkatëse, përkatësisht Agjencionit të Statistikave të Kosovës.

Natyrisht që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim miratimin e projektligjit me bindje se dëgjimet publike me ekspertë të kësaj fushe dhe amendimet e nevojshme në Komisioni FunkSIONAL Parlamentar, Projektligjin do të mund ta shndërrojmë në një ligj efektiv dhe të zbatueshëm në Kosovë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah miratimin e ligjit në parim.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Mujota!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, zoti Lutfi Haziri, e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i LDK-së në shqyrtimin e parë mbështet Projektligjin për statistikën, në kuadër të komisioneve funksionale ne do ta japim kontributin tonë në mënyrë që ky ligj të procedohet dhe të miratohet nga ana e Parlamentit në afatin ligjor.
Ju faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, kryetari Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar deputetë.

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë, me gjithë vërejtjet të cilat janë shënuar nga ana e grupit, ne deklarojmi për miratim në parim të këtij projektligji me besimin se gjatë procedimit të mëtutjeshëm nëpër komisione parlamentare do të marrë një formë të plotë. Natyrisht, projektligjin në fjalë e përcjellin një mori dobësish në radhë të parë edhe në vetë emërtimin e këtij ligji që në shumicën e vendeve të rajonit, sidomos, quhet statistika shtetërore, ndërkaq këtu ne e kemi Ligjin për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës e që pastaj përcillet edhe me një mori shkurtesash të cilat mund të asocojnë me çështje të tjera. Po ashtu, kemi vërejtje edhe në pjesën e zgjedhjes së emërimit të kryeshefit të këtij agjencioni, i cili konsiderojmë se do të duhej të emërojmë të zgjidhej nga ana e Këshillit të Lartë për Emërime, sikurse te

agjencionet e tjera, që po ashtu, do të nënkuptonte një rang më të lartë edhe barazi me agjencionet e tjera që i ka Republika e Kosovës .

Ne deklarohe mi për dhe vërejtjet tona do t'i ofrojmë në komisionet e punës të cilat janë. Ju faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë.

Vërejtjet që janë bërë në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media qëndrojnë, prandaj ato mangësi në ligj, pa dashur t'i përsëris, duhet evituar.

Në Projektligj ka disa paqartësi në mes të materies dhe mënyrës së zbatimit. Kujtoj se zbatimi i ligjit nuk ka mbulesë të mjaftueshme financiare. Sidoqoftë ne mendojmë se ligji duhet të kalojë ngase arrin t'i përcaktojë parimet themelore dhe të krijojë kornizën ligjore për organizimin dhe prodhimin e statistikave zyrtare të Kosovës. E gjithë kjo bëhet edhe në pajtim me standardet ndërkombëtare të statistikave.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me kujdes e ka shqyrtuar Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës dhe vlerësojmë se është i nevojshëm dhe i domosdoshëm, duke e pasur parasysh faktin se ky ligj do të shërbejë për rregullimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës. Qëllimi i tij është ofrimi i statistikave zyrtare për shtetin, administratën dhe publikun e gjerë.

Nga ky dokument, drafti i parë që na është ofruar për shqyrtim nga ana e Ministrisë së Shërbimeve Publike, shihet se janë bërë përpjekje për ta përgatitur në mënyrën sa më të mirë të mundshme, mirëpo vihen re disa lëshime nëpër nene, paqartësi, formulime jo të drejta çka konsiderojmë se mund të shkaktojë probleme dhe vështirësi gjatë zbatimit të tij në praktikë.

Po mundohem t'i paraqes disa nga vërejtjet tona që ne i kemi si Grup që i hasim gjatë shfletimit të projektligjit në fjalë.

Neni 3, shpjegon parimet e statistikave zyrtare, në pikën 3.1.4 thuhet te parimi i ekonomizimit të mjeteve financiare publike apo kosto efektiviteti. Citoj fjalinë e parë: "Shfrytëzimi optimal i të dhënave të disponueshme dhe minimizimi i barrës së përgjegjësisë, respondentit". Këtu mendoj se duhet një formulim pak më i drejtë dhe në mënyrë më të përsosur, sepse kemi të bëjmë me një parim të ekonomisë, mirëpo fjalia si e ndarë- pjesa e parë dhe e dyta nuk kanë harmonizim dhe përputhje, prandaj nuk kanë të bëjnë me këtë parim.

Neni 5, statusi dhe financimi i ARS-së, mendojmë se pas nenit 5.1 duhet të futet një nen dhe të thuhet se organet e ARS-së janë: Këshilli Statistikor dhe kryeshefi ekzekutiv i ARS-së dhe stafi i tij, pastaj të vazhdojnë me nene tjera.

Neni 5.6, ARS krijon të hyra vetanake nga shërbimet e veta dhe këtu të përfundojë fjalia. Duhet të hiqen të parapara me ligj apo edhe ato fjalë tjera shtesë, sepse në asnjë ligj nuk janë të parapara çfarë lloj të hyrash vetanake mund të krijojë ARS-ja, madje as ky dokument që po e shqyrtojmë sot nuk e rregullon këtë, sepse kjo duhet të bëhet me akt të veçantë apo me një rregullore të veçantë, me një rregullore të brendshme, pas themelimit të ARS-së e kjo duhet të bëhet duke respektuar Ligjin për menaxhimin e financave, ku secili ligj duhet t'i referohet kur janë në pyetje krijimi i të hyrave vetanake.

Te neni 21, por edhe në disa nene të tjera përdoret termi "përditësuar" që është shumë pakuptim dhe nuk është e qartë çka është dashur të nënkuptohet me këtë. Nëse ka qenë fjala për diçka të përditshme në raportime të përditshme, kjo mendoj se është e pakuptimtë dhe duhet të hiqet dhe të zëvendësohet me fjalën e" përditshme"

Neni 44- shkelja e fshehtësisë, edhe këtu mendoj se duhet të bëhet një riformulim dhe të thuhet zbulimi i fshehtësisë e mandej të vazhdohet me fjalinë dhe të përfundohet deri në fund të fjalisë.

Janë edhe disa vërejtje tjera në këtë nen, që duhet t'i kemi parasysh, pra do të kemi mundësi t'i japim vërejtjet në komisionet funksionale, ku do ta japim kontributin tonë dhe në parim Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështet këtë projektligj dhe jep vizën për vazhdim të mëtutjeshëm lidhur me miratimin në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputetja Shpresa Murati.

SHPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedniče.

Pozdravljam sve prisutne u Sali.

Nacrt zakona o Službenoj statistici Kosova je pripremljen sa ciljem zakonskog sređivanja službenih statistika Kosova u skladu sa standardima međunarodnih statistika.

Ovim predlogom zakona se određuju osnovna načela i stvara zakonski okvir o organizovanju i sakupljanju službenih statistika Kosova. Tokom izrade Nacrta zakona

korišçeni su zakoni mnogih evropskih zemalja i dokumenti Evropske zajednice, Slovenije, Albanije, Hrvatske i ostalih zemalja u regionu.

Izvesne odredbe Nacrta zakona su uopštene, nejasne, neprecizne ali verujem da će Funkcionalna komisija otkloniti sve nejasnoçe i izvesne odredbe preformulisati u cilju što efikasnijeg sprovođenja zakona.

Takođe je potrebno otkloniti veliki broj pravopisnih, jezičkih i gramatičkih grešaka u verziji po kojim mi obradjujemo skupštinske materijale i uskladiti sve tri verzije.

Trebamo ponovo istaći da u memorandumu nisu navedeni članovi radne grupe koji su učestvovali u izradi Nacrta zakona, što po nama nije dobra praksa.

Parlamentarna Grupa „7+“ podržaće ovaj Nacrt zakona u načelu jer ispunjava uslove za jedan zakon ovakve prirode i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sllobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsedniçe,
Uvaženi ministri Vlade Kosova,
Kolege, narodni poslanici,

Parlamentarna grupa Samoslane liberalne stranke će podržati ovaj zakon u načelu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Tani është radha e deputetëve të paraqitur për diskutim.
Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Për të qenë ky agjencion i pavarur dhe apolitik- profesional, unë do të ndërlidhem edhe me terminologjinë që e tha kolegu Makolli, pikësëpari te emërtime. Në asnjë vend të rajonit nuk kemi Agjencion Republikan të Statistikave, por gjithkund është agjencion shtetëror i statistikave. Po ashtu, edhe unë mendoj se duhet të jetë edhe këtu pasi që tani ne jemi shtet dhe si shtet i pavarur, ndoshta, do të ishte i një rëndësie të veçantë që edhe ky agjencion të jetë i pavarur. Këtu ceket te neni 5.1 që është i pavarur, por prapëseprapë kryeshefi i këtij agjencioni emërohet nga ministri. Edhe unë këtu e ndaj mendimin që duhet të emërohet nga Këshilli për Emërime të Larta Publike, sepse rëndësia e këtij agjencioni do të jetë shumë më e veçantë.

Prandaj kjo lidhet direkt edhe me raportimin edhe ndarjen e buxhetit. Nuk është në rregull që një agjencion përmes ministrit t'i raportojë Qeverisë dhe Kuvendit. Pra, duhet të definohet ose t'i raportojë Qeverisë ose t'i raportojë Kuvendit. Prandaj, për të qenë

më koherent dhe të mos ketë dyfishim të kompetencave, unë mendoj që këto vërejtjet duhet të merren parasysh nga Komisioni funksional dhe gjatë punimeve të ceken këto në bashkëpunim edhe me Ministrinë edhe me Qeverinë se kujt i mbetet kompetencë, por emërimi është shumë i veçantë të quhet statistikë shtetërore.
Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Të lajmëruar për debat, diskutime nuk ka.

Në vazhdim kërkohet deklarimi për miratim në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezentë janë 70 deputetë.

Konstatohet se me 63 vota “për, asnjë “kundër” 1 abstenim, miratohet Projektligji në parim.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si Komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet, që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbartuese

Shqyrtimi i këtij projektligji është bërë që nga seanca e kaluar me qëllim të evitimit të lëshimeve teknike. Në ndërkohë, Komisioni për Legjislacion si Komision funksional dhe raportues ka rishqyrtuar raportin me rekomandime të datës 22 prill 2008 dhe u është shpërndarë deputeteve më 13 maj 2008.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e Komisionit funksional, nëse e shih të nevojshme ta arsyetojë raportin me rekomandime.
Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2008, rishqyrtoi Raportin me rekomandimet në Projektligjin për procedurën përmbartuese të datës 22 prill 2008, shpërndarë deputetëve më 13 maj 2008 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë raport.

Komisioni qëndron pranë raportit me rekomandimet të datës 22 prill 2008, që u është shpërndarë deputetëve më 13 maj 2008.

Komisioni ka konstatuar se në raportin dërguar Komisionit për Buxhet e Financa është bërë lëshim teknik ku në amendamentin 7 është harruar të shkruhet fjala “fshi” dhe është shkruar gabimisht edhe data 25 prill, në vend të datës 22 prill 2008.

Në raportin që u është shpërndarë deputetëve më 13 maj 2008 është shtuar një amendament gjuhësor, i cili nuk ka figuruar në raportin e shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet e Financa, ku fjala “gjyqtar” është zëvendësuar me fjalën “gjykatës”. Prandaj, duke marrë parasysh këto shqyrtime që janë bërë edhe një herë në Komision, i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kalojmë në votim të amendamenteve.

Votojmë për amendamentin nr.1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 1.

Në radhë kemi amendamentin nr. 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 2.

Në radhë është amendamenti nr. 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. 3.

Amendamenti nr.4.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 4.

Amendamenti nr. 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti nr. 5.

Amendamenti nr. 6.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 6.

Amendamenti nr. 7.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti nr.7.

Amendamenti nr.8.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 8.

Amendamenti nr. 9.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 9.

Amendamenti nr. 10.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 10.

Amendamenti nr. 11.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr.11.

Amendamenti nr,12.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 12.

Amendamenti nr.13.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr.13.

Amendamenti nr.14.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 14.

Amendamenti nr. 15.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr.15.

Amendamenti nr. 16.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 16.

Amendamenti nr. 17.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 17.

Amendamenti nr. 18.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 18.

Amendamenti nr. 19.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr.19.

Amendamenti nr. 20.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 20.

Amendamenti nr. 21.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 21.

Amendamenti nr. 22.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenim, miratohet amendamenti nr. 22.

Amendamenti i fundit është amendamenti nr. 23.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenim, miratohet amendamenti nr. 23.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e tekstit në tërësi të Projektligjit. Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet në tërësi miratohet ligji i propozuar nga Qeveria.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit financiar të buxhetit të Kosovës për vitin 2007

Raporti Financiar për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 u është shpërndarë deputetëve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin dhe ka rekomanduar që të procedohet për diskutim në seancën plenare.

Raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj ministrin për Ekonomi dhe Financa që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin financiar për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007.

Fjalën e ka ministri Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Në dhjetor të vitit 2006 nga Kuvendi i Kosovës është aprovuar Rregullorja 2006/61 për Buxhetin e vitit 2007, si dhe rishikimet buxhetore në shtator 2007 me Udhëzimin Administrativ 2007/10.

Plani buxhetor për realizimin e të hyrave vjetore për vitin 2007 ka qenë 682.800.000 euro, plani buxhetor për pagesat vjetore ka 764.273.000 euro, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura nga viti 2006 dhe të cilat nuk janë të planifikuara në Rregulloren e buxhetit.

Më lejoni që në katër shtylla ta paraqes faktikisht raportin, pra, nga të hyrat, shpenzimet, grandet dhe gjendjen e mjeteve në kesh.

Të hyrat, përkatësisht pranimet gjatë vitit 2007, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve si dhe Fondin e privatizimit kanë qenë 2.998.000 euro dhe paraqesin 132,2% të hyra të përgjithshme vjetore të planifikuara. Kjo tregon një rritje vjetor të hyrave, krahasuar me planin vjetor për 32%, në këtë rritje ndikim ka pasur sidomos licenca e operatorit të dytë prej 75 milion euro. Pra, edhe pa këtë ka pasur një rritje.

Pjesa më e madhe e të hyrave, dua të shkojë në veçanti, janë mbledhur në kufi në pjesën prej 58,9%, pra, rreth 60% të mjeteve janë të mbledhura nga doganat. Këto të hyra kapin shumën prej 531.591.000 euro, gjë që tregon për një tejkalim prej 21%.

Të hyrat nga Administrata Tatimore janë të mbledhura 182.542.000 euro ose 20,2% dhe që janë mbi vlerën e planifikuara për 30%.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë prej 3,2% e që janë në fakt ende shumë të ulëta, megjithatë, këtu ka pasur, gjithashtu, një tejkalim plani prej 4%.

Të hyrat vetanake të nivelit qendror në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë me 2,8% dhe janë në shumën prej 25.724.000 euro, të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 6,5% , përkatësisht një tejkalim të realizuar prej 1.44 të treguesit të indeksit. Kësaj kategorie duhet t'i shtohen se edhe të hyrat nga gjobat të cilat mblidhen nga komunat për regjistrimin e të hyrave jo tatimore dhe pastaj atyre u alokohen.

Në pikat e shkurtra shpenzimet gjatë vitit 2007, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve si dhe Fondin e privatizimit, kanë qenë 661.208.000 euro dhe paraqesin 86,5% të planit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin paraprak, pra, vitin 2006 shihet një rritje vjetore e shpenzimeve dhe kryesisht në kategorinë e investimeve kapitale.

Shpenzimet nga kategoritë e pagave dhe mëditjeve janë 208.513.000 euro ose janë 32%, të realizuara 96,3%.

Shpenzimet e mallrave janë 127.018.000 euro, 19% të shpenzimeve ose të realizuara 87,5%.

Shpenzimet për shërbime komunale janë në shumë prej 17.893.000 euro apo 3% të shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa realizimi ndaj tyre është bërë 93,1%.

Subvencione dhe transfere- 153.000.000 euro, që përfshinë 23% të shpenzimeve të përgjithshme dhe të realizuara 94,7%.

Te shpenzimet kapitale, siç dihet, ekzekutimi është goxha në nivel të ulët, megjithatë përfshin 154.767.000 euro ose 23% të shpenzimeve dhe të realizuara vetëm 70%, megjithatë në krahasim me vitin 2006 ka 16% ngritje.

Grandet e përcaktuara të donatorëve. Fondi i granteve të përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti 2006 në 2007 ka qenë 12.949.000 euro si gjendje fillestare, si dhe të hyrat nga grandet e vitit 2007 në shumën prej 14.885.000 euro, që paraqesin fondin e përgjithshëm të granteve të përcaktuara për vitin 2007 në shumën prej 27.834.000 euro, po flas më shpejt dhe po e përfundoj.

Nga ky fond në vitin 2007 janë shpenzuar 15.496.000 euro dhe janë bërë kthime në shumë prej 1.070.000 euro ku shihet se gjendja e fondeve të granteve të përcaktuara të donatorëve më 31.12. 2007 janë 11.267.000 euro.

Gjendja e mjeteve kesh, mjeteve të gatshme më 31.12.2007 janë 856.010.000 euro, mirëpo nga kjo gjendje rrjedhin detyrime siç janë: detyrimi Fondit për donatorët 11.267.000 euro, të hyrat vetanake 28.725.000, Fondi i privatizimit 406.248.000, fondet e tjera në mirëbesim në shumën prej 12.626.000 dhe nga kjo, pas shpërndarjes, pra më 31 dhjetor, shuma prej 397.144.000 euro janë para të cilat kanë qenë në dispozicion të Qeverisë së Kosovës.

Faleminderit!

KRYETARI: Lus deputetët për shtim të vëmendjes.

Për fjalë i kemi të lajmëruar thuaj se gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Fjalën e ka kryetari i këtij komisioni, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

I nderuari zoti ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Ne sa po e dëgjuam shkurtimisht raportin për vitin fiskal 2007 dhe shikuar nga ajo që tha edhe ministri edhe ajo që kemi marrë në raport, na del se gjithçka ka qenë në rregull në shfrytëzimin e mjeteve buxhetore për vitin 2007.

Unë do të përpiqem t'i përçoj këto qëndrimet dhe vendimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa që në bazë të Kornizës Kushtetuese të Kreut 5.1, 9.1 dhe të rregullave 35.10,

51.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e vet të mbajtur më 4.5.2008 ka shqyrtuar Raportin fiskal të Buxhetit Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 dhe në parim e ka miratuar dhe i ka propozuar Kuvendit që ta shqyrtojë në seancën të cilën edhe tash jemi duke mbajtur.

Po të shikohet raporti, ai pothuajse i përmban të gjitha karakteristikat që parasheh neni 40 i Ligjit të menaxhimit të financave publike, por me ndonjë dokument, siç thuhet atje nga ky nen në këtë raport dhe kështu si është prezantuar nuk dallon nga raportet e viteve të tjera dhe sikur është krijuar një mënyrë, një shabllon i raportimeve.

Përmban të njëjtën strukturë të hyrave dhe të dalave nga ky buxhet me pak ndryshime nga viti i kaluar, por nuk përmban detaje të të hyrave dhe detaje të shpenzimeve për të cilat ka qenë në pamundësi Komisioni të japë vlerësimet e veta lidhur me këtë raport. Unë e di që Qeveria aktuale,

Respektivisht Ministria përkatëse e ka pasur shumë vështirë, sepse sikur i ka mbetur ky raport edhe nga vitet e kaluara, prandaj, tash barra i bie kësaj qeverie për një punë që kanë bërë të tjerët në mandatin e kaluar, por paraprakisht dua t'i them dhe personalisht që duhet të shërbejë ky raportim dhe kjo mënyrë e menaxhimit të financave publike se si nuk duhet të menaxhohen në këtë vit fiskal dhe në vitet tjera që do të ketë mandatin kjo qeveri.

Nuk jep informata të nevojshme dhe përshkrime për aktivitetet financiare rreth suficitit që u përmend këtu. Pse ai suficit, nga ai suficit, si është menaxhuar dhe si do të menaxhohet në këtë vit ky suficit? Pra, Qeveria aktuale dhe ministri do të duhej të jepnin, ndoshta, në një lloj llogarie këtu për këtë raportim. Raporti nuk përshkruan pasqyrën e shpenzimeve dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve që kanë qenë të dedikuara për statusin e Kosovës, gjë që do të ishte mirë që edhe opinioni edhe ky Kuvend të njihet me këtë fond dhe me mënyrën e shpenzimeve nga ky fond dhe çka është shumë karakteristike dhe është shqetësuese, 30% të mjeteve të dedikuara për shpenzime kapitale kanë mbetur pa u shfrytëzuar. Pikërisht është kjo linjë buxhetore që qytetarin e prek më së shumti, do të thotë qytetari i Kosovës në vitin e kaluar 30% më pak ka përfituar prej këtij buxheti nga ajo që ne e kemi projektuar. Dhe çka është karakteristike mbi 13 organizata buxhetore, buxhetin e vitit të kaluar këtë linjë e kanë shfrytëzuar nën 50%, që është shqetësuese dhe le të jetë si shembull prapë edhe një herë se si nuk duhet të menaxhohen financat publike.

Nuk dua të hy në çështjet tjera, sepse edhe materiali ka qenë i mangët, nuk kemi pasur pasqyra analitike, nuk kemi pasur një analizë të veçantë për ndarje të veçanta edhe për shpenzime të veçanta edhe për të hyra të veçanta dhe në fund konsideroj ,sepse ne s'kemi çka të bëjmë, ne duhet ta miratojmë këtë raport si është, por me të gjitha vërejtjet dhe me të gjitha mësimet që duhet të nxirren për një qeverisje , vërtet, të përgjegjshme sa i përket parasë publike dhe buxhet të Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Koci!

Tani është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2007 dhe ka ardhur në konstatimin se ky raport teknikisht është mirë i avancuar në krahasim me vitet e mëparshme, por në aspektin e realizimit të hyrave dhe shpenzimeve nuk ndryshon shumë me raportet e viteve 2005 dhe 2006.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në vazhdimësi ka dhënë sugjerimet për një menaxhim më efikas të buxhetit.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, po ashtu, vazhdimisht ka sugjeruar dhe kritikuar Qeverinë për mënyrën e shpenzimit të buxhetit, duke tërhequr vërejtjen se Kosova nuk përballet me mungesë të mjeteve, por me paaftësinë për shpenzimin e tyre në mënyrën më të mirë. Këtë e dëshmon edhe ky raport që na është ofruar në diskutim.

Nga faqja 7 shohim se ish Qeveria ka pasur para të gatshme në fillim të vitit 487.593.000 euro, kurse gjatë vitit 2007 ka pas rritje të parave të gatshme 368.417.000 euro, çka do të thotë se paratë e gatshme në fund të vitit kanë qenë 856.010.000 euro. Kjo është një dëshmi se Kosova edhe përkundër humbjeve të mëdha të mjeteve të saja, në saje të dukurive negative, evazionit, ekonomisë joinformale, nuk ishte pa para, por problemi ishte tek menaxhimi i parasë publike.

Gëzon fakti se nga ky raport vërehet se gjatë vitit 2007 të hyrat buxhetore janë rritur për 32.2% . Rritja më e madhe ka ardhur nga licenca e telefonisë mobile, por rritje ka pasur gati në të gjitha kategoritë ekonomike, por shqetëson fakti kur kërkesat e qytetarëve janë të shumta në të gjitha fushat e jetës, kurse mjetet mbesin të pasistemuara.

Buxheti hartohet nga Qeveria për të menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme, tërësinë e burimeve financiare publike në favor të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Buxheti hartohet për t'u shpenzuar, por problemi është si të shfrytëzohet me efikasitet dhe efikasitet. Në vitin 2007, ashtu si edhe në vitet e kaluara, 32% të mjeteve janë shpenzuar për paga e mëditje, 23% për subvencione, 19% për mallra dhe shërbime, kurse 23% janë shpenzuar për mjete kapitale, apo për investime kapitale.

Analiza e raportit sjell në konstatim se shfrytëzimi i buxhetit nuk është orientuar në drejtimin e duhur. Shfrytëzimi i vetëm i 70% i mjeteve të planifikuara për investime kapitale vërteton faktin se mjetet edhe këtë vit janë orientuar dhe shpenzuar për luks qeveritarë dhe jo për investime kapitale aty ku mjetet u kthehen qytetarëve në formë të mirave publike.

Në raport shihet se 13 organizata kanë shpenzuar më pak se 50% të mjeteve të tyre për investime kapitale, gjë që tregon një menaxhim jo të mirë të mjeteve të alokuara buxhetore për këtë kategori.

Në këtë raport janë paraqitur edhe shumat e mjeteve të zotuar, mirëpo shumë organizata buxhetore mjetet e ndara për investime as nuk i kanë zotuar dhe as nuk i kanë shpenzuar. Po marr shembull disa ministri, investimet e të cilave ndikojnë direkt në jetën e qytetarit.

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë ka shpenzuar vetëm 67% të mjeteve të dedikuara për investime, ku nga 2.162.000 euro ka shpenzuar 1.448.000 euro, ka zotuar 672 mijë euro, kurse 40 mijë euro i ka dërguar në suficit.

Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar 57.3% të buxhetit për shpenzime kapitale ku nga 9 milion e 159 mijë euro të planifikuara ka shpenzuar 5.249.000 euro, ka zotuar 2.892.000 euro, kurse për suficit ka lënë 1.070.000 euro.

Pra, kjo Ministri edhe për mallra dhe shërbime ka shpenzuar vetëm 64% të mjeteve, kurse në anën tjetër kanë munguar edhe barërat esenciale për pacientët që është dashur të sigurohen nga kjo vijë buxhetore.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka shpenzuar 62% mjete të dedikuara për investime kapitale, ku nga 19 milion euro të planifikuara ka shpenzuar vetëm 11.000.000, kurse ka zotuar 5.499.000 euro, kurse 1.700.000 euro i ka dërguar prapë në suficit. Ministria e Transportit dhe Poste Telekomunikacionit prej 24.954.000 eurove i ka shpenzuar për investime kapitale vetëm 51%, që do të thotë se ish - Qeveria nuk ka arritur të ngrit kapacitetet planifikuese zbatuese dhe monitoruese të projekteve kapitale.

Mungesa e planifikimit real shumëvjeçar, duke paraqitur edhe fazat e realizimit të projekteve dhe llogaritja jo e mirë e kostos reale, ka penguar në masë të dukshme realizimin e projekteve.

Sa i përket shpenzimeve për mallra dhe shërbime është vazhduar me ritmin e njëjtë nga e kaluar ku pjesa më e madhe e shpenzimeve është bërë për kategori të shpenzimeve të udhëtimit, telefona, derivate, mirëmbajtje, shpenzime kontraktuese, qira e të tjera, të cilat janë diskutuar pothuaj se me vite të tëra.

Në faqen 79 të Raportit, vërejmë se avancat e paarsyetuara për udhëtime zyrtare për mbylljen e të cilave ka afate kohore, janë 112.674 euro. ku prinë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me 30.782 euro, domethënë avancat të cilat duhet të mbyllën në afat të caktuar dhe nuk janë mbyllur. kurse avancat e paarsyetuara për mallra dhe shërbime janë 1.148.000 euro. Pra, nuk janë respektuar rregullat në fuqi, kurse faturat e papaguara që ka trashëguar kjo qeveri nga e kaluara, janë me vlerë 6.896.000 euro, në nivelin qendror dhe 8.496.000 euro në nivelin lokal.

Siç po shihet, Qeveria aktuale ka trashëguar një gjendje jo të mirë të menaxhimit të buxhetit. Ajo, krahas sfidës për të luftuar ekonominë informate, që i ka shkaktuar dëme

të mëdha: buxhetit, evazionit, korrupsioni e dukurive të tjera të trashëguara, do të përballet edhe me sfidën e ngritjes së kapaciteteve për një planifikim dhe realizim më të mirë të buxhetit.

Dënimin më të këtij menaxhimi jo efikas të buxhetit e ka dhënë qytetari i Kosovës, që me votën e tij ka krijuar mundësinë për një qeverisje ndryshe, për një menaxhim ndryshe të buxhetit, i ka hapur mundësi vetes të ketë institucione demokratike dhe menaxherë që kryejnë veprimtari publike, duke zbatuar ligjet që janë të ndershëm dhe i respektojnë interesat e popullit të cilit i shërbejnë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i mendimit se në këtë raport duhet të përfshihen dhe vërejtjet e deputetëve dhe njëkohësisht i jepet një përkrahje e fuqishme Kryeministrit dhe Qeverisë aktuale që të vazhdojë me kontrollin e rrjedhës së parave, ashtu siç ka filluar, dhe të bëjë të pamundurën për shpëputje nga sistemi i shpërdorimit të parasë dhe të kalohet në një sistem të mirë të menaxhimit të mjeteve, ashtu që të hapen perspektiva për qytetarët tanë.

Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. E ka fjalën deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Të nderuar deputetë,
Ministra të pranishëm,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike jam i obliguar që të them që përkrahet Raporti dhe në vazhdim do ta paraqes esencën e atyre që i vlerëson Grupi Parlamentar i LDK-së, lidhur me punën që është bërë në vitin e kaluar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financa.

Raporti i Buxhetit për vitin 2007, është përgatitur në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Po ashtu, Raporti i përmban kërkesat e ligjit në fjalë, qoftë në afatin e prezantuar, qoftë me përmbajtjen që ka në vetvete. Pra, ky është edhe mendimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me Raportin.

Në bazë të të dhënave që ofron raporti, të cilin po e shqyrtojmë, rezulton që në vitin 2007, Qeveria ka realizuar një aktivitet dinamik në sferën e realizimit të politikave buxhetore të përcaktuara në Ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2007. Në fakt, në aktivitetet e Qeverisë të vitit 2007 lidhur me përgatitjet për definimin e statusit të Kosovës, çështje me rëndësi të veçantë është përcaktuar sigurimi i bazës materiale për funksionimin e institucioneve të Kosovës, në vitin e parë të funksionimit të saj në kushtet e pavarësisë, gjë e cila edhe është arritur.

Duke e kuptuar rëndësinë e këtij faktori, pra të sigurimit të bazës materiale për funksionimin e institucioneve shtetërore të buxhetit të nevojshëm, për të ardhmen politike të Kosovës, segmente të caktuara në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, Administrata Tatimore, Shërbimi Doganor dhe Departamenti i Politikave Fiskale janë mobilizuar gjatë tërë vitit 2007, dhe siç po shihet në raportin që e kemi marrë para do kohe dhe në pjesën e prezantimit që e bëri Ministri i Ekonomisë dhe të Financave, kanë përmbushur obligimet e tyre, si vijon:

-Shërbimi Doganor ka realizuar rritje të të hyrave buxhetore 16.5% në krahasim me vitin 2006 dhe 21% më shumë se sa që ka pasur obligim me Planin vjetor të buxhetit për vitin 2007.

- Administrata Tatimore ka realizuar rritje të të hyrave për 11.3% në krahasim me vitin paraprak dhe 30% më shumë se sa që ka pasur obligim me buxhetin për vitin 2007.

Edhe kategoritë e tjera të të hyrave kanë realizuar të hyra mbi obligimet me buxhetin 2007, si të hyrat vetanake qendrore për 134% , të hyrat jotatimore qendrore 44% dhe zgjerimi i politikave tatimore për 300%. T'ju përkujtoj, të nderuar deputetë, se shtesa nga licencimi i telefonisë së dytë mobile lidhet me zgjerimin e politikave tatimore dhe efekti i saj në mbikalimin e buxhetit është vetëm 50 milion, kurse të hyrat mbi buxhetin janë 221 milion. Pra, nuk është korrekte që ky rezultat të fshihet prapa një të hyre që në efektin e tejkalimit është vetëm 50 milion karshi 221 milionëve. Totalisht në vitin 2007, në Fondin e konsoliduar të Kosovës janë derdhë 902.998.000 euro, që do të thotë 190.000.000 më tepër se sa në vitin 2006, dhe 221.000.000 mbi kërkesat e buxhetit për vitin 2007.

Po ashtu, struktura e të hyrave ka pësuar përmirësim pozitiv në favor të rritjes së të hyrave që realizohen në brendi të vendit.

Pjesa tjetër e Raportit që ka të bëjë me shpenzimet për vitin 2007, po ashtu tregon një menaxhim të kujdesshëm të parave publike. Asnjë kategori e shpenzimeve nuk e tejkalon vëllimin e paraparë të shpenzimeve me buxhetin për vitin 2007.

Konkretisht, pjesa e pagesës për paga është më e vogël 3.7% se sa që është paraparë ose është lejuar me buxhet.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të vogla se sa buxheti i paraparë 12.5%.

Shpenzimet për shërbime komunale janë 7% më të vogla. Subvencionet dhe transferet 5.3 dhe ajo që është dobësi, e pranojmë, dobësi që e ka përcjellë sistemin nën shpenzimet kapitale, që janë 30% më të vogla se sa që janë paraparë me buxhet. Kjo e fundit është dobësi e organizatave buxhetore për realizimin me kohë të buxhetit të aprovuar dhe mbetet për obligim për përmirësim të mëtejshëm.

T'ju përkujtoj që në vitin 2007 ka pasur kompetenca shtesë, që nënkupton edhe obligime shtesë, që do të thotë, në qoftë se merret baza e përbashkët krahasuese, atëherë

tejkalimi në krahasim me parashikimet e planit është shumë më i lartë se sa kjo që paraqitet me shifra nominale, sepse këtu janë përfshirë edhe dy ministri të reja dhe kompetenca të reja, obligimet dhe shpenzimet që janë bërë shtesë në vitin 2007, në aktivitetin për definimin e statusit.

Po ashtu, t'ju përkujtoj që nga 103.000.000 të pashpenzuara e të parapara, të lejuara me buxhet për vitin 2007, 67.000.000 janë nën shpenzime në investime kapitale dhe është pjesa e dobësisë së sistemit, pra mungesa e përgatitjes së kuadrit nëpër ministri, nëpër agjensione shpenzuese për t'i realizuar këto investime me kohë. Por, duhet të jemi korrekt dhe të themi janë 36.000.000 që janë kursye nga Qeveria në vitin e kaluar, nga kategoritë që janë shpenzime të pastra, dhe këtë duhet ta themi sepse shifrat janë këtu dhe ato janë tepër të kokëforta, nuk na lejojnë të manipulojmë me opinion.

Si rezultat i aktivitetit, qoftë në segmentin e të hyrave, po ashtu edhe të shpenzimeve, nga viti fiskal 2007 janë bartur në vitin 2008 397.000.000 euro. Pra, kjo Qeveri ka trashëguar nga Qeveria e kaluar 397.000.000. Është e vërtetë që ka trashëguar fatura të papaguara të cilat vijnë në janar, rryma, telefoni etj. dhe ato ka qenë e pamundur të shlyhen deri me 31 dhjetor të vitit të kaluar. Pra, duhet t'i lexojmë raportet mbarë, çdo rresht e jo t'i kalojmë vetëm shifrat që na konvenojnë dhe momentalisht na ndihmojnë në do politika parciale.

Dhe, ajo që duhet thënë në fund, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e vlerëson punën shkëlqyeshme në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Shërbimin Doganor në vitin e kaluar dhe kërkon që kapacitetet humane të ndërtuara në këto institucione, të mbështeten për të punuar edhe këtë vit edhe vitet tjera dhe për të arritur rezultate tjera, sepse janë bazë e funksionimit të shtetit. Mbikëqyrjen dhe procedimin e shpenzimeve po ashtu nga Departamenti i Buxhetit dhe i Thesarit, e vlerësojmë dhe e çmojmë shumë lartë sepse nuk kanë lejuar që mjetet e lejuara me buxhet, në raste kur nuk janë plotësuar kushtet e parapara me Ligj, nuk i kanë lejuar që të procedohen vetëm sa për t'u shpenzuar dhe sa për të raportuar si shpenzime me dinamikë të paraparë kohore. Në bazë të kësaj, mendojmë se duhet të kërkojnë formë adekuate për përgatitjen e organizatave buxhetore, të cilat nuk kanë kapacitete humane të ndërtuara mjaft për shpenzimet me kohë dhe destinim të ndarjeve buxhetore në sferën e investimeve kapitale. Në fund, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon që të dhënat e ofruara në këtë raport janë përgjigja më e mirë ndaj kritikave të pabazuara ndaj Sektorit të Financave dhe të Buxhetit, në kohën kur ky sektor udhëhiqej nga LDK-ja, pra në mandatin e kaluar qeverisës.

Bashkë me këtë raport, mendojmë që është dashur të shqyrtohet edhe Raporti periodik i tremujorit të parë, meqenëse është i përgatitur në bazë të kërkesave të Ligjit dhe iu është shpërndarë deputetëve me kohë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i Grupit, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Raporti që na është ofruar, natyrisht, është shumë i mangët dhe nuk ka pjesë përmbajtësore përmes të cilës do të mund të jepnim një vlerësim më të drejtë dhe më të saktë të krejt kësaj, por megjithatë nga kjo që shihet, mund të thuhet se Qeveria e kaluar ose Qeverisë së kaluar i ka munguar një planifikim i drejtë i buxhetit që pastaj ka rezultuar edhe me keqmenaxhim, por sidomos me mbetje në fushat ku ka pasur më së shumti nevojë, në arsim, në shëndetësi dhe në fusha të tjera.

Sikurse që pjesa për investimet kapitale, gjithsesi paraqet një nga dobësitë më të mëdha të Qeverisë së kaluar, që përkundrazi faktit se këtu përpiqet të gjejnë fjalë me të cilat do të mund të arsyetohej, natyrisht se të gjitha këto duhet të na shërbejnë dhe duhet të shërbejnë si një mësim i mirë që në të ardhmen të kemi një menaxhim më të drejtë të buxhetit, por në radhë të parë një planifikim më të drejtë të buxhetit, sepse edhe rrethanat të cilat i ka Kosova, nuk do të toleronin që ne të kemi mbetje të buxhetit për vitin tjetër.

Në asnjë rast nuk konsiderohet si sukses, nëse ne për çdo vit kemi përafërsisht shpenzime të njëjta në shërbime dhe mallra, që po na trashëgohet nga viti në vit. Përderisa ky raport edhe nuk do të votohet në Kuvend, sepse është diçka e kaluar, ne nuk do të kishim diçka tjetër sa i përket kësaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shefi Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,
Ministra,

Kjo foltore është e vërtetë se është foltore politike dhe çdo fjalë që nxjerrim prej goje, është politike dhe është plotësisht legjitime që çka do që vjen para deputetëve të përket në aspektin politik. Mirëpo, unë fillimisht e falënderoj ministrin Shala për sjelljen e një raporti korrekt, në fund të fundit, me shifra korrekte edhe me shpjegimet të cilat i ka bërë. Në të njëjtën kohë e falënderoj ministrin Shatri për një shpjegim prapë korrekt të shifrave të cilat kanë ardhur në raport, se në fund të fundit, kjo Qeveri e ka bërë Raportin, dhe kisha dashur t'i shtoj disa fjalë në lidhje me raportin, që janë politike.

Shikoni, ne kemi mundësi të gjejmë të meta edhe prapë duhet ta falënderojmë edhe ministrin se dikush, në fund të fundit, del në Kuvend dhe thotë: Po, në këtë drejtim kemi pasur të meta, nuk kemi qenë ideal, kemi pasur probleme, një qeveri ka pasur probleme në realizim të investimeve kapitale, mirëpo kjo është vetëm njëra pjesë e krejt asaj çka po themi ne këtu. Nëse dikush e ka dëgjuar atë që u tha deri tash, ka për të pasur konfuzion ta kuptojnë a ka qenë mirë a ka qenë keq. Për diçka ka qenë mirë, për diçka ka qenë mirë për diçka ka qenë keq. Për diçka ka qenë mirë, për diçka keq. Të hyrat buxhetore janë rritur përmbi 30%, realizimi i investimeve kapitale, sipas ministrit është rritur për atë vit 16%, gjithçka është rritur realisht, por nuk ka qenë qysh duam, ka qenë larg për të qenë qysh synon secili prej nesh. Edhe kjo është esenca dhe mendoj se kryesorja që duhet të dalë, kur dikush e bën një analizë të buxhetit të Qeverisë së kaluar

ose të vitit të kaluar, pa marrë parasysh se cila qeveri, është se të cilat janë të metat në sistem realisht edhe detyrë e kujt, në çfarë aspekti është që t'i përmirësojë ato të meta. Okej, krejt në rregull është që të thuhet se ka pasur të meta, nuk është realizuar, nuk është bërë, krejt janë në rregull, mirëpo kemi folur shumë shpesh për dy pika referente në punët e institucioneve. Nëse ekziston vetëm një pikë referente, nëse ne e shohim vetëm ku duam të arrijmë, është pak problem për shkak se është demotivuese, është demotivuese se njerëzit nuk e shohin se prapë se prapë ka pasur njëfarë lëvizje pozitive prej ku kemi qenë e deri ku jemi. Edhe nëse e shohim vetëm aspektin prej ku kemi qenë dhe ku jemi dhe nuk e shohim se ku duam të arrijmë, prapë mund të jetë deprimuese se nuk e tregon realitetin dhe kthen në vetëkënaqësi. Këto të dyja janë të gabueshme.

Mendoj se është në rregull që të thuhet si pjesë e analizës, që ka pasur lëvizje, është larg për të qenë ideale, por ka pasur lëvizje prej një viti më përpara dhe nuk duam të kthehemi tash edhe në vitin 2005, edhe në vitin 2004 dhe ta shohim një dallim enorm të madh në shkurtim të shpenzimeve kapitale, përkundër krijimit të dy ministrive ose të tri ministrive në ndërkohë, në rritje të buxhetit, në rritje të shpenzimeve kapitale, në gjithçka rritje. Mendoj se ka qenë mirë të thuhet këto, dhe i falënderoj të dy ministrat që në njëfarë forme e thanë, e thanë se kështu ka qenë, edhe si mesazh prej debatit të cilin e zhvillojmë ne sot, të dalë se kemi ende shumë punë, si Kosovë është fjala, si Kosovë, si institucione të Kosovës, që të bëjmë prej sot e tutje, që një ditë, ajo ditë qoftë më afër se kurdo tjetër, qoftë në fund të këtij viti, ta kemi një situatë në të cilën nuk do të flasim më për këto të meta. Ne të gjithë dyshojmë se e dimë se nuk mund të jemi ideal përnjëherë, por le të synojmë.

Unë këtë e kisha nxjerrë si koment dhe kisha kërkuar që të jenë të shkruara diku edhe mësimet, të jenë të shkruara edhe qëllimet të cilat do t'i kemi që edhe prej këtu ku jemi, përkundër përmirësimeve, të përmirësohemi edhe më tutje.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e mbështet Raportin, e konsideron si korrekt dhe mendon që edhe komentet tona do të jenë korrekte po ashtu në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

T'ju them të vërtetën, sot vërtet janë duke u shqyrtuar shpenzimet buxhetore të vitit 2007 dhe në bazë të diskutimeve të deritanishme, ne si opozitë vërtet nuk po dimë politikisht ku ta gjejmë veten.

Në qoftë se dëgjojmë Grupi Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, atëherë unë shumë pak kisha me pasur çka të shtoj. Në qoftë se dëgjojmë Grupin Parlamentar të

Lidhjes Demokratike andej, është një pjesë e medaljes krejt tjetër, dhe në realitet që në fillim unë po dua t'ju përkujtoj se LDK dhe PDK jeni në koalicion dhe ju duhet të dilni këtu dhe të na tregoni se vërtet a pajtoheni apo s'pajtoheni, a duhet të marrë përgjegjësi kjo Qeveri në qoftë se ai raport vërtet është ashtu si u prezantua nga PDK, dhe e kundërta.

Megjithatë, ne si Grup parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e kemi bërë një analizë tonën dhe, natyrisht, që nga ky raport shihen të hyrat për vitin 2007, duke mos përfshirë grandet dhe donatorët dhe mjetet e privatizimit kanë qenë, pra, gjithsej 902.998.000 euro. Pra, realizimi i planifikuar në përqindje shprehet prej 132.2%, çka do të thotë se ka pasur tejkalim të planit për 32.2%.

Sa u përket kategorive të strukturës së të hyrave, fatkeqësisht dominojnë të hyrat nga dogana në shumë prej 531.591.000 euro ose 58.9%, pasojnë të hyrat nga grumbullimi i Administratës tatimore me 20.2%, të hyrat nga komunat me 29.237.000 euro apo 8.2%, të hyrat jotatimore qeveritare nga gjrobat dhe tarifat me 6.5%. Nga të gjitha këto të hyra, gjithsej janë shpenzuar 661.208.000 euro. Struktura e këtyre shpenzimeve është tejet e papranueshme. Prijnë shpenzimet për paga dhe mëditje me 208.923.000 apo 32% të buxhetit, 127.180.000 euro apo 19% mallra dhe shërbime. Shpenzimet për shërbime komunale, pra 17.893.000 euro apo 3%, shpenzimet për subvencione dhe transfere 153.552.000 euro apo 23%, e cila shumë është e barabartë me investimet kapitale ose krejt e përafërt. Kjo, mendoj unë se nuk do koment dhe të jep të kuptosh mjaft.

Të nderuar kolegë,

Nga ky bilanc i të hyrave dhe shpenzimeve më 31.12.2007, mjete të pashpenzuara apo suficit janë 397.000.144 euro. Kjo na jep të kuptojmë se Qeveria nuk kishte projekte dhe u zu në befasi me rastin e tejkalimit të planit të të hyrave, ani pse edhe për ato të cilat i kishe planifikuar realisht, sepse këtu na del se kanë pasur të hyra të paplanifikuara, por edhe ato që ishin planifikuar në investime kapitale, realizohen apo investohen vetëm 70%, do me thënë 30% mbeten të porealizuara. Kjo na jep të kuptojmë se nga janë të hyrat e këtij viti, të kësaj Qeverie - 397.000.144 euro suficit i vitit të kaluar.

Edhe kjo Qeveri krekoset se këtë vit janë 1 miliard të hyra si dhe shpenzimi i këtij buxheti është i të njëjtit fat, sepse kolegë të nderuar, ky Kuvend nuk ka pasur rastin që të shoh asnjë projekt në Programin e Qeverisë, projekt pra kapital për të cilin kanë parashikuar shumat e caktuara, pra shuma konkrete apo shpenzime konkrete. Megjithatë, shpresojmë, do t'i vijë radha edhe kësaj Qeverie.

Nuk dua të lëshohem në çdo zë buxhetor, sepse shumë gjë u tha, megjithatë edhe nuk na lejon koha, por po i theksoj disa nga vërejtjet në lidhje me shpenzimet. Në këtë raport shohim se Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit, unë po i theksoj këto dy ministri, duke pasur parasysh që janë dy sfera shumë të ndjeshme për qytetarët e Kosovës dhe për vetë shtetin e Kosovës, nga ky raport shohim se mbi 1 milion euro nuk i kanë shpenzuar as që i kanë zotuar, dhe nuk e di sa do koment rreth kësaj.

Të nderuar kolegë,

Nuk di a ka dhënë kush përgjegjësi për këtë gjë, për shembull për këto dy ministri. Veç e thashë, e kemi parasysh se vërtet këto dy sfera janë edhe shpesh jemi arsyetuar që vërtet ka buxhet, ndërsa në anën tjetër nuk e kanë zotuar fare as buxhetin të cilin e kanë pasur të ndarë.

Shembull tjetër kemi tek shpenzimet për mallra dhe shërbime. Në përshkrim të këtyre shpenzimeve, po jap një ndër shembujt: shuma për shembull prej 35.955 euro të emëruara - shpenzime të tjera, për të cilat, kolegë të nderuar, edhe në Komisionin e Buxhetit kemi kërkuar sqarim dhe nuk na është dhënë ndonjë sqarim se çka janë këto shpenzime të tjera, do me thënë 35 mijë euro e më shumë janë shpenzime të tjera që ne nuk e dimë çka janë ato, dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë kishte pasur dëshirë dhe kërkon të dijë se çka janë këto shpenzime. Gjithashtu, shohim për shembull, atje diku janë 112.000 avance të paarsyetuara. Por, të nderuar kolegë, më shqetësuese është shuma prej 8.000.000 euro, e cila është ndarë për statusin e Kosovës dhe fatkeqësisht as në vitin 2006 e as në vitin 2007 nuk shohim nuk shohim në raportet e dy viteve kah janë shkuar këto mjete. Edhe lidhur me kërkesën që unë e kam shtruar edhe në Komisionin e Buxhetit, nuk është dhënë një sqarim.

Për ta përmbyllur, mos t'ju marrë kohë shumë kolegëve, edhe njëherë para këtyre kolegëve kërkoj në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë që të na vijë një raport i plotësuar për të gjitha këto vërejtje që i dhashë, në veçanti për shumën për 8.000.000, nuk janë pak, 8. milion nuk dua të paragjykoj, as nuk po paragjykon askush, por është obligim i yni, si deputetë, të kërkojmë dhe i Qeverisë të na raportojë se ku janë shpenzuar dhe si janë shpenzuar këto mjete. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Dozvolite da Vas pozdravom, gospodine predsjedniče, prisutne ministre, kolege, gosete,

Današnja sednica je sigurno jedno od rado slušanih u javnosti Kosova, jer prvi put govorimo o nekim nepotrošenim sredstvima, o suficitu, o milionima koji nisu planirani, koji su došli, i tako dalje. E sad, ne znamo neki će reći, pa što će nam Donatorska konferencija juna ili oktobra, pa evo imamo para. Medjutim, pokazaće druga polovina godine kako ćemo menadžirati ono što nije planirano, o čemu su renomirani ekonomisti, gospoda ministri Šalja, zatim ekonomista Koci, bivši ministar Šatri, ekonomista, Gadžeri i tako dalje, govorili tako da mi koji nismo ekonomisti vrlo rado slušamo ove brojke, ali se i pitamo šta ćemo kada krene lavina zahteva iz službi kojima nismo udovoljili već godinama kada su u pitanju lični dohodci, kada su u pitanju zaposleni u obrazovanju, kada su u pitanju zaposleni u Policijskoj službi, kada su u pitanju socijalna struktura, recimo penzioneri, invalidi, i tako dalje. Kako ćemo objasniti stopiranje ličnih dohodaka a već ovde operišemo brojkama i milionima, neplaniranim viškovima. Tako da mi u našoj Poslaničkoj grupi pozdravljamo, brižno pripremljeni izveštaj, pozdravljamo nove izvore, ali sa iščekivanjem očekujemo drugu polovinu godine, kako će to sve da se uklopi u ono što zovemo budžetsku godinu u drugoj polovini 2008.

U svakom slučaju, mi se pridružujemo kolegama koji podržavaju ovaj izveštaj, nadamo se da ćemo pronaći mere i načine kako da sredstva uklopimo i ponajbolje iskoristimo. Hvala Vam još jednom!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar SLS. Fjalën e ka deputeti Sllobodan Petroviq.

SLLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsedniče Skupštine,

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Uvaženi kolege,

Želim pre svega da se zahvalim ministru na iscrpnom izveštaju i korektnom objašnjenju, svakako da ja nisam ekonomista ili finansijski ekspert, ali svakako...

KRYETARI: vazhdo, vazhdo!

...U svakom slučaju, želeo sam da se zahvalim ministru na iscrpnom izveštaju i korektnom objašnjenju. Svakako da će grupa Samostalna liberalna stranka u načelu podržati ovaj izveštaj. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Tani është fjala e deputetëve të paraqitur për diskutim. Fjala është për deputetin Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Pasi që zotëri Gjini foli në emër të Grupit, unë do të flas për atë se çka është biseduar në Komisionin për Buxhet dhe financa. Ne e përgëzojmë këtu zotëri ministrin Shala, por edhe në takim në Komision, zotëri zëvendësministrin Bedri Hamzaj, i cili në mënyrë korrekte ka paraqitur Raportin e vitit 2007.

Unë do të jem shumë i shkurtër dhe shumë i qartë, them se ne si deputetë dhe Ministria për Ekonomi dhe Financa, Komisioni për Ekonomi dhe Financa, shumë është më mirë që të ulemi dhe të bisedojmë për buxhetin e vitit 2009, se në shumë vende normale fillojnë 6 -7 muaj përpara të përgatiten për buxhet, se sa të merremi me Raportin e vitit 2007. Raporti 2007 është në mënyrë analitike dhe sintetike edhe pse jo në mënyrë detale, por zëvendësministri atë ditë ka qenë i gatshëm që t'i japë të gjitha sqarimet, kush ka kërkuar nga deputetët në Komision dhe atë e ka paraqitur në mënyrë korrekte.

Këtu duhet të thuhet ajo çka është pozitive, por duhet të thuhet edhe ajo çka është negative. Pozitive duhet të thuhet se ka pasur rritje të zhvillimit ekonomik, a ka pasur një, dy apo tre dhe tani kërkojmë që vitin tjetër kjo Qeveri të ketë një rritje edhe një shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik, për arsye se të gjithë jemi të interesuar si pozita, si opozita të kemi një zhvillim të hovshëm ekonomik. Dhëntë Zoti që Ministri i Ekonomisë dhe Financave, që është kolegë i gjeneratës dhe i profesionit, të dalë këtu në

vitin tjetër, tash një vit dhe të thotë: - kam pasur rritje 15% dhe të mundim edhe ekonominë kineze, edhe gjermane, dhe kështu do ta kishim zvogëluar edhe papunësinë.

Mirëpo, për shkak të zhvillimit aktual ekonomik, kjo do të jetë shumë, shumë e pamundshme. Unë dëshiroj që ky trend pozitiv i Qeverisë së kaluar, me një zhvillim të tillë të vazhdojë me një shkallë edhe më të lartë të zhvillimit ekonomik, sepse vetëm me një zhvillim ekonomik mund të kemi perspektivë. Arsyeja, veç të ndalemi në 32% të shpenzuar nga buxheti i Kosovës është për të ardhura personale, e duhet të themi se të ardhurat personale më të ulëtat në rajon janë në Kosovë. Ka nevojë që të ngriten edhe 100% edhe për arsimtarë, edhe për mjekë, dhe sikur kjo të ndodhte, atëherë përmbi 60, 70% të buxhetit do të ishte harxhuar vetëm për të ardhura personale. Ky 32% me siguri do të jetë i përcjellë edhe në vitin e ardhshëm dhe shumë vite, derisa të kemi një normë të zhvillimit ekonomik.

Unë dëshiroj të them që ky Raport ka qenë një raport. Them pozitiv për arsye se është bartë edhe nga ministri dhe zëvendësministri, të cilët nuk e kanë menaxhuar këtë buxhet, por e kanë treguar ajo çka është pozitive dhe ajo çka është negative. Edhe neve na brenë suficiti dhe 32% që e ka kritikuar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar që të harxhohet për të ardhura personale. Unë besoj se ne, si deputetë, edhe të pozitës edhe të opozitës, duhet të kontribuojmë në mënyrë pozitive dhe jo atë çka është negative të themi se është e Qeverisë së kaluar dhe kjo çka është pozitive, është e kësaj Qeverie. Kosova nuk fillon historinë që nga sot, por duhet, ajo çka është e mirë të thuhet, dhe ajo çka është e keqe të eliminohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani për diskutim është me radhë deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Siç po shihet këtu, në prononcimet që i patën dy grupet që e përbëjnë koalicionin, kemi të bëjmë me silogjizma të kundërta...

KRYETARI: Lus deputetët që të kthehen në sallë!

DRITON TALI... njëra logjikisht është fals, dhe tjetra është më afër të së vërtetës. Mendoj se në këtë rast silogjizmi fals apo elefanti rozë, është se buxheti ka qenë në rregull, se janë tejkaluar planifikimet, se janë ulur shpenzimet në mallra dhe në shërbime nga fakti se shtrohet pyetja sa i keni planifikuar ato. 17% të shpenzimeve në mallra dhe shërbime, nuk është një shumë logjike, ashtu dhe 32% në paga dhe mëditje, duke marrë parasysh se në këto hyjnë edhe shpenzimet banale të cilat mediat i raportojnë për çdo ditë, si në gardëroba e në reprezentacione, e tjera, dhe kjo është si rezultat i keqmenaxhimit të buxhetit.

Ai silogjizmi, do me thënë elefanti në dhomë bie. Megjithatë, mendoj se këtu duhet përfunduar, është tepërca 397 milionëve apo 30% më pak të investimeve kapitale, të cilat do me thënë hapin vende të punës, investimet kapitale. Ato nuk janë realizuar 30%,

do me thënë 30% më pak vende të punës, ndonëse kjo zakonisht ka efektin e shumëzuesit dhe çdo koment i mëtutjeshëm mendoj se është i tepërt.

Shpresoj se kjo Qeveri do të ketë kujdes me sorflusin, me suficitin, sidomos në këtë depresionin ekonomik, me të cilin po ballafaqohemi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë, duke e lexuar këtë raport dhe duke e bërë një analizë krejt empirike, parafytyroja përpiluesit e tij se sa vështirësi kanë pasur ata për t'i barazuar shifrat.

Kjo më së miri ilustron, do të thotë, dallimin, dallimin shumë të vogël në mes të investimeve kapitale dhe pozicionit - shërbime dhe mallra. Është e pajustificueshme që të futen 35.955.000 euro si shpenzime të tjera. 35.955.000 euro, lexoje mirë zotëri Hyseni, këtu që e kam te mallra dhe shërbime, është do me thënë 35.955.000 euro shpenzime të tjera. Kjo do të thotë, sigurisht që do të duhet të kërkohet. Ne po flasim për një raport ku nuk mund t'i kërkojmë llogari kësaj Qeverie. Po ashtu, edhe te mirëmbajta dhe riparime, shpenzime 20.000.000 janë tepër shumë, kështu që do t'i sugjeroja Qeverisë aktuale që këtë raport ta analizojnë se si nuk do të duhej ta menaxhojë buxhetin gjatë këtij viti fiskal, sepse dihet që ne në programin e Qeverisë dhe në buxhetin e aprovuar për vitin 2008, janë të planifikuara të gjitha pozicionet buxhetore dhe shpresoj, nëse do të vazhdojë me këtë ritëm dhe me këtë intensitet, që është duke punuar Qeveria e Kosovës, edhe do të futet në deficit se jo që do t'i mbetet suficit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ju njoftoj se të lajmëruar të tjerë për diskutim nuk ka. Në sallë janë 64 deputetë. Në vazhdim kërkohet që të deklarohemi për miratimin e Raportit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Ju njoftoj se në sallë janë 66 deputetë.

Konstatoj se me 47 vota "Për"...Urdhëro

ABESA GAXHERRI: Kjo le të jetë vetëm sa për procesverbal. Unë kërkoj falje se gabimisht votova "pro", jam "kundër". Kjo është e para, dhe e dyta, kërkoj falje për shumën që më kujtohet se kam thënë 35.000 euro, por është vërtetë 35.000.000. Ndoshta edhe në procesverbal apo në transkript kur të vjen do ta bëjnë përmirësimin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Më së miri është atëherë. Tani i kemi 47 vota "për", megjithatë po e zbresin një - 46 vota "për", 13 janë "kundër", 6 abstenime dhe konstatoj se miratohet Raporti i Qeverisë për vitin 2007.

Në radhë është pika e shtatë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencionit Kundër Korrupsionit

Le të deklarohej shëfati i grupeve parlamentare çka po kërkojnë!

Të nderuar deputetë, në bazë të konsultimit që patëm, mendojmë që pika e cila ishte në radhë të hiqet nga rendi i ditës, edhe pikat e tjera në vazhdim, përveç pikës së 9-të:

9. Shqyrtimi i propozimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e trasesë për ndërtimin e autostradës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit, si zonë me interes të veçantë publik në Kosovë.

Këtë pikë duhet ta përfundojmë sot, ndërsa nesër në orën 12,00 vazhdojmë seancën me pikat e tjera të rendit të ditës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar Projektin për shpalljen e hapësirës, trasesë, zonë me interes të veçantë publik në Kosovë, për ndërtim të autostradës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit dhe ka kërkuar nga Kuvendi miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe Komisioni për Ekonomi, Tregti, industri, Transport dhe Telekomunikacion e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi ia kanë paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta arsyetojë propozimvendimin e Qeverisë.

Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Kosovës, përmes strategjisë zhvillimore mbështet fuqishëm tezën se infrastruktura transportuese është parakusht i domosdoshëm për një zhvillim të mbarë ekonomik të vendit tonë, si dhe për integrim funksional në infrastrukturën transportuese regjionale dhe atë evropiane.

Në këtë kontekst, investimet intensive në programin e ndërtimit të autostradave, morën një rol fundamental, sidomos kur elaborohen efektet pozitive të shumanshme që i sjellin ato.

Këto investime reflektojnë filozofinë e një zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë, që ka për qëllim kryesor rritjen kohezionit ekonomik dhe social të shtetit tonë. Padyshim, një filozofi e kështu është dëshmuar si induktor i zhvillimit të brendshëm dhe regjional të shumë shteteve.

Shikuar nga ky prizëm dhe me këtë frymë zhvillimore, drejtimet rrugore Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit janë dy autorrugët prioritare të rrjetit dhe të transportit rrugor të Kosovës, që janë thelbësore si për koherencën e brendshme të Kosovës, ashtu edhe për ndërlidhje me shtetet fqinjë. Këto dy autorrugë do ta lidhin Kosovën edhe më shumë me shtetet evropiane dhe do t'i sjellin asaj përfitime në shumë sfera që janë jetike për prosperitetin e gjithmbarshëm ekonomik dhe shoqëror.

Autorruga Morinë – Merdarë do të lidhë Kosovën me pjesët e tjera të Ballkanit Jugor, nga Jugu me portin e Durrësit në Shqipëri, me Korridorin 8 të rrugëve panevropiane dhe nga Veriu me Korridorin 10 të rrugëve panevropiane. Këto korridore kanë potencial për zhvillime ekonomike të vendeve të Ballkanit Jugor, me detin Adriatik dhe me vendet e Mesdheut.

Ndërkaq, autorruga Prishtinë – Hani i Elezit, lidhë me Korridorin 8 dhe 10 të rrugëve kryesore panevropiane të transportit, i cili mundëson gjithashtu lidhjet më të mira që përbëjnë impulse të reja të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Sa i përket autostradës Morinë – Merdarë, është përfunduar projekti zbatues, studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi të ndikimit në mjedis, është realizuar evidencimi i pronave si dhe është bërë paramasa dhe parallogaria specifike dhe teknike, përveç se në këtë projekt zbatues janë evidentuar disa mangësi, të cilat duhet të plotësohen ose të revidohet projekti, sidomos në pjesën e studimeve të gjeomekanikës për të cilën besojmë që do të përzgjidhet kompania e cila do ta bëjë revidimin dhe mbikëqyrjen e gjithë projektit të rrugës. Prandaj, po ashtu është publikuar edhe shprehja e interesit për këtë autostradë. Gjatësia e përgjithshme e trasesë është 117 kilometra, autostrada lidhë dy pikat kufitare, nën kyçe, 105 ura dhe tre tunele me gjatësi totale 5 kilometra, me mundësi të ndryshimeve.

Sipërfaqja e nevojshme për ndërtim është: $S = 1062.2786$ ha, prej të cilave është $S = 376.2420$ ha ose 35.42% është pronë shoqërore dhe $S = 686.0366$ ha ose 64% e saj është pronë private. Kostoja e përgjithshme, atëherë kur është bërë projekti, është llogaritur në 659.000.000 euro, ndërsa tani do të shihet sipas çmimeve të tregut.

Ekzekutimi i punimeve në segmentin e parë Vërmicë –Prizren pritet të fillojë gjatë këtij viti.

Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit ka një gjatësi rreth 75 km., ndërsa segmenti A i trasesë kryesore saj do të jetë 35 km. Ministria e Transportit vlerëson se zgjidhja më e mirë për një investim afatgjatë në këtë korridor, është të ndërtohet një rrugë e re, me parametra të autostradës. Kjo është edhe një vlerësim që e ka bërë Banka Botërore ose një fizibilitet. Korridori ose rruga e re me parametra të autostradës do të ndërtohet, do të fillojë nga udhëkryqi i Lipjanit deri tek udhëkryqi Doganaj, pjesa e parë ose segmenti A, dhe pastaj do të vazhdohet deri në kufi me Maqedoninë, në Hani të Elezit. Për sa i takon kësaj autostrate, jemi në pritje të hartimit të projektit kryesor. Dhe për këtë është një ofertë konkurrimi ku presin kompanitë, të cilat janë të interesuara për të marrë përsipër hartimin e projektit kryesor. Besoj se shumë shpejtë do të bëhet përzgjedhja e

kompanisë, e cila do të bëjë hartimin e këtij projekti dhe presim që për vitin e ardhshëm të jemi të përgatitur për fillimin e punimeve edhe në këtë autostradë.

Këto autorrugë, si arteriet më të mëdha transportuese përbëjnë lidhjen kryesore të Kosovës me qytetet më të mëdha në fqinjësi, si dhe me rrjetin rajonal të transportit në Evropën Juglindore. Ato në të njëjtën kohë lidhin edhe qytetet dhe qendrat kryesore të vendit tonë, ato paraqesin impute produktive për rritjen ekonomike, me të cilën janë në korrelacion pozitiv dhe si të tilla përbëjnë njërën nga forcat drejtuese, domethënëse të aktivitetit ekonomik.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto dobi ekonomike që mund t'i sjellin këto dy autostrada, i tejkalojnë të gjithë kufijtë, pra këto dy korridore janë me interes të veçantë nacional për shtetin tonë. Prandaj, edhe Kuvendi i Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Transportit, propozimin e Qeverisë, kërkon nga ky Kuvend t'i shpallë si zona me interes të veçantë këto dy korridore. T'i shpallë me interes të veçantë për shkak se, siç thashë, është në interesin e veçantë të vendit tonë, që ne tutje të fillojmë në realizimin e këtyre projekteve vitale, vepra të mëdha kapitale që do t'u shpërbejnë gjeneratave që vijnë, do t'i shërbejnë ekonomisë së Kosovës, do t'iu shërbejnë qytetarëve të Kosovës, prandaj kërkojmë nga Parlamenti që të votojë këto dy korridore si dy zona me interes të veçantë për vendin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Gani Koci, në emër të Komisionit.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2008, ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për shpalljen e këtyre hapësirave trase, zonë me interes të veçantë publik për Kosovën, dhe të njëjtat ia ka sjellë Kryesisë së Kuvendit për shqyrtim rekomandimet e veta, të cilat janë:

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar këtë propozim dhe e ka miratuar si propozim që ka një interes të veçantë nacional dhe kërkon nga Kuvendi që propozimi i tillë të marrë miratimin dhe pëlqimin e Kuvendit, pikërisht duke pasur parasysh këtë interes. Gjithashtu, në Komisionin për Buxhet dhe Financa është kërkuar nga Qeveria që sa më parë të insistojë që të nënshkruhet Ligji i miratuar vitin e kaluar mbi shpronësimet, sepse pikërisht kjo ka të bëjë me fillimin e shpronësimeve në këtë pjesë, në këtë hapësirë me interes të veçantë, dhe duke pasur parasysh se është një projekt shumë madhor dhe kërkon investime shumë të mëdha, po ashtu Komisioni ka kërkuar nga ministria përkatëse që shumë shpejt t'i adresojë Kuvendit Projektligjin për koncesionet. Vetëm me një projektligj të tillë dhe me një ligj të tillë ne mund të fillojmë realizimin e projekteve të mëdha duke i pasur parasysh kapacitetet tona jo të mjaftueshme buxhetore për realizimin e këtyre projekteve.

Dhe, një rekomandim tjetër, sepse përveç këtyre projekteve madhore, ne kemi edhe projekte të tjera, të cilat në të kaluarën vetëm janë nisur dhe ka qenë pikërisht mënyra e shpronësimit dhe procedurat e shpronësimit që kanë mbetur pa u përfillur dhe pa u

realizuar këto projekte. Kërkohet që në projektet të tilla të ngjashme gjithnjë të kërkohet shpallja e interesit të veçantë, ashtu siç kërkojnë, po them, normat ligjore të zbatueshme të shpronësimit, por edhe të ligjit të ri që s'është nënshkruar mbi shpronësimin. Këto ishin rekomandimet e Komisionit dhe besoj që Qeveria dhe Ministria përkatëse do t'i marrë parasysh dhe lus Kuvendin që ta miratojë këtë propozim të Qeverisë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për deputetët brenda në seancë,

Me datën 23.05.2008 Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në bazë të rregullave numër 36 dhe 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni shqyrtoi Projektvendimin e Qeverisë për shpalljen e hapësirës tranzonë me interes të veçantë publik në Kosovë për ndërtimin e auto-udhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit dhe u pajtua me këtë Projektvendim të Qeverisë, duke nxjerr këtë rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që ta miratojë Projektvendimin e qeverisë për shpalljen e hapësirës tranzonë me interes të veçantë publik në Kosovë për ndërtimin e auto-udhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit, që të ndërmarrë veprime procedurale në Zyrën e PSSP-së për shpalljen e Ligjit për shpronësim nr. 2L97 të miratuar në Kuvendin e Kosovës më 8.02.2007 dhe t'i rekomandojë Qeverisë të themelojë një Komision të pavarur profesional që do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë shpronësimit të zonës nëpër të cilën do të ndërtohet auto-udha Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit. Presim që këtë ta miratoni ju brenda Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Konsideroj që deputetët që folën, kanë folur edhe në emër të grupeve parlamentare. Për fjalë e kisha lutur shefin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ose dikush në emër të Grupit Parlamentar.

Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Unë me kënaqësi do t'ia lija profesorit Sabri Hamiti por e kam amanet prej Lutfi Haziri që të deklarojmë që jemi pro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar, ministra,

Definitivisht, ne e mbështesim këtë proces, mirëpo e kemi një çështje e cila na ka dalë pak si ndryshe tash. Kjo çështje ka të bëjë me rutën 6, do të thotë, rruga Hani i Elezit – Prishtinë – Pejë edhe kufi me Malin e Zi është quajtur ruta 6. Ka qenë një segment i

përbashkët dhe kemi dilema pse është hequr gjysma e kësaj rute, e rutës 6, do të thotë pse nuk parashihet që edhe pjesa prej Prishtinës deri në Pejë dhe në kufi me Malin e Zi të shpallet zonë me interes të posaçëm. Kjo është ajo që na intereson ne për shkak se më përpara në Komitetin Drejtues për këto autostrada, ku kam qenë edhe unë, është folur për autostradën Merdarë – Morinë, janë hartuar projektet, është mbyllur projekti, si i tillë, dhe ka filluar hartimi i projektit të rutës 6, bile, bile ka pasur edhe mjete të ndara, e ruta 6, edhe një herë po ju them, është Hani i Elezit – Prishtinë – Pejë – Rozhajë, nuk është vetëm Hani i Elezit – Prishtinë. Kjo është një befasi për ne, kemi pritur që edhe kjo pjesë e autostradës, që edhe ajo pjesë e Kosovës, që ne i themi Dukagjin, do të jetë e barabartë në prioritet për lidhje me kryeqendrën. Ju e dini qysh është rruga, dhe po besojmë që ose shumë shpejtë, ose sot ministri do të na tregojë se edhe ajo pjesë duhet të lidhet me autostradë, edhe ajo pjesë është prioritet i njëjtë, edhe në atë pjesë duhet të shpallet zona me interes të posaçëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri zoti Fatmir Limaj.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Së pari, besoj që pjesa dërmuese e kolegëve këtu e dinë, ne po vazhdojmë një projekt i cili ka nisur që kah moti, po e shtyjmë përpara dhe kemi thënë, jemi zotuar që do ta vazhdojmë realizimin e të gjitha projekteve të cilat kanë mbetur pa u realizuar që është normal duhet kohë dhe nuk po bëjmë asgjë tjetër, por po e shtyjmë një projekt i cili ka nisur më herët.

Ju dokumentin e keni pasur në duar. Dokumentin të cilin e keni shqyrtuar ka qenë njëherë nëpër komisione, në të kaluarën, në Parlamentin e kaluar, dhe t'ju them të drejtën, ne asgjë nuk kemi shtuar nga ai dokument. Kështu që, atë çka e keni sot, ka qenë edhe në përbërje të kaluar të Parlamentit dhe ne as nuk kemi hekur dhe as nuk kemi shtuar, përveç rrugës Prishtinë – Shkup, për të cilën është fizibiliteti i bërë nga Banka Botërore, ka qenë i bërë më herët dhe ne duam ta fillojmë realizimin ose bërjen e projektit ekzekutues. Kjo është e vërteta. Tjetër, normalisht që ne, nuk ka qenë në projekt, por sivjet jemi në projekt të fillimit dhe të sigurimit të rrugës, zgjerimit të rrugës në drejtim të Pejës dhe ky është projekt që ne e kemi futur dhe do të shkojmë në zgjerimin e rrugës, ruta gjashtë, siç e tha edhe deputeti, ndërsa tani do të ecim deri në Aeroport. Ideja është që faza e parë është deri ne Aeroport, për të vazhduar më tutje.

Një gjë dua t'ju siguroj, që të mos i lajthitim qytetarët, edhe ju ftoj juve si deputetë të jemi koherent në këtë që Kosova është aq e vogël sa që nuk ka nevojë dhe nuk do të lejojmë të ndahet në krahina, në rajone, në të ashtuquajtura nga vijnë ministrat, në ashtuquajtur diskriminimi i një zone dhe dhënia e përparësisë një zone tjetër. Këtu më së miri flasim projektet tona. Në Dukagjin sivjet investohet, krejt çka është investuar për 8 vite, vetëm në këtë vit në Dukagjin, në të gjitha komunat e Dukagjinit, dhe kjo tregon që ne nuk veprojmë në atë kuptimin ta heqim një pjesë, ta shtyjmë një pjesë, ta motivojmë një pjesë, ta anashkalojmë një pjesë, sepse Kosova është aq e vogël sa që... dhe ne këtu jemi për t'i shërbyer në tërësi vendit, prandaj ne po fillojmë me kapaciteti që e kemi, do të shkojmë me rrugën e parë ose me autostradën e parë, kufi Vërmicë – Merdarë, por normalisht në vitin e ardhshëm do të vazhdojmë për Shkup – Prishtinë, për të vazhduar në drejtim të Pejës. Padyshim, objektivi kryesor është që edhe kjo rrugë të lidhet me

autostradë Prishtinë – Pejë – Mali i Zi. Mirëpo, ne nuk mund të japim premtime se do të fillojmë nesër këtë, sepse mundësitë tona janë jashtëzakonisht të vogla për këtë projekt kaq ambicioz. Do të fillojmë me Vërmicë e pastaj, sipas mundësive, do të vazhdojmë me projekte të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për replikë është lajmëruar Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ekzakt, ministri e tha qartë. Projekti, i cili ka ekzistuar për rrugën Merdar – Prishtinë – Prizren – Vërmicë nuk ka ndryshuar asgjë. Mirëpo, ruta e gjashtë, nuk ka qenë vetëm segmenti i rrugës Hani i Elezit – Prishtinë. Ruta e gjashtë është Hani i Elezit – Prishtinë – Pejë – Rozhajë. Kjo është ruta e gjashtë.

Unë vetëm pyeta – pse, kur është përzgjedhur ruta e gjashtë, nuk është përzgjedhur e gjithë ruta e gjashtë për t’u bërë shpallje e zonës me interes nacional, por është zgjedhur vetëm segmenti – Hani i Elezit – Prishtinë, sepse kjo ka ndodhë. Ne, në dokument, këtë e kemi, dhe thotë: “Hani i Elezit - Prishtinë“ do të thotë vetëm një pjesë e rutës së gjashtë shpallet zonë me interes të posaçëm. Pse nuk shpallet edhe pjesa tjetër. Kjo ishte pyetja dhe mendoj se është pyetje plotësisht legjitime dhe nuk ka të bëjë me atë që tha ministri me autostradë Merdarë – Morinë dhe është kjo krejt në rregull.

Do me thënë, edhe një herë: Pse është zgjedhë vetëm ky segment?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, urdhëroni ministër! Ministri Limaj e ka fjalën.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Nuk e di, më duket e sqarova. Ne jemi në fazën e parë. Po futemi në hartimin e projektit Prishtinë-Shkup, për të vazhduar në fazën e dytë në drejtim të Pejës. Mendoj se jam jashtëzakonisht i qartë. Po futemi në fazën e parë të hartimit të projektit Prishtinë-Shkup si segment i parë dhe për të vazhduar në drejtim të Pejës dhe në segmentin e dytë për të përmbushur rutën e gjashtë. Tani ne nuk kemi kapacitete të mjaftueshme për t’u futur atje, sepse për trasenë e re për Pejë, ende nuk dihet a do të shkohet e reja apo e vjetra. Duhet një fizibilitet ta kemi për të vazhduar më tutje. Tani e kemi fizibilitetin vetëm për Prishtinë-Shkup. Mbi bazën e këtij fizibiliteti të studimit ne kemi hapur ofertën për hartimin e projektit në këtë segment. Nuk kemi asnjë studim nga Prishtina për Pejë. Atë që e flet deputeti i nderuar, flet për ato projekte SITO. Është projekt i Evropës Juglindore dhe nuk është ende projekt i Kosovës dhe nuk ka filluar ende të realizohet. Do të thotë, ju po flitni me diçka që është paraparë në kuadër të SITO gjë që, padyshim, është një nga objektivat tona por tani për tani ne po shkojmë me fazën e parë.

KRYETARI: Faleminderit zoti ministër. Për një sqarim paraqitet Gani Koci, shkurt.

GANI KOCI: Megjithatë, dëshirat duhet të dallohen dhe të ndahen nga ajo që është ligjore dhe që është procedurale. Ligji i shpronësimit e thotë troç se shpallet zonë e

interesit atëherë kur pala ose subjekti ka një plan dhe ka një fond që ka të destinuar shpronësimin dhe për këtë vit është fondi i shpronësimit i dedikuar për projektet që i diskutuam këtu dhe ai fond është 49 milion euro. Prandaj, në momente kur bëhen studime dhe krijohen fonde për shpronësime, tek atëherë vjen në shprehje edhe shpallja e interesit. Pa u krijuar fondet për realizimin e shpronësimit nuk mund të shpallësh sferë të interesit apo zonë të interesit, as nacional, as lokal. Kjo është ajo që nuk janë shpall zona tjera, sepse nuk ke buxhet të shpronësimit. Në vitin tjetër, besoj do t'i bëjmë këto. Duhet lexuar ligjet pak më shumë, po edhe ato dispozitat që janë të kaluara, sepse pak dallon ligji i shpronësimit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka kërkuar Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të çmuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Lidhja e Kosovës me rajonin dhe korridoret 8 dhe 10 si korridore pan-evropiane është tejet e rëndësishme dhe është një investim kapital dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit.

Zoti ministër, e ceku edhe kolegu – deputeti zoti Koci, pa Ligjin për shpronësimet, Ligjin për koncesione, i cili ka kaluar njëherë nëpër këtë sallë të këtij Parlamenti të nderuar, në legjislaturën e kaluar dhe është në Zyrën e PSSP-së, nuk mund të shkojë kjo punë si duhet. Prandaj, ju lutem, duhet të merren hapa të studiuar, të respektohen ligjet dhe nëse është e nevojshme, të nxirren ligje të reja adekuate, sepse realisht janë projekte nacionale dhe këto nuk bëhen për çdo legjislaturë, por bëhen për breza të ardhshëm dhe për Kosovën.

Unë e kam edhe një pyetje: I cekët mundësitë e ndryshimeve të vogla. A është çështja për ndryshime të projektit të fizibilitetit. Mos të harrojmë, traseja e autostradës Merdarë – Prishtinë – Morinë është ndryshuar një herë dhe ne nuk kemi llogari, si qytetarë të Kosovës, si institucione dhe si shtet për çdo tre muaj të ndërrojmë trase të rrugëve nacionale. Sepse, janë dhënë mjete nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dyfish më shumë pa u planifikuar fare.

Këtë sqarim kisha dashur ta kem edhe për hir të rëndësisë së këtij projekti edhe për hir të opinionit publik dhe ta dinë qytetarët e Kosovës se kah po shkon ky projekt i kësaj rëndësie nacionale.

Dhe, krejt në fund, zoti ministër, është e domosdoshme që orientimet, prioritetet buxhetore të dikasterit që ju e udhëhoqi në Qeverinë e Kosovës, për çka cekët se janë këtu rreth 50 milion euro, e kanë qenë edhe në draft-ligjin e buxhetit që tani është Ligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, a menduat se sivjet do të filloni me fazën e shpronësimit dhe të përgatitjeve të procedurave ligjore dhe dokumentacionit të nevojshëm apo keni menduar që të filloni me punët në projektin e studiuar të fizibilitetit në trasenë aktuale që është baruar nga qeveria e kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka Hestet Cakolli.

HESET CAKOLLI: I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar ministra dhe të respektuar kolegë deputetë,
Ne sot po diskutojmë për një studim të fizibilitetit për vlerësimin e mjedisit për dy akset kryesore rrugore në Kosovë:

1. Rruga numër 7 Vërmicë – Prishtinë – Mërdarë, dhe
2. Rruga numër 6 Prishtinë – Hani i Elezit.

Këto akse rrugore mundësojnë lidhjen me korridorin 10 i cili kalon nëpër Serbi dhe me korridorin 8 që kalon, po ashtu, nëpër republikën ish-jugosllave të Maqedonisë. Prandaj, këto dy akse rrugore janë të një rëndësie të veçantë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, si dhe mundësojnë lidhjen me rrjetin rajonal të transportit rrugor në Evropën Juglindore dhe më gjerë.

Fizibiliteti është i paraparë të realizohet për periudhën pesëvjeçare në shumën prej 400 milion euro për akset rrugore numër 7 dhe numër 6. Ky studim ka disa paqartësi. Për shembull, projektet e urave në autostrada, mbikalimet, nënkallimet, muret mbrojtëse, shqyrtimet gjeologjike thuhet se janë të përfunduara dhe duhet pritur të dorëzohen deri në marsin e vitit 2007, ndërsa traseja e rrugës nuk është e identifikuar saktë dhe nga kjo del se mungon projekti kryesor këtyre dy rrugëve.

Rruga numër 6 nga QMI deri te kufiri me ish-republikën jugosllave të Maqedonisë është i ndarë në katër segmente, ku segmenti 6-5 përfshinë pjesën e rrugës Lipjan – Ferizaj dhe segmenti 6-6 pjesën e rrugës Ferizaj – Doganaj janë paraparë dy variantat.

- a) Ndërtimi i rrugës së re dyshiritore dhe është menduar që të sigurohet tokë e rezervuar për auto-rrugë në të ardhmen sipas standardeve evropiane, dhe
- b) Zgjerimi i rrugës ekzistuese me katër shirita në segmentet 6-5 dhe 6-6.

Versioni i dytë do të krijonte probleme më të mëdha mjedisore për shkak se kjo pjesë e rrugës kalon nëpër hapësira të urbanizuara. Ndërsa segmenti i rrugës 6-7 është analizuar vetëm një version dhe ky version parasheh zgjerimin e rrugës ekzistuese me katër shirita në mes pjesës Doganaj dhe Kaçanikut, si dhe rrugë me tre shirita në mes të Kaçanikut dhe kufirit deri në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë.

Shuma e investimeve për rrugën numër 6 në këtë pjesë – Prishtinë – Hani i Elezit, kap shumën diku rreth 97.500.000 euro, ndërsa projekti është paraparë të përfundojë deri në vitin 2012.

Për t'u realizuar ky projekt, ne mendojmë se duhet të implementohet Ligji për shpronësimin e tokës, si dhe të bëhen studime më të hollësishme për variantin e parë dhe të dytë dhe Qeveria të dalë me një propozim konkret për variantin që do të ishte më optimal për realizimin në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Faleminderit zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Ja mislilm da su oba ova putna pravca Vermnica – Merdare i Hani i Elezit – Prishtina od nacionalnog interesa i mi kao Parlamentarna grupa „7+“, zato što je ovaj projekat započeo, znači idejni projekat još od prošlog mandata, mislimo da dajemo podršku i zaista neka Ministarstvo krene da radi. Znači, ima našu podršku jer Kosovo ima potrebe da se približi svetu i prema Makedoniji, i prema Albaniji i prema Srbiji i mislim da je to od nacionalnog interesa. Svi poslovi koji proizilaze iz ovoga, iako će biti problema oko imovinskih odnosa i tako dalje, ali Ministarstvo, koje je dobro krenulo, ima našu podršku. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të SLS, deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se!

Poštovani predsedavajući, zameniče premijera, uvaženi ministri,
Dame i gospodo narodni poslanici,

Želim da odmah kažem da je ovo jako bitno i da će Poslanički klub Samostalne Liberalne Stranke podržati predlog Vlade, ali dozvolite mi da dam jedan komentar i koristim priliku da istaknem da je ovo Ministarstvo jedno od retkih koje se može videti na trenutku da se radi i ono što za mene posebno znači jeste da se radi po zakonu i da je do sada, što je svima nama jako vidljivo, da je puno te divlje gradnje i da je to Ministarstvo jedno od retkih koje se uhvatilo u koštac sa takvim jednim problemom i koristim priliku da se javno zahvaljujem i Ministarstvu i ministru što su našli način da izgrade raskrslnicu na putu Priština-Skoplje kod Lapnog sela koje je od velikog značaja ne samo za Srpsku zajednicu, nego i za sve one ljude koji žive na tom prostoru i koji koriste taj put. Još jednom se zahvaljujem i imaćete podršku za ovaj predlog. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Kërkesa e Qeverisë drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtimin e Propozimvendimit për shpalljen e traseve me interes shtetëror për autostardat Vërmicë-Mërdarë dhe Hani i Elezit – Prishtinë ka një rëndësi të veçantë dhe mendoj se të gjithë deputetët duhet ta përkrahin këtë njëzëri.

Ajo që më së shumti më habit, është se, pse u deshtë të pritet 3 vite që Qeveria t'i drejtohet Parlamentit të marrë një vendim ose një kërkesë të tillë, duke pasur parasysh se projekti ka qenë i përgatitur para 3 vitesh.

Unë dëshiroj t'i drejtohem kolegut Gjini sa i përket rutës apo drejtimeve të rrugëve tjera, përveç autostradës, duke pasur parasysh se Qeveria, e udhëhequr atëherë nga ish-kryeministri Rexhepi dhe Ministria e Transportit, i kanë përcaktuar prioritetet për të gjitha rrugët magjistrale të cilat kanë qenë të kategorizuara të shndërrohen në rrugë – autostrada, por natyrisht në faza. Kjo është bërë për shkak se në atë kohë fizibiliteti që është bërë nga Drejtoria e rrugëve ka treguar cilat segmente janë më të ngarkuara dhe pikërisht rruga e cila tani kërkohet, pra Prishtinë-Hani i Elezit, është rruga më e ngarkuar dhe është më se e nevojshme që tani të kryhet. Mirëpo, nuk mendoj se Ministria ose Qeveria dëshirojnë të bëjnë ndonjë shkëputje apo ndarje të këtij projekti sepse ky do të shkojë Prishtinë-Pejë-kufi me Malin e Zi, Prishtinë-Mitrovicë-Leposaviq-kufi me Serbinë dhe Prishtinë-Gjilan. Domethënë, është një kryqëzim i autostradave, përveç autostradës kryesore e cila ka qenë interes i përgjithshëm dhe mund të them se ka qenë kërkesë e parë kur ne ndoshta s'kemi ditur se çka është autostrada nga ish Presidenti Rugova në vitin 1994 dhe autostrada Prishtinë-Durrës të ketë përparësi ose të ndërtohet sa më shpejt. Kështu që, ne falënderojmë Ministrinë dhe Qeverinë që vërtet kanë vendosur që projektin në letër ta bëjnë projekt në vepër, gjegjësisht të fillojnë me ndërtimin e kësaj rruge dhe mendoj se ne të gjithë deputetët duhet ta mbështesim këtë kërkesë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Morina! Gjini, kërkon replikë! Shkurt!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe njëherë, nuk di pse m'u përgjigj zoti Morina, sepse unë nuk e pyeta zotin Morina, por po ju them kështu se ne e dimë që këto rrugë nuk kanë për të filluar sivjet, as vitin tjetër. Nëse sivjet shpallet zonë me interes të posaçëm për të filluar ndërtimi pas një a dy vite, pse nuk shpallet edhe ajo tjetra. Kjo ishte pyetja dhe ishte shumë e thjeshtë.

Shumë e thjeshtë sepse shpallja zonë interesi, e din shumë mirë zoti Morina, bëhet për ta ruajtur trasenë dhe të mos ketë ndërtime tjera dhe mos t'iu zënë fryma trasesë. Kjo është arsyeja pse shpallet zonë me interes të posaçëm, e jo për të filluar ndërtimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini!
(Ndërhyrje)

Po, s'keni të drejtë t'i bëni njëqind replika, kot! Hajde, Morina, edhe një herë, por shkurt.

ZEF MORINA: Më falni, por nuk është qëllimi i replikës, por qëllimi i një qartësimi. Nuk desha të replikoj apo të jap ndonjë sqarim të jashtëzakonshëm, por desha të them se këto janë bërë në kohën kur ne kemi qenë në Ministri dhe në Qeveri. Kërkesa ka qenë kur unë kam qenë ministër dhe një gjë e tillë fatbardhësisht tash po realizohet. Nuk besoj se ministri Limaj dëshiron të bëjë ndonjë shkëputje apo ndarje të projekteve që kanë qenë prioritet. Këtu ishte qëllimi.

KRYESUESI: Faleminderit! Do ta shfrytëzoja të drejtën si deputet, por pasi jam duke e udhëhequr punën, më vonë do ta bëj këtë. Fjalën e merr deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAIJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne na vjen mirë që kanë dalë në Parlament këto propozime dhe sigurisht se do t'i përkrahim dhe nuk ka nevojë të theksojmë shumë herë këtë.

Problemi ynë është që jemi pak të vonuar dhe kemi mungesë të madhe të fondeve. Po ashtu, dëshiroj të përkujtoj se vetëm hartimi i projektit për autostradën Mërdarë-Vërmnicë ka zgjatur një 5 vite dhe tash mund ta kuptojmë se sa shpejt do të mund t'i kryejmë projektet për këto pjesë tjera.

Ajo që më intereson mua, në mënyrë të veçantë, është autostrada Prishtinë-Hani i Elezit dhe veçanërisht traseja që do të kalojë nëpër qytetin e Ferizajt. Dëshiroj të kam sqarime nga ministri, sepse janë lënë disa alternativa dhe unë mendoj se traseja më e përshtatshme prej të gjitha është magjistrala, pra rruga ekzistuese për shkak se janë të koncentruara një mori shumë e madhe biznesesh dhe devijimi nga kjo trase do të shkaktonte probleme të mëdha për bizneset që janë aty. Prandaj, mendoj se një devijim shumë i vogël do të duhej të bëhej në vetë qytetin e Ferizajt, pra që të mos bie autostrada nëpër qytet por të devijojë përreth fshatit Talinofc, i cili është në periferi të Ferizajt.

E dimë se do të kemi shumë vështirësi. Vetë procesi është shumë i komplikuar, kushton mjaft shtrenjtë dhe veçanërisht procesi i shpronësimit është shumë i ngadalshëm dhe i komplikuar.

Mendoj se, megjithatë, po bëhen hapa të nevojshëm dhe është një fatbardhësi që kemi atë tepërcën e buxhetit nga viti i kaluar e që do të mundësojë sigurisht një ecje më të madhe përpara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj. Fjalën e merr deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Nuk do të diskutoj, sepse ato që kam menduar të them, u thanë nga shumë diskutues, por do t'i them vetëm dy-tri fjalë.

Sa për projektin Vërmicë-Mërdarë nuk diskutohet, sepse ai është prioritet i përcaktuar kah moti.

Sa për këto pjesët tjera, unë vetëm po ju informoj. Prej Prishtinës, në çdo regjion tejkalon normën për këto rrugë të nivelit magjstral. Një normë është 12 vetura për 24 orë e ato i kemi edhe për Elez-Han, i kemi edhe për Gjilan, për Prizren dhe për Pejë. Prandaj, këto prioritete që janë dhënë sot nga Ministria e Transportit janë për shkak të lidhjes së Korridorit 8 dhe të Korridorit 7 për Durrës.

Desha t'ua jap edhe një informatë. Edhe vetë Maqedonia, prej Shkupi, është më shumë e interesuar për këtë korridor deri në Prishtinë dhe për Durrës se sa për ta shfrytëzuar Korridorin 8, i cili nuk është ndërtuar prej Gostivari kah Shqipëria me normat për transportin e mallrave.

Prandaj, po e përfundoj. Shpresoj se Ministria do të marrë parasysh nga njerëzit tanë, të cilët merren profesionalisht me inxhinieri e ndërtimtari të rrugëve, që të mos bëjnë gabime sikur më herët që janë bërë dhe janë marrë njerëzit të cilët nuk janë profesional dhe të mos na vjen keq të kërkojmë ndihmë edhe prej regjionit për do ekspertë të cilët kanë eksperiencë për ndërtimin e rrugëve sepse ky nuk është objekt i vogël, por është madhor dhe ne eksperiencë për ndërtimin e rrugëve nuk kemi.

Propozoj, sikur edhe të tjerët që ky propozim – projektligji për koncesione sa më shpejt të aprovohet, kurse për zonën me interes të veçantë, unë mendoj se është e qëlluar të bëhet sot dhe një vendim të miratohet që propozohet nga Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk di pse kaluam në këtë pikë të rendit të ditës, edhe pse ju thatë se u morët vesh, por nuk di, si duket edhe jemi të lodhur dhe do të ishte shumë më lehtë të diskutohet për këtë propozim-vendim të Qeverisë. Megjithatë, nuk është herë e parë që po shkelen rregullat në këtë Kuvend.

Unë do t'i them vetëm dy-tri fjalë sa i përket kësaj. Në radhë të parë, ne kemi një përvojë të hidhur me shpronësimet në Kosovë dhe po përkujtoj këtë Kuvend të nderuar për çështjen ose shpronësimin e fshatit Hade që, sot e kësaj dite, kanë probleme. Prandaj, nuk do të duhej që në asnjë rast të hyhet në shpronësime të tjera pa pasur Ligjin për shpronësimet. U përmend këtu nga kolegët më herët mbështetja në ligj, por ai ligj nuk është aktiv nga se nuk është nënshkruar edhe më tutje nga ana e PSSP-së.

Po ashtu, përkrah fuqimisht edhe kërkesën e kolegut nga AAK, zotit Gjini, që në këtë gjendje çfarë jemi edhe rruga Prishtinë-Pejë të shpallet zonë me rëndësi të veçantë dhe nuk konsideroj se mungesa e mjeteve do të duhej të ishte ndonjë pengesë. Në të vërtetë, krejt kjo do të duhej të ndodhë që në të ardhmen, kur duhet të shpallet kjo pjesë, të jetë më pak e kushtueshme se sa që mund të jetë sot.

Rëndësia e rrugëve në Kosovë, ose për rëndësinë e rrugëve as që duhet të flasim, por përderisa ne nuk kemi kompletuar infrastrukturën ligjore edhe për eksproprijim, por edhe për shpronësim, do të shtroja pyetjen se kujt i ngutet që pa pasur një mbështetje mbi bazë ligjore të fortë të ndërmarrim veprime të tilla, në kohën kur ky Kuvend ka pasur dhe ka mundësi që të kompletojë infrastrukturën ligjore, me të cilën do të përcaktoheshin qartë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me këtë.

Përndryshe, ne përkrahim fuqimisht nevojën që Kosova ka dhe duhet të ketë për ndërtimin e rrugëve dhe sidomos rruga ose autostrada Merdar-Vërmicë dhe autostrada Prishtinë-Hani i Elezit dhe Prishtinë-Pejë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se Rregullorja nuk është thyer. Fjalën e ka ministri, zoti Fatmir Limaj.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, Kryetar!

Unë do të mundohem të përgjigjem në disa nga pyetjet që i bënë kolegët deputetë.

Një pjesë e madhe e pyetjeve gati thuaja është e njëjtë për nga shqetësimet që i kanë ngritur deputetët dhe mendoj se mund të jetë një përgjigje e përbashkët siç është çështja e shpronësimeve dhe e ligjeve të tjera.

Së pari, duhet t'ju them se Ligji për koncesione është në përgatitje e sipër dhe ne presim shumë shpejt të procedojmë në Parlament për koncesion. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ne mund të na ndalojë për procedimin e veprimeve paraprake për të mos humbur kohë.

Edhe ligji për shpronësim, e dini, ka qenë ligj i vjetër. Ligji i ri është miratuar nga Parlamenti dhe pritet nënshkrimi, edhe pse ka telashe edhe në këtë ligj, që pritet të nënshkruhet. Ju do të shihni se ka probleme edhe me atë ligj për shpronësim, nga i cili, kush e ka lexuar, shihet se ka probleme dhe edhe aty duhet të bëhen përmirësime.

Unë dua t'ju them një gjë: Ne po i ndërmarrim veprimet procedurale të domosdoshme duke respektuar institucionet tona me qëllim që të hapim rrugë dhe të përgatitemi të vijnë deri aty te shpronësimi.

Kujt po i ngutet, është shtruar një pyetje nga deputetët. Unë mendoj se na ngutet të gjithë ne për t'i pasur sa më shpejt rrugët tona dhe autostradën. Iu ngutet qytetarëve të këtij vendi sepse mjaft kemi pritur dhe në qoftë se ngutemi, kjo është shenjë e mirë. Mirëpo, nëse flitet për shpronësim, po sot të fillohet edhe veprimi apo ekzekutimi i punëve në autostradë, shpronësimi është se merr kohë. Domethënë, ne po përgatitemi dhe nesër sigurisht, mos harroni, jemi afër 15 qershorit, por llogaritim që më 15 qershor ai ligj i shpronësimit do të nënshkruhet nga Presidenti i vendit. Kohë kemi edhe një javë dhe ne normalisht do të bëhemi me atë ligj. Mirëpo, për derisa të bëhet atje, ne nuk mund të presim, por i kryejmë disa procedura paraprake me qëllim që të mos humbim kohë. Pra, për këtë edhe po ngutemi.

Si do të bëhet shpronësimi? Unë nuk mund të jap përgjigje si do të bëhet shpronësimi, sepse këtë duhet ta bëjë Qeveria. Kjo nuk është çështje e Ministrisë dhe duhet Qeveria të marrë vendim se a do ta bëjnë komunat veç e veç ku kalon autostrada, secila komunë në pjesën e vet, apo do ta bëjë një komision qeveritar dhe pastaj një komision mbikëqyrës sikur që kemi propozime në Parlament, këto janë çështje që mbasin të diskutohen. Nuk janë çështje të Ministrisë. Është ky projekt kapital dhe pastaj Qeveria do të japë rekomandimet e saj si do të shkohet më tutje në drejtim të shpronësimit.

Një gjë duhet ta kemi të qartë: Shpronësimi nuk mund ta ndalojë veprimin – ekzekutimin e punëve. Prandaj, edhe po e bëjmë trasenë me interes të veçantë. Ky është qëllimi i shpalljes me interes të veçantë. Ne vazhdojmë punën tonë. Atje janë të identifikuar, sikur që thashë, saktësisht pronarët e secilës pronë ku do të kalojë autostrada dhe pastaj mbi bazën e ligjit, mbi bazën e asaj që vendoset si do të bëhet shpronësimi fillon shpronësimi i të gjithë atyre pronarëve dhe kjo nënkupton se rruga nuk mund të ndalohet sa i përket ekzekutimit të punëve.

Përsëri, ishte një çështje e ngritur rreth trasesë ose rrugës – autostradës Prishtinë – Shkup, e ngritur nga njëri nga deputetët, zoti Adem, më duket. Të them të drejtën, unë nuk mund të jap përgjigje për faktin se ne nuk kemi projekt. Domethënë, po flasim për një moment kur ne kemi hapur ofertën për ta bërë projektin ekzekutues. Do të thotë, do të vjen një projekt ideor. Ideja është se ata do t'i sjellin tri projekte ideore – kompania e cila do ta fillojë punën dhe pastaj mbi bazën e saj ne duhet të vendosim se në çfarë drejtimi do të shkojmë, a do të shkojmë në rrugën magjistrale ekzistuese apo do të shkojmë me trase të re. Ju e keni të drejtë shqetësimin që e ngritni, por gjithashtu duhet të keni parasysh edhe mundësitë tona dhe shpenzimet dhe problemet. Duhet ta keni parasysh se sa probleme ka pasur nga Vetërniku deri te QMI për ta hapur atë rrugë. Dhe, imagjinoni, në atë pjesën e Ferizajt sa do të kemi telashe nëse futemi kështu.

Domethënë, këtë duhet t'ia lëmë projektit ideor dhe projekti ideor do të na ofrojë cila dhe sa është kostoja më e lirë dhe cila është më e favorshme. Po ashtu, me Ligjin mbi rrugët është obligim yni që ta respektojmë lirinë e qytetarëve. Do të thotë, nuk mund të obligohet qytetari të futet në lëvizje përmes auto-rrugës. Qytetarit je i obliguar t'ia japësh edhe rrugën alternative magjistrale në këtë rast. Auto-rruga po, por ne duhet t'i afrojmë alternativë tjetër. Nuk mund ta obligojmë qytetarin që domosdoshmërisht duhet të shkojë në auto-rrugë. Ai duhet të ketë edhe hapësirë tjetër.

Sa i përket kësaj çështjes së Pejës. Po më habit, askush s'po e përmend Mitrovicën. Është e njëjta gjë. Ne po vijmë prej Shkupi në Prishtinë dhe këtu po diskutohet. Peja s'po diskutohet dhe pse s'po vazhdohet prej Prishtinës për Mitrovicë. Është i njëjti problem. Domethënë është e njëjta gjë. Është problemi se ne po shkojmë në fazën e parë. Faza e dytë do të fillojë studimin deri në kufi, në pjesën veriore të vendit e po ashtu edhe për Pejë. Por, në ndërkohë, ne do të fillojmë punimet e zgjerimit të rrugës, siç thashë, për Aeroport në drejtim të Pejës dhe zgjerimin e rrugës në drejtim të Mitrovicës. Është një projekt dhe i njëjti me atë që është duke u punuar në drejtim të Fushë-Kosovës dhe në drejtim të QMI ose të aksit të Lipjanit.

Përsëri, te çështja e projektit. Ne do të kemi dy gjëra para sysh. U ngrit nga deputeti Rugova. Nuk do të lejojmë të krijojmë shpenzime shtesë dhe nuk do të lejojmë që të humbim kohë. Për këto dy gjëra ju siguroj: as nuk do të lejojmë që të krijohen shpenzime shtesë, sepse edhe ashtu ka pasur shumë shpenzime, por as nuk do të lejojmë që të vonohemi në kohë. Çfarëdo ndryshimi që mund të ketë, këto të dyja do t'ju sigurojmë se nuk do të ndodhin. Për këtë ju siguroj dhe besoj se do ta përcjellin vazhdimisht punën që do të fillohet.

Po them përsëri: Ne po përgatitemi të fillojmë segmentin e parë, që besoj, sivjet do të fillojë nga Vërmica për Prizren. Punët e tjera janë çështjet për të cilat Qeveria duhet të marrë vendime.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Konsideroj se janë përfunduar diskutimet. Nuk ka replikë pas kësaj ekspoziteje.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Sabriu tani më njoftoi se nuk ka kartelë. Nëse ndokush nuk ka mundësi të votojë me kartelë, atëherë le të votojë me dorë.

Ju njoftoj se në sallë janë 66 deputetë. Me kartela kanë votuar 56, me ngritje të dorës 4, do të thotë 60 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi miratoi Vendimin për shpalljen e hapësirës së trasesë zonë me interes të veçantë publike në Kosovë për ndërtimin e autostradës Morinë-Merdarë-Prishtinë-Hani i Elezit. Faleminderit!

E kemi edhe një kërkesë të Ministrisë së re të Punëve të Jashtme.

Kisha kërkuar që edhe këtë ta përfundojmë sot, sepse është çështje e ngutshme.

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë për aprovimin e buxhetit për vitin 2008 për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për aprovimin e buxhetit për vitin 2008 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë Propozim-vendimin e Qeverisë.

Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, së bashku me propozimin e Qeverisë iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci, të paraqet rekomandimet.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,

Kisha dëshiruar që të jetë këtu edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Shala, por s’qenka këtu, sepse kjo ka të bëjë shumë me të.

Unë, paraprakisht, jo për deputetët, por më shumë për qeveritarët dua ta lexoj rregullën 8 ose nenin 8 nën b) të Ligjit për buxhetin për vitin 2008, që ka të bëjë me kërkesën e Qeverisë, respektivisht të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

KRYETARI: Lus deputetët, të rrinë në sallë!

GANI KOCI: Rezerva për implementimin e statusit, në tabelën a) të pasqyrës 2 – fondet e ndara me rezervë për implementim të statusit, do të zotohen, obligohen dhe shpenzohen vetëm për mbështetjen e përgjegjësisë të reja të Qeverisë për pas statusit. Këto fonde do të lirohen vetëm për programe specifike, projekte dhe funksione të specifikuara nga ministri për Ekonomi dhe Financa me planin që aprovohet nga Qeveria dhe nga Kuvendi.

Nëse e shikojmë këtë, kërkesa e Qeverisë apo vendimi i Qeverisë, shtruar Kuvendit, nuk e plotëson këtë rregull të nenit 8 ose pikën b) të nenit 8 sepse ne si Komisioni nuk e kemi marrë një plan qoftë edhe për këtë fushë, po le më për planin e përgjithshëm për implementimin e statusit, se në çka janë të dedikuara këto 1 milion euro që janë kërkuar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e themelimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në këtë fazë dhe në këtë periudhë, megjithatë Komisioni, ndoshta në kundërshtim me këtë rregull, ka miratuar që kjo kërkesë të miratohet në Kuvend, por tërheq vërejtjen që për kërkesa të tilla të bëhen plane të detajizuara si e kërkon Ligji mbi buxhetin për vitin 2008.

Prandaj, duke pasur parasysh, po them, rëndësinë e kësaj Ministrie, sidomos në fazën kur kërkohet njohje sa më e shpejtë dhe aktiviteti i kësaj Ministrie në fushën e njohjes së shtetit të Kosovës, kërkoj nga Kuvendi që ta miratojë kërkesën e Qeverisë.

KRYETARI: Lus deputetët të kthehen në sallë! Po ashtu, kisha kërkuar nga Komisioni për hartimin e Rregullores të fillojë punën për hartimin e Rregullores sepse mendoj se ka ardhur koha që deputetët mëditjet t'i marrin mbi bazën e votimit, apo prezencës në votim. Vërtet, ka ardhur koha, për shkak të pandershmërisë dhe pandërgjegjshmërisë së deputetëve sepse nga shumë detyra, e kanë harruar se e kanë për detyrë si deputetë, për çka edhe marrin të ardhura shumë më të mira se në çdo vend tjetër të punës dhe kjo të sanksionohet që mëditjet e seancave të jenë mbi bazën e votimit dhe jo mbi bazën e fjalëve.

(Ndërhyrje nga deputetët)

Kjo është kryesorja, sepse ne nuk po kemi mundësi të votojmë pa prezencën e deputetëve.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Ata që nuk kanë kartelë, le të votojnë me ngritjen e dorës.

Atëherë, 54 vota i kemi me elektronikë dhe 4 me ngritje dore, që bëjnë: 58 “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime.

Prandaj, konstatoj se kalon vendimi i Qeverisë.

Për sot, me kaq po e përfundojmë. Mirë u pafshim nesër në ora 12.00!

Vazhdimi i seancës, më 3.06. 2008

KRYETARI: Lus deputetët, t'i zënë vendet e tyre!
I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Mirë se keni ardhur në vazhdim të seancës. Para se të procedojmë me pikën e rendit të ditës –Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, kërkoj një deklaram nga seanca për të lejuar drejtorin e Agjencionit Antikorrupsion, zotin Preteni, që t'i drejtohet seancës nga foltorja e Kuvendit.

Kush është për? Ju faleminderit!

A ka kundër? A ka abstenime? Me shumicën e votave i mundësohet drejtorit të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, zotit Preteni, t'i drejtohet seancës. Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit, në pajtim me nenin 18 të Ligjit kundër korrupsionit, ia ka parashtruar Kuvendit Raportin për punën njëvjeçare.

Raporti u është shpërndarë deputetëve.

Komisioni për Buxhet e Financa dhe Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri e kanë shqyrtuar Raportin dhe kanë rekomanduar që të procedohet për diskutim në seancë plenare.

Raportet e Komisionit u janë shpërndarë deputetëve.

Ju njoftoj se në sallë janë prezentë 82 deputetë.

Ftoj përfaqësuesin e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Raportin vjetor të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit.

HASAN PRETENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit,

Zoti zëvendëskryeministër,

Zotërinj anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Së pari dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë bilanc të Raportit vjetor të punës së Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, që më bën të besoj se puna që kemi bërë deri më tani do të jetë në fokusin e vëmendjes suaj.

Konkluzioni im i thjeshtë është se puna na ka bërë që në këtë analizë njëvjeçare, ne të shpresoj se kemi komoditetin të dëgjohemi me interes dhe me besimin nga ju e pikërisht për hir të kësaj pune dhe këtyre sakrificave jemi të gatshëm të përballemi për ato që kemi bërë mirë, për ato çka kemi lënë pa bërë dhe për ato që kemi të bëjmë. Gjithashtu, vlerësoj dhe mirëpres çdo kritikë, vërejtje apo sugjerim, i cili mund të shërbejë në rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit të punës sonë si institucion që kemi për mision fuqizimin e ligjit dhe rendin në Kosovë.

Agjencioni është organ i pavarur i konceptuar si mekanizëm themelor në: parandalimin, luftimin e fenomenit të korrupsionit dhe koordinimin e politikave antikorrupsion në Kosovë. Fondet për funksionimit e agjencionit sigurohen nga buxheti i Kosovës. Të punësuarit në Agjencion, u referohem vitit raportues, ishin 15 të punësuar, nga 35 sa janë paraparë me organogramin e Agjencionit.

Nga UNDP-ia kemi pasur 4 këshilltarë dhe prej tyre 2 ndërkombëtarë dhe 2 vendorë. Agjencioni ushtron përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin kundër korrupsionit 2004/34, ka filluar punën më 17 korrik 2006, me zgjedhjen e drejtorit dhe ka filluar të jetë funksional më 12 shkurt të vitit 2007.

Puna e Agjencionit mbikëqyret nga Këshilli i Agjencionit. Këshilli përbëhet nga 9 anëtarë, 3 emërohen nga Kuvendi dhe nga një përfaqësues të emëruar nga: Zyra e Presidentit, Qeveria, Gjykata Supreme, Zyra e prokurorit publik, autoritetit lokal dhe shoqëria civile.

Të nderuar të pranishëm,

Aktivitetet e Agjencionit në vitet që i lamë pas janë mbështetur në tri shtylla kryesore. Në zbatimin ose fuqizimin e ligjit, parandalimin e korrupsionit ose eliminimin e shkaqeve të korrupsionit dhe të aktiviteteve lidhur me edukimin. Fuqizimi i ligjit, aktivitetet e veçanta në trajtimin e informatave që qytetarët i sollën në Agjencion, hetimi i tyre dhe përcjella e tyre në prokuroritë publike të Kosovës.

Gjatë vitit 2007, në Agjencion janë trajtuar 124 informata. Pas hetimeve administrative, në 61 raste, ato në mungesë të provave janë mbyllur. 47 informata janë dërguar në prokuroritë gjegjëse dhe në fund të vitit 2007 16 informata kanë qenë në fazën e hetimeve.

Nga informatat e përcjella në prokurori, 14 i përkasin gjyqësorit, 13 Qeverisë, 11 pushtetit lokal dhe 9 ndërmarrjeve publike. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht Kodin Penal të Kosovës, natyra e rasteve sipas veprave penale është si në vijim:

- Shpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimet, 12 raste,
- përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, 9 raste,
- marrja e ryshfetit, 10 raste,
- ushtrimi i ndikimit, 4 raste,
- nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, 7 raste,
- arkëtimi dhe pagesa e paligjshme, 2 raste
- falsifikimi i dokumentacionit zyrtar, 3 raste

Nga faktet e sjella, nga rastet e dyshuara për veprime korruptive, të cilat janë përcjell për procedim penal të mëtutjeshëm në prokuroritë përkatëse, pasojat ekonomike që mund ta dëmtojnë shoqërinë kosovare kapin shifrën rreth 30 milion euro.

Nga informatat e përcjella në prokurori, në mënyrë zyrtare jemi informuar për fatin e vetëm 6 prej tyre. Në mesin e tyre 5 informata janë që i përkasin gjyqësorit, dhe 1 rast që është nga pushteti lokal.

Parandalimi

Eliminimi i shkaqeve të korrupsionit, mbikëqyrja e pasurisë edhe pse ky aktivitet është realizuar për herë të parë në Kosovë, 98% e zyrtarëve e kanë kryer këtë obligim. Ky

obligim ligjor është realizuar në tri faza dhe deri te realizimi i plotë është dashur që ndaj 24 zyrtarëve të kërkohen ndërmarrja e masës administrative zvogëlimi i pagës për 20%, kurse ndaj 14 zyrtarëve, nga punëdhënësit e tyre është kërkuar largimi definitiv nga puna.

Pas kontrollit tekniko-logjik ne kemi hasur në shumë parregullsi tek plotësimi i formularëve dhe të gjitha këto është dashur angazhim shtesë dhe kontakt direkt me zyrtarët që mangësitë të evitohen.

Parandalimi i konfliktit të interesit

Në bazë të informata të bazuara për ekzistimin e konfliktit të interesit, Agjencioni ka ndërhyrë tek 15 raste dhe është arritur evitimi i tyre. Në disa raste ku janë vërejtur shkeljet e Ligjit të prokurimit publik, nga ana e institucioneve të Kosovës, Agjencioni ka ndërmarrë veprime ku janë rekomanduar anulimet e disa tenderëve dhe iniciativa tjera të institucioneve para hapjes së ofertave, duke eliminuar diskriminimin e operatorëve të përgjegjshëm ekonomik, vlera e paralogaritur e tenderëve të anuluar arrin shifrën rreth 7 milionë.

Edukimi

Agjencioni si institucion i ri i formuar nga Kuvendi, aspektin e edukimit e ka trajtuar në dy drejtime. Edukimin në ngritjen profesionale të vetë zyrtarëve të agjencionit dhe edukimi i përgjithshëm i publikut me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare.

Zyrtarët e agjencionit gjatë vitit raportues kanë marrë pjesë në gjithsej 35 trajnime , konferenca, tryeza pune dhe vizita studimore.

Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer me Qendrën për Arsim të Kosovës kemi marrë pjesë aktive në seminarët e organizuara në 10 komunat e Kosovës dhe së bashku me OSBE-në dhe UNDPI-në kemi realizuar 2 kampanja mediale, kemi vizituar të gjitha ministrinë e Qeverisë së Kosovës dhe 3 komunat më të mëdha të vendit ku zyrtarët i kemi njoftuar për legjislacionin në fuqi me mekanizmat antikorrupsion. Raporte shumë të mira kemi pas edhe me mediat duke mos refuzuar asnjë kërkesë për bashkëpunim.

Për të gjitha aktivitetet e agjencionit janë shpenzuar 336 mijë e 956 euro ose 88.11% nga buxheti i lejuar. Duke menaxhuar mirë buxhetin dhe duke shpenzuar për: telefonata, dreka, darka dhe derivate shpenzime minimale, vetëm 5% e buxhetit është shpenzuar në procedura me vlerë minimale.

Cilat ishin pengesat në punën e Agjencionit për vitin raportues?

Buxheti jo sipas kërkesës, numri i zyrtarëve jo sipas organo-gramit, pagat e vogla dhe aspak motivuese, pamundësia e angazhimit të ekspertëve të fushës përkatëse dhe rrezikshmëria e largimit të personelit ekzistues, bashkëpunimi me prokurinë jo në nivelin e duhur. Objekti ku është vendosur Agjencioni është i vogël dhe jofunksional.

Të nderuar të pranishëm,

Agjencioni është në funksion më shumë se një vit dhe ky është raporti i parë që po prezantohet para jush. Jam shumë i bindur se rezultatet e arritura janë larg asaj çka ne dëshirojmë, mirëpo mendoj se në Kosovë është formuar një institucion i cili veç ka krijuar një themel të fortë, një institucion tek i cili qytetarët e Kosovës po e rrisin besimin dhe me vazhdimin e përkrahjes së institucioneve qendrore, në një të ardhme të afërt do të arrihen rezultate të dëshirueshme.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që me 2 fjalë të referohem edhe gjendjes aktuale.

Agjencioni për herë të parë e ka buxhetin sipas kërkesës. Numri i zyrtarëve definitivisht do të jetë sipas organogramit. Kuvendi po ndërmerr hapa konkret drejt fuqizimit të Agjencionit dhe në raport me prokuroritë ka progres. E gjithë kjo po rezulton me rritjen e intensitetit dhe kualitetit të punës së Agjencionit.

Deri me tani për vitin 2008, i kemi pranuar 59 informata serioze për veprime korruptive. Me qëllim të parandalimit të tyre, më lejoni që t'i veçoj dy nga shumë format e lajmërimit të korrupsionit. Nën një, edhe më tutje po vazhdon me abuzime të mëdha në procesin e tenderimit, duke mos i publikuar tenderët në faqet e internetit, duke i diskriminuar operatorët e përgjegjshëm dhe duke mos i respektuar kushtet të cilat vetë i përcaktojnë. Vetëm në dy javët e fundit, në tri raste, pas reagimit të Agjencionit, në tenderët e publikuar, parandalohet tentim -keqpërdorimi i më shumë se 2.5 milionë euro. E dyta, është e re, por me shenja metastazike, te procedurat e përzgjedhjes së konsulencës ndërkombëtare, gatishmërisë së institucioneve ndërkombëtare për të ndihmuar ngritjen e institucioneve vendore, zyrtarët tanë i përgjigjen duke i futur në polica të afërmit e tyre ose nga ekspertët ndërkombëtarë për dhënien e pëlqimit për vazhdimin e kontratave, kërkojnë vetura, punësim dhe favore tjera.

Deputetë të nderuar,

Me qëllim të mbrojtjes së: rendit ligjor, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, ndershmërisë dhe drejtësisë sociale, konkurrencës, rritjes ekonomike, besimit të përgjithshëm tek institucionet publike dhe vlerat morale të shoqërisë, lufta kundër korrupsionit dhe kycja në këtë proces e të gjitha institucioneve, është e domosdoshme.

Ju falënderoj për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Preteni!

Sipas radhës, kryetarët e komisioneve, por nuk janë lajmëruar. Jo, tek unë nuk janë lajmëruar. Do të thotë fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, Kryetar!

Përsëndetje Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Fillimisht duhet të falënderoj drejtorin e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, zotin Preteni për këtë raport të shkurtër, të saktë dhe shumë real për punën e punën njëvjeçare të Agjencionit.

Ne si Komision e kemi shqyrtuar këtë raport të Komisionit dhe e kemi vlerësuar lart mënyrën e raportimit dhe vërtetë transparencën që do të duhej të ishte shembull për të gjitha institucionet qeveritare të Kosovës dhe për të gjithë mekanizmat tjerë dhe agjencionet e pavarura se si duhet vepruar dhe në fund si duhet raportuar para organit që edhe i ka zgjedhur si mekanizëm.

Shqetësimet e Komisionit kanë qenë të orientuara dhe pikërisht në atë që mekanizmat që janë të thirrur, vërtet, të jenë hallkë në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit si fenomen shumë i keq për shoqërinë, nuk e luajnë atë rol dhe atë mision për të cilin janë të thirrur.

Duke u nisur nga ky raport dhe rastet e paraqitura, na del se Qeveria dhe gjykatat, me theks të veçantë po i them gjykatat, prijnë për rastet e paraqitura, që janë të përfshira në korrupsion dhe natyrisht në luftën kundër korrupsionit, misionin që duhet ta kryejnë këto gjykata ose këto institucione nuk e kryejnë dhe këtu është shqetësimi shumë i madh dhe është, ndoshta, edhe pamundësia e vet Agjencionit që vërtet rastet aty ku duhet t'i paraqesë, ato hidhen poshtë, nuk përfillen, lihen anash dhe vazhdon ajo që quhet dhe që është e keqe dhe Kosova ta mbajë vendin e parë, ndoshta, në atë listën e shoqërive më të korruptuara.

Dua ta përmendi vetëm një fakt, nga 35 raste të paraqitura për gjykata, 14 janë në prokurori dhe vetëm dy janë në procedurë. Kjo tregon efikasitetin e këtij mekanizmi dhe në këtë drejtim unë thërras edhe Qeverinë edhe Ministrinë e Drejtësisë, që vërtet sa më parë të fillojë një reformë në sistemin gjyqësor, në qoftë se dëshirojmë ta kemi një shoqëri të pastër dhe në qoftë se dëshirojmë të realizojmë atë moton e Qeverisë zero tolerancë ndaj korrupsionit.

Çështja tjetër që dua të them, pikërisht për gjykatat është edhe kjo te rasti i deklarimit të pasurisë sipas ligjit, pikërisht janë gjyqtarët që sot punojnë ende në gjykata dhe të cilët nuk e kanë përfillur ligjin, dhe, ndoshta, janë institucionet dhe njerëzit që së pari me shembullin e tyre, do të duhej të respektonin ligjin, dhe ata sot ende edhe kësaj dite vazhdojnë punën nëpër gjykata dhe Këshilli prokurorial dhe gjyqësor që është tash nuk merret me këtë çështje, nuk e shqyrton këtë çështje. Prandaj, kërkohet edhe nga ky Kuvend, që vërtet në këtë drejtim të bëjë presion që të jenë më efikase, sepse deklaramet deri në Agjencionin Antikorrupsion, deri tash sa kanë qenë edhe ai bashkëpunim me qytetarët që ka qenë, me mos efikasitetin e gjykatave, ne nuk do të mund ta realizojmë misionin e kësaj lufte kundër korrupsionit. Ne e dimë se nuk mund ta ndalim deri në fund, por thuhet një maksimum atje : ” nga rreziku i vogël dhe fitimi i madh, ta biem gjendjen në këtë fushë me rrezik të madh e fitimi shumë i vogël” dhe kush e dëshiron këtë le t'i hyjë. Prandaj, në këtë drejtim unë konsideroj se këtij agjencioni duhet t'i jepet një mbështetje shumë e fuqishme, një përkrahje edhe financiare, sepse nuk e ka pasur deri me tani, dhe natyrisht pa këtë përkrahje, ndoshta, vetë ky si

mekanizëm do të mund të binte në kthetrat e këtij fenomeni të korrupsionit, gjë që ne nuk e dëshirojmë.

Vetë ndërhyrja e këtij agjencioni në vitin e kaluar për anulimin e 13 tenderëve në vlerën diku prej 7 milion eurove tregon dhe mund të lidhet edhe me Raportin e djeshëm që e patëm të shpenzimeve buxhetore se vërtet a është faji te ligji apo është faji te njerëzit që e zbatojnë ligjin rreth këtyre çështjeve. Dhe në fund, ne si Komision kërkojmë nga ky Kuvend që të përkrahet ky raport, dhe jo vetëm të përkrahet, por të fuqizohet puna dhe veprimi i këtij agjencioni.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: I nderuari, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Korrupsioni në shoqërinë tonë flitet se është dukuri shumë e pranishme. Kjo dukuri, madje është cilësuar si gangrenë në jetën tonë institucionale dhe ekonomike. Për t'u ballafaquar me këtë dukuri tejet të dëmshme për vendin tonë është krijuar baza ligjore përmes Ligjit kundër korrupsionit i miratuar në vitin 2004 dhe mbi bazën e tij, dy vjet më vonë do të themelohet Agjencioni Antikorrupsion.

Agjencioni, sipas raportit do të fillojë funksionimin e tij nga shkurti i vitit 2007. Ky agjencion tash para Parlamentit të Republikës së Kosovës ka paraqitur Raportin e parë vjetor për punën e tij.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin dhe ka ardhur në përfundim se aktivitetet e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit janë në fazën fillestare. Ne i vlerësojmë angazhimet dhe përpjekjet e këtij agjencioni në drejtim të konsolidimit dhe përgatitjeve për të operuar, por konsiderojmë se për një kohë të gjatë nuk e ka pasur mbështetjen e nevojshme institucionale.

Nga mënyra se si është trajtuar mund të vijmë në përfundim se Qeveria e kaluar e ka mbështetur këtë agjencion vetëm sa për hir të rregullit se duhet të themelohet një agjencion i tillë për t'u plotësuar një normë ligjore dhe nuk e ka mbështetur në krijimin e hapësirës dhe kushteve të mjaftueshme për punë. Mbetja në këtë gjendje e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, nuk është vetëm për faktin se është ndër agjensionet e fundit të krijuara në vendin tonë.

Për me shumë se një vit, Agjencioni nuk e ka plotësuar – kompletuar stafin në tre departamentet e tij të parapara sipas skemës organizative, kurse një vështirësi të madhe për të rritur efikasitetin del se ka qenë edhe alkimi me vonesë i mjeteve buxhetore, por edhe mos afrimi i sigurisë së mjaftueshme për punëtorët e Agjencionit.

Neglizhenca e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit nga ana e Qeverisë së kaluar, ka bërë që edhe rastet e hetuara dhe të paraqitura në organet gjyqësore të mos trajtohen me seriozitetin e duhur nga këto të fundit.

Nga rastet e paraqitura këtij Agjencioni gjatë vitit 2007 dhe nga puna e paraqitur në raport, vërehet se ka pasur fenomene korruptive në të gjitha institucionet të niveli qendror e lokal, në sistemin gjyqësor dhe në ndërmarrje publike. Prandaj, duke pasur parasysh edhe moton e Qeverisë: “zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar”, konsiderojmë se Agjencioni Kundër Korrupsionit duhet të mbështetet e veçanërisht t’ forcojë departamentet për parandalimin dhe hetimin e korrupsionit, bashkëpunimin me qytetarët, me sistemin gjyqësor si dhe lansimin e fushatave mediale kundër korrupsionit për çka e inkurajojmë që të përfshijë në strategjinë e luftës kundër korrupsionit.

Trajtimi me seriozitet i rasateve të paraqitura nga organet e sistemit të gjyqësisë është i domosdoshëm. Me këto kapacitete që ka aktualisht Agjencioni Kundër Korrupsionit, nuk do të mund t’i kryejë obligimet dhe detyrat që ia përcakton Ligji kundër korrupsionit, prandaj, duhet të krijohen kushte, stimulim dhe siguri e mjaftueshme për punëtorët e këtij agjencioni, në mënyrë që të jenë të suksesshëm në punën e tyre.

Të nderuar deputetë,

Grupi Partisë Demokratike të Kosovës, në parim e mbështet miratimin e raportit të Agjencionit Kundër Korrupsionit dhe kërkon që këtij agjencioni t’i krijohet hapësirë dhe mundësi të mjaftueshme për operim.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Të nderuar deputetë,

Falënderoj drejtorin e Agjencionit në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, që ka sjell raportin para organit që kërkon nga ai që ta zbatojë ligjin, në

një lëmi aq shumë të përfolur, një dukuri që Kosova e ka trashëguar, në një formë apo në formën tjetër dhe në formë të shkruar Raporti pasqyron angazhimet dhe të arriturat e këtij agjencioni, si dhe pasqyron sfidat që Agjencioni ka para veti.

Nëse e keni parë me kujdes aneksin e fundit të raportit, ky agjencion kërkon edhe më tutje mbështetje më të madhe. Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet edhe punën e deritashme edhe kërkon nga institucionet që të vazhdojë mbështetjen, në mënyrë që ky mekanizëm shtetëror të funksionalizohet dhe të jetë në shërbim, në interes të zhvillimit pozitiv të shtetit, duke luftuar dukurinë për të cilën është ngarkuar me ligj.

Nuk është i vetmi mekanizëm që e lufton korrupsionin, nuk janë të vetmet shifra që kanë ardhur këtu si probleme në të kaluarën. Ka edhe mekanizma tjerë që janë përgjegjës në funksion të zbatimit të ligjit, në funksion të hetimeve, në funksion të parandalimeve dhe në funksion të marrjes së masave ligjore për të gjithë ata që abuzojnë, keqpërdorin, shkelin dhe përfitojnë nga pozita apo nga niveli që ata kanë parasysh. Këtu e kam fjalën se Agjencioni është njëri nga mekanizmat tonë për të cilën jep llogari të përditshme, por edhe zyrat tjera, institucionet dhe organet që çdo ditë merren, kanë shifrat e tyre, kanë të arriturat e tyre dhe besa disa prej tyre edhe janë edhe nëpër burgje, në vendet ku ligji i detyron t' i dërgojë.

Unë nuk do të merrem me të kaluarën, meqë i përmendi kolegu im Avdiu, dëshiroj ta konfirmoj Qeveria e kaluar ka themeluar Agjencionin, ka miratuar legjislacionin dhe ka planifikuar sipas kërkesës së drejtorit dhe rolit që ka pasur Bordi i emëruar nga Parlamenti, duhet të vendosë mekanizma, rrugë më të mira të mundshme që ky agjencion të funksionalizohet edhe më shumë. Është arritur deri në një masë që të krijohen kushtet, por edhe më tutje Agjencioni kërkon hapësirë, mundësi dhe mbështetje më të madhe. Ky agjencion do të zhvillohet përderisa dukuria për të cilën po flasim është evidente dhe trendët janë negative. Për t' i parandaluar kërkesat e këtij agjencionit, duhet të vazhdohet të mbështeten, në mënyrë që të krijohet mundësi zero e atyre që pretendojnë me këta mekanizma joligjor të krijojnë rrethana.

Nuk do të doja ta quaj neglizhencë kushdo që kualifikon diçka, unë për herë të fundit, në cilësinë time si deputet kisha kërkuar që të jemi në funksion të mbështetjes të plotë të këtij agjencionit, të këtyre politikave, të krijojmë edhe infrastrukturë tjetër ligjore, sepse problemi i korrupsionit nuk është që dy vjet, nuk është që tri vjet, nuk është që 5 vjet, është që 9 vjet dhe është trashëguar edhe nga një e kaluar më e largët si dukuri, është importuar edhe nga format tjera dhe si i tillë, gjeneratat e ardhshme nuk e meritojnë të merren me këtë problem. Ne e kemi për nderë dhe për mandat që ta luftojmë deri në fund si mundësi, si institucion më i lartë i vendit edhe një herë po e përsëris Grupi Parlamentar i LDK-së, çdolloj kërkesë, sfide që ky agjencion ka paraqitur, kërkojmë që të mbështetet nga Qeveria. Pra, kërkojmë që Bordi, si organ mbikëqyrës të funksionalizohet sa më shpejtë, dhe ata të vazhdojnë të hetojnë rastet, ata kanë funksion të hetimit administrativ. Por, nëse Prokuroria përmendet si mekanizëm i cili duhet të involvohet, por kur Agjencioni përgatit një dosje për dike, aty mund të dalin edhe probleme tjera.

Në rastet që janë marrë nga Prokuroria për rastet e hetimeve të caktuara, mund ta shihni se atje ka rezultate dhe unë besoj se Agjencioni, nëse ka probleme në koordinim ndër-institucional, duhet të kërkojë nga autoritet qendrore që të krijojnë rrethana të bashkëpunimit, koordinimit dhe të krijimit të kushteve të përbashkëta që të punohet në këtë fushë aq të ndjeshme në Kosovë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i grupit Ibrahim Makolli e ka fjalën.

Regjia le t'i jepet fjala deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Të respektuara deputete e deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Shumëkush korrupsionin e merr si ryshfet, por ryshfeti është diçka krejt tjetër, është vetëm një segment i hollë – brajveri, ndërsa korrupsioni ka miliona forma. Unë i marr si shembull dy molla, nëse njëra është pak e shtypur është mollë e korruptuar. Nuk është korrupsioni për fatin e mirë, si të thuash veti e kosovarëve, sepse ne jemi popull i traditës edhe i moralitetit edhe populli e gjykon çfarëdo forme të korrupsionit, por. Megjithatë, mjerisht ka edhe është infiltruar- penetruar në forma të ndryshme në të gjitha porët e jetës shoqërore. Se është dokument, pra, fenomen shoqëror, tregon edhe fakti se janë me dhjetëra dokumente, marrëveshje, konventa ndërkombëtare kundër korrupsionit e tjera.

Po ta kishim gjyqësorin dhe po ta kishim administrativin efikas dhe eficient, pa fije të dyshimit se nuk do të kishim nevojë që ta kemi, po e zëmë, Agjencionin Kosovar Kundër Korrupsionit.

Unë di raste edhe me numra edhe di po e zëmë se te kush janë lëndët, rastet këto quhen lëndë, që me vite nuk zgjidhen, di raste tjera që në mënyrë ekspres zgjidhet lënda, protokollohet, evidencohet, jepet fund, kryhet, jepet vula e plotfuqishmërisë, vërtet, ankesa- refuzohet ankesa brenda jave, vula edhe ekzekutohet, këto janë forma shumë drastike korruptive. Numri i madh i lëndëve zvarritet ka shkaqe objektive, por ka edhe subjektive.

Do të ishte mirë që edhe rastet e tilla të përfshihen në fokusin e kontrollimit. Ka shumë vendime, ka shumë aktgjykime të influencuara nga dhuna, nga mashtrimi, po e lëmë mashtrimin, nga kanosja që janë forma korruptive drastike, por edhe nga mitoja.

Pikat më neuralgjike të korrupsionit konsideroj se janë: tenderët, konkurset, abuzimet dhe investimet. Ndër tjera, forma e përmendi një formë korruptive që e ka një mbështetje në ligj, që bie fjala nëpunësit civilë mund të bëjnë kontratë me punëdhënësin deri 3 vjet edhe nëpunësi edhe kur janë punët e përhershme, që do të thotë nuk ka vend për kontratë deri në 3 vjet, që gjithmonë me veshë në krah edhe me kohë bëhet i subordinuar edhe i nënshtrohet vullnetit të punëdhënësit. Ka shumë abuzime në këtë çështje, do të thotë që edhe kanë mbështetje në ligj, e lëri më ato që nuk kanë.

Ju lutem, uzurpimet arbitrare të tokave publike, ta marrim në Gërminë. Ju lutem ajo është e patolerueshme, mushkëritë e Prishtinës janë zënë me objekte, ato objekte, po të kishin pasur një ekzekutiv të mirë edhe një gjyqësor, që mjerisht nuk e kemi, nuk do të ishin ndërtuar absolutisht, se dy- tri rrëtime po të kishin ndodhur, sipas ligjit edhe shpeshherë thonë se nuk kem ligj, kemi ligj, sepse është ligji i cili nuk aplikohet dhe është ligj fare i mirë, nuk është diskriminues është në fuqi, pastaj janë miratuar edhe dokumente tjera.

Nga vetë numri i raportit që u dha këtu, shihet se është një numër i vogël, në krahasim me gjendjen. Pastaj ai numër reduktuar në minimum që janë proceduar rastet atje. Prokuroria një herë gjysmë përgjysmë e pastaj e kështu. Domethënë ekziston një rezistencë e fuqishme anti korrupsion. Unë e kam ngritur një pyetje kuvendore, referuar Universitetit të Prishtinës edhe konkursit, i cili fare nuk është përfillur, janë pranuar me mijëra studentë jashtë konkursit. Një student jashtë konkursit po qe se do të pranohej, do të ishte abuzim ilegal që do të duhej hapur procedurë dhe fare nuk kam marr përgjigje nga ministri, bie fjala. Në ndërkohë, ministri më ka thënë se ashtu është, po unë e di se është ashtu është, por ju lutem ekzekutivi le të ndërmerr masa. Kjo është formë korruptive, vargore se nuk mund të tolerohet. Një shoqëri e korruptuar është e infektuar edhe e gjykuar për bastardim, ndërsa një shoqëri politike që nuk është e korruptuar e ka perspektivën përpara.

Unë konsideroj se do duhej ta bënim ne regjistrimin e pasurisë edhe do duhej ta bënim edhe, sipas ligjit, hulumtimin e prejardhjes së pasurisë. Në masë të madhe do ta kishim luftuar korrupsionin dhe përfundimisht e mbështes raportin edhe zotin Preteni për punën, se me siguri ai këtu nga modestia nuk i ka thënë se me siguri ka pasur pengesa serioze edhe ky agjencion duhet të sforcohet dhe presin punë më të madhe, më serioze, më efikase.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, për kryetarin e Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Para së gjithash edhe unë në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dëshiroj ta falënderoj Agjencionin Kosovar Kundër Korrupsionit dhe zotin Preteni sot për raportin për raportin të cilin e ka sjellë. Mendoj se kemi arritur një fazë e cila është më e avancuar se në vitin e kaluar, vitin e kaluar në këtë kohe, realisht nuk kemi pasur agjencion, sot e kemi e po shohim se rezultatet e para dhe frytet veç kanë filluar që të shihen.

Komentin tim në vazhdim, ju kisha lutur që ta kuptoni si insistim tonin që korrupsioni duhet të luftohet më tepër në mënyrën strukturale se sa në ndjekjen e njerëzve dhe të individëve veç e veç. Dëshiroj që edhe njerëzit e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit në këtë mënyrë ta kuptojnë e jo si ndonjë insistim që të kërkohet diçka që është e paarrtshme. Vetëm thashë, se ne po insistojmë që korrupsioni të luftohet në mënyrën strukturore paralelisht me punën e cila bëhet në ndjekjen, po them ashtu me këto fjalë që, ndoshta, nuk janë adekuate në ndjekjen e njerëzve.

Kam kërkuar një ditë këtu para Kuvendit, që edhe ligjet të cilat hartohen të kalojnë nëpër Agjencionin Anti Korrupsion, e qëllimi ka qenë ky, me një shembull shumë të thjeshtë. Nëse ka më tepër potencial të lindjes së korrupsionit, nëse një tender e

nënshkruan vetëm një njeri, se nëse e nënshkruajnë 5 njerëz, atëherë Agjencioni Antikorrupsion duhet t'i rekomandojë hartuesit të ligjit edhe Kuvendit të Kosovës, që ta ndryshojë pak atë ligj, në mënyrë që më shumë njerëz të jenë të involvuar në një proces, se, ndoshta, mundësia për korruptim është më e vogël në atë rast. Përmes këtij rasti po tentoj ta ilustroj atë që duhet të studiohet forma strukturore. Do të vazhdoj më tutje në këtë drejtim.

Nëse nuk luftohet forma strukturore, mirëpo korrupsioni luftohet në mënyrë politike, do të thotë ky grumbulli i njerëzve janë të korruptuar ose ky grumbull i njerëzve janë të mirë. Çka do të ndodhë? Do të ndodhë ajo që ekzakt e kemi dëgjuar sot, në tre muajt e parë vetëm ka problem me tenderë tash, edhe tash ka probleme me tenderë në tre muajt e parë. Paramendoni tenderët tash fillojnë të hapen. Deri në fund do të ketë prapë probleme. A e dini pse ka probleme? Se njerëzit janë njerëz, nuk janë as të mirë, nuk janë as të këqij, mirëpo nëse ju lihet mundësia, atëherë duhet të pritet që të gjendet një ose dy, ose tre, ose katër të këqij dhe e bëjnë atë punë. Kjo është arsyeja pse duhet të luftojmë strukturalist, është një ligj që në anglisht, nuk do ta them, do ta them shqip ku thuhet: "që nëse punëve u lejohej të shkojnë mbrapshtë, ato bashkë mbrapshtë shkojnë", nuk e zgjedhin vet rrugën tjetër, do të thotë, këto që po i shohim edhe çka ndodh tash nëse eventualisht njerëzit e Kosovës e shohin që nuk paska zgjidhje? Çka do që po ndodhë në Kosovë, është korrupsion. Do të ndodhë një dezulizionim total i njerëzve, njerëzit do të fillojnë të mendojnë se nuk ka shpresë në Kosovë që të luftohet korrupsioni, dhe kur njerëzit e humbin shpresën se korrupsioni nuk mund të luftohet, atëherë ta kemi të sigurt se Kosova për një të ardhme shumë të gjatë e ka humbur luftën kundër këtij fenomeni që u tha edhe më parë, për të mos i përsëritur, realisht po e degradon shoqërinë prej niveleve më të ulëta të qeverisjes, në të gjitha nivelet.

Ne kemi pritur, besoj se keni pritë edhe ju edhe kanë pritur të gjithë njerëzit që, kur në pushtet vjen një Qeveri e cila e fillon edhe e përfundon kampanjën me theksin të lufta kundër korrupsionit, që do të kemi para vetes një sistem, do të thotë, do të kemi para vetit një sistem, do të thotë do të kemi para vetes një koncept sistemor të luftimit të korrupsionit. Nuk e kemi realisht edhe ne kërkojmë që të ndërtohet për shkak se nuk është larg, nuk është vështirë. Ne kërkojmë që Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit të fuqizohet jo vetëm me plotësim të stafit për t' i mbledhur deklaratat e pasurisë ose që t' i shohë tenderët, por me plotësim të stafit dhe me ekspertizë që ta kontrollojë sistemin, që ta shoh sistemin aq sa mundet dhe t' i sugjerojë sistemit ndryshimet. Pra, duhet t' i sugjerojë Kuvendit ndryshimet nëse është e nevojshme në ligje, t' i sugjerojë Kuvendit ndryshime edhe në sistemet tjera me të cilat ne punojmë, për shkak se ajo është rruga e vetme për të mos ardhur në një pozitë, prapë të themi ose të gjithë njerëzit janë të këqij ose për ta luftuar njëri-tjetrin politikisht edhe të dilet të thuhet këtu ajo Qeveri ka qenë e keqe, kjo qeveri është e mirë. Kjo nuk është mënyra, për shkak se po i bëjmë dëm vendit. Kemi për ta humbur luftën të gjithë, se edhe kjo qeveri njëjtë ka për të përfunduar edhe kur të përfundojnë të gjitha qeveritë njëjtë çka ndodhë? Ka për të përfunduar një qeveri e ardhshme t' i thotë kësaj qeverie - ju keni qenë të korruptuar e ne jemi të mirë.

Ky është insistim i Aleancës. Luftimi i korrupsionit në mënyrë strukturore, luftimi i korrupsioneve përmes kontrollimit të ligjeve dhe normave dhe vendimeve të cilat merren, në mënyrë që të kemi shumë më pak të bëjmë me individë e shumë më tepër të kemi të bëjmë me sofistikim të sistemit. Dhe në fund të fundit kisha dëshiruar që debati për Agjensionin Kosovar Kundër Korrupsionit dhe raportin e tij, në fakt, të mos shndërrohet në debat për sistemin e gjyqësisë në Kosovë. Këto dy çështje janë shumë të ndërlikdhura, por në fund të fundit janë të ndryshme. Ne e dimë punën e Prokurorisë, e dimë punën e gjykatave, por sot po flasim për Agjencionin, për Raportin e Agjencionit edhe përfundimisht për të mos u lodhur juve, po insistoju që të punohet më tepër nga të gjithë ne që të fillohet të luftohet korrupsioni në mënyrë strukturore e jo duke i akuzuar njerëzit veç e veç.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra dhe zëvendëskryeministra që jeni prezentë,

Sot po debatojmë apo po flasim rreth në raportin të një agjencioni kundër korrupsionit, i cili është themeluar nga ky Kuvend diku para një viti. Kur zihet fjala në gojë korrupsion, vërtet në kuadër të kësaj fjale nënkuptohet shumë apo çdo qytetar që dëgjon, hap sot sytë dhe veshtë se çfarë po thuhet kundër korrupsionit, sepse vërtet korrupsioni në shoqërinë tonë tashmë është një plagë shumë e rëndë. Në qoftë se mendohet se korrupsioni mund të luftohet vetëm me Agjencionin Kosovar Kundër Korrupsionit, atëherë vërtet kjo mund të jetë vetëm një retorikë. Para se të flas rreth raportit, me këtë dua të them se vërtet ne si Kuvend, si deputetë veç e veç dhe si institucione, duke përfshirë edhe Qeverinë, duhet vërtet të koordinohemi, të punojmë dhe ta kemi shumë seriozisht, që në radhë të parë ky agjencion të jetë i pavarur, e pastaj të përkrahet edhe në forma tjera që vërtet të fillohet të bëhet diç apo të luftohet vërtet korrupsioni.

Nëse fillojmë të flasim për këtë raport, duke pasur parasysh kushtet në të cilat ka vepruar ky agjencion, ne mund të themi se vërtet rreth një vit është bërë një punë që mund të përshëndetet.

Në raportin, të cilin e kemi marrë dhe si Grup Parlamentar, por edhe në komisionet përkatëse që i kemi shqyrtuar, shihet se janë paraqitur 124 raste të cilat janë hetuar në aspektin administrativ. Janë grumbulluar materialet, pra, janë materializuar ato dhe më pas janë përcjellë në prokurori. Prej këtyre 61 janë mbyllur në mungesë të materialit dëshmues. 47 raste janë dërguar në prokurori, ndërsa 16 sosh – thuhet në raport janë duke u hetuar. Më së shumti raste, të nderuar kolegë, janë dërguar në Prokurorinë Publike të Prishtinës, sepse duhet ta kemi parasysh se shumica prej këtyre rasteve janë në institucionet qendrore, pra në kryeqytet.

Nga këtu shohim se mungon, vërtet, një bashkëpunim jo i mirë me Prokurorinë Publike dhe kjo thotë shumë, nuk mendoj se duhet koment. Mbyllja e shpejtë e rasteve nga Prokuroria e që në aspektin tjetër ne kemi vërejtje, ankesa nga çdo institucion se në prokurori dhe në gjykata lëndët janë të grumbulluara, ndërsa në këtë aspekt kur kërkohet nga Agjencioni, konkretisht që po flasim sot për të, në këto prokurori bëhet, pra, mbyllja shumë e shpejtë e rasteve, dhe kthimi i përgjigjeve brenda 10 ditëve. Nga të gjitha rastet e dërguara atje, domethënë nga ky agjencion, vetëm 6 prej tyre Agjencioni thotë janë informuara dhe tjerat janë hedhur poshtë.

Karakteristikë e tyre është se pesë prej tyre i përkasin gjykatave, domethënë, tash e shohim se nga ky agjencion kryekëput më së shumti ka të dhëna për korrupsionin brenda gjykatave, që është vërtet shqetësues.

Ky agjencion parasheh vështirësitë në menaxhimin e buxhetit për shkak të mungesës së zyrtarëve për zotim dhe prokurim dhe certifikim. Domethënë, në këtë drejtim duhet të kemi parasysh mbështetjen dhe përkrahjen për ekspertë në këtë fushë dhe për përkrahjen e faktorit apo resurseve njerëzore.

Natyrisht se Agjencioni paraqet ankesën për paga të ulëta që ka ndikuar pra, në demotivimin e punonjësve, dhe natyrisht ikjen e ekspertëve. Problem tjetër është mos rregullimi i statusit të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencionit, që mendo se shpejt duhet të rregullohet kjo çështje dhe objekti jo i siguruar sa duhet, e që natyrisht paraqet rrezik për punën e zyrtarëve të Agjencionit, e që në kuadër të objekteve për mos të hyrë, të flasim se kemi shumë agjencione, shumë institucione të Kosovës, që vërtet nuk janë në objektet përkatëse dhe gati secili agjencion e ka peshën e vet, natyrisht, që duhet të mendohet në këtë drejtim.

Nga parallogaritë që janë bërë nga 47 raste të dërguara në prokurori, të nderuar kolegë, kanë peshën, si thotë agjencioni 30 milionë euro, domethënë këta kanë përlllogaritur që diku 30 milionë euro janë në pyetje të korrupsionit nga këto 47 raste që këta i kanë mbledhur të dhëna.

Sa i përket deklarimit të pasurisë, në Raport janë pasqyruar 732 raste që kanë qenë të obliguara ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe prej tyre 713 e kanë deklaruar. Nga statistikat që janë pasqyruar në raport, 14 zyrtarë që nuk e kanë deklaruar pasurinë, 8 prej tyre janë nga Kuvendi, ndërsa 6 të tjerë nga gjyqësori edhe këtu fatkeqësisht janë dy institucione më relevante të këtij shteti - Kuvendi i Kosovës dhe sistemi i gjykatave.

Nga jo vijmë në përfundim, të nderuar kolegë, se ky agjencion është në rrugë të mirë, i cili duhet të përkrahet edhe përkrahja më e madhe, përveç obligimeve ligjore, është që institucionet e Kosovës të mos interferojnë në punën e këtij agjencioni. Ky agjencion, në kuptimin e plotë të fjalës duhet të jetë i pavarur.

Në bazë të këtij raporti, Qeveria duhet të bëjë shumë reforma, në veçanti reformat në drejtësi dhe gjykata.

Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështet këtë raport dhe shpreh gatishmërinë që ky agjencion të mbështetet edhe financiarisht. Kur jemi këtu, Lidhja Demokratike e Dardanisë mendon se shumë shpejt duhet të merret një vendim, qoftë lloj rregulloreje apo ligj i veçantë që të gjitha agjencionet, të cilat janë trup i këtij Kuvendi, duhet të bëhet të jenë, vërtet, të pavarura dhe të kenë mbështetje të harmonizuar financiare dhe buxhetore.

Pra, në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë përkrahim këtë raport dhe ju falënderojmë për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsjedniče,
Gospodo ministri, kolege, gosti,

Kažu da je gradjanin iz Đakovice putovao u Skoplje, i zašto pitaju ga, on kaže eda pitam šta ima novo u Đakovici. Mi smo ovih dana putovali u Brisel, i mogli bismo u Briselu da saznamo ponešto šta to ima novo na Kosovu, pogotovu kada je u pitanju korupcija. Od osvedočenih prijatelja Kosova, kao što je Jelko Kacin, ervopski parlamentarac iz Slovenije ili gospođa Doris Pak, čuli smo iz njihovih usta više puta tenderi, specijalizacije, konkursi u Carini, u Pošti, KEK-u i tako dalje. To smo čuli u Briselu. Ja sam čuo. Znači nismo imuni od zla koje je kancer svakog društva koja je veoma prisutna čak i u razvijenim zemljama. Znamo koliko vlada pada u Italiji, kada se otkriju lanci korupcije, da ne govorimo o okruženju Kosova koje spada u sami evropski vrh korupcije. Kosovo, kao jedno od zemalja u tranziciji, suočeno je sa korupcijom, i na žalost, ili na sreću, prave se neke ankete, i u njima se kao što je i koleginica pre mene rekla, najčešće se pominje kao rekorder upravo pravosudje, dakle oblast koja treba da deli pravdu, izgleda je tu najjači argumenat novac i on može da bude posrednik, da neko ko je kriv postane prav, dakle nevin i oburnuto.

Nažalost, korupcija ne poznaje ni poziciju ni opoziciju, jer je ona ušla u sve pore kosovskog društva, ušla je u institucije dakle, ušla je na fakultete, ušla je u škole, ušla je, gde je već ušla, dakle svugde. I ovaj Izveštaj koji smo dobili prvo u pisanom obliku a kasnije, danas i skraćeni izveštaj gpospodina Pretenija, svi smo pohvalili. Naravno, da i ja u ime Parlamentarne grupe kažem da je on sačinjen vrlo brižljivo. Možda nismo ni svesni koliko je bilo teško doći do nekih podataka koji su nam prezentirani. U to ime, ja zahvaljujem i gospodinu Preteniju i njegovim saradnicima, ali ću vam reći da borba protiv ovog fenomena mora da traje. Mi moramo svi zajedno da se uključimo što masovnije, što upornije, bez pardona ako želimo da institucije Kosova, i od najodgovornih pojedinaca povrate poverenje. Mi ne smemo da pokleknemo protiv ovog zla, mi moramo da pronademo i druge načine borbe protiv ovog zla. Da krenemo od naših institucija, da čujemo šta je uradjeno po izveštajima našeg materijalnog stanja koje smo dali. Ja bih voleo da čujem, da se proverí koliko ima neko od poslanika, šta je prikazao a da mu Komisija dokaže suprotno. Da li ja imam samo kuću koju sam prikazao ili još nešto drugo. Imaju zemlje razradjen ovaj sistem. Mi trebamo da učinimo

sve da Komisiji protiv korupcije stvorimo još bolje uslove za rad. Ja podržavajući ovaj Izveštaj, pozdravljajući i mišljenja mojih kolega, želeo bih da moto nula tolerancije ne ostane samo nula. Hvala vam!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Po tërheqë vërejtjen që e kemi në diskutim Raportin e Agjencionit Anti Korrupsion. Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputetja Radmilla Vujoviq.

RADMILA VUJOVIĆ: Uvažena gospodo, Parlamentarna grupa SLS daje podršku Agenciji kprotiv korupcije i tараži od Vlade i Skupštine da radi na suzbijanju korupcije praktično. Imamo zakone, nadam se i mehanizme da bi se korupcija što više, po pitanju uzimanja maha suzbila, jer je izveštaj zabrinjavajući. Toliko.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar edhe anëtar i Kryesisë, zotëri Ibrahim Gashi.,

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshtëndetje Kabinet qeveritar,

Përshtëndetje kolegë deputetë,

Një gjest i mirë i bërë nga ana e Kryetarit të Kuvendit është që këtë pikë të rendit të ditës e s'postoi nga seanca e djeshme që ishte shumë e ngarkuar dhe la mundësi, që për një çështje kruciale për shoqërinë kosovare dhe për shtetin e Kosovës, siç është çështja e korrupsionit të debatohet në një pikë të veçantë, të debatohet në një vazhdim të seancës kur kemi hapësirë më të madhe kohore, dhe mendoj që krijimi i mundësisë që të debatohet për çështjen e korrupsionit në shoqëritë postkonfliktuale dhe postranzicionale siç është rasti i Kosovës, është një gjest i mirë dhe do të thotë që duhet përshtëndetur dhe inkurajuar edhe në të ardhmen.

Unë përshtëndes prezencën dhe fjalën e kryetarit, përkatësisht të drejtorit të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, zoti Preteni dhe raportin e tij. Raporti flet në fakt se sa ky agjencion ka qenë i suportuar nga institucionet e Kosovës, pra volumi i tij flet dhe rastet që ka marr në shqyrtim, flasin se aq ka qenë mbështetja jonë për një institucion që paralelisht me institucionet të Kosovës, të thirrura për ta luftuar korrupsionin edhe ky ka bërë punën e tij, por ka bërë aq sa ne e kemi mbështetur jo më shumë.

Unë mendoj se sfida më e madhe për shoqërinë në korrupsion, është konstatuar nga të gjithë studiuesit e fenomeneve që lidhen me perspektivat e zhvillimit, demokratizimit të shoqërive siç është Kosova, janë të lidhura, domethënë janë prioritet që lidhen me korrupsionin, përkatësisht me luftimin e korrupsionit.

Në Kosovë mendoj se, ose nëse e shtrojmë pyetjen ku është Kosova në këtë çështje, mendoj se do të duhej të ishim shumë më mirë nga niveli ku jemi sot, për faktin se kishim një asistencë ndërkombëtare ose së pakut popujt që vështrojnë zhvillimet në

Kosovë, në këto tetë vitet e fundit, kanë pritur që Kosova të jetë më mirë në këtë pikë, gjë që nuk është rast. Domethënë, kjo flet se përveç një agjencioni, instancat tjera që janë të thirrura për ta luftuar korrupsionin, që në fakt edhe paguhen për ta luftuar korrupsionin, nuk e kanë bërë si duhet punën e tyre. Pa dashur të interferoj në punën e tyre dhe ta bëjmë temë debati sepse dikush na e tërhoqi vërejtjen që sot të mos flasim për instancat tjera a pajtohemi, unë mendoj se Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit është vetëm një nismë paralele që duhet të asistojë instancat që janë të thirrura dhe që paguhen për ta luftuar korrupsionin, dhe këtu duhet të jetë i mbështetur edhe nga shoqëria civile, e cila mendoj se ka pasur më shumë hapësirë, por nuk e ka bërë punën e saj edhe nga media e pavarur, nëse ka të tillë e cila është dashur ta bëjë punën e vet për të krijuar një ambient, për të krijuar një opinion publik që do të shkojë ndesh me trendet e korrupsionit në Kosovë. Unë po përmend vetëm dy- tri nisma të medias në fushatën parazgjedhore dhe zgjedhore në Kosovë, që jemi dëshmitar të gjithë se sa ka ndikuar që korrupsioni të frenohet ose në njëfarë mënyre që të kemi një tendencë për ta ndaluar atë.

Kemi pasur dy emisione, emisionin “Jeta në Kosovë”, që kërkonte që të kandiduarit për këshilltarë në asamblatë komunale, të shihet a kanë borxhe ndaj shtetit, sa e vjedhin shtetin, sa i kryejnë obligimet ndaj shtetit dhe njerëzit i kemi parë duke vrapuar për t’i paguar faturat e rrymës para se të vijë emisioni “Jeta” në komunat e tyre, ose një emision tjetër “Pro e Contra” që ka ndihmuar, domethënë ka prekur rastet më eklatante të korrupsionit në Kosovë, sa i ka ndihmuar besoj, pajtohet edhe zoti Preteni, sa i ka ndihmuar Agjencionit. Gjithë këtë e thashë për t’u kuptuar se sa komplekse është lufta kundër korrupsionit në një shoqëri siç është rasti i Kosovës. Prandaj, mbështes Raportin, po mbështesë shumë fuqishëm ose insistojë shumë fuqishëm që të mbështetet më shumë Agjencioni, që të hapet debati, për njëfarë mënyre për temat që kanë të bëjnë për korrupsionin në këtë Parlament dhe prej këtu në të gjitha instancat e institucioneve të Kosovës ku mund të debatohet. Pra, i ftoj mediat e pavarura që ta trajtojnë më shpesh temën e korrupsionit. Të gjitha këto instance mund të ndihmojnë bashkërisht që të krijohet një opinion publik ku luftohet korrupsioni dhe që ngushtohen mundësitë edhe ligjore nëse ka të tilla, por sidomos ato të shmangies nga ligjet për të lulëzuar korrupsioni në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se!

Poštovani gospodine predsjedniče Skupštine,

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Svakako da je ovo jako bitna tema i nisam ni očekivao da će neko da podrži korupciju u ovoj sali. Nisam imao nameru da se javim, ali s obzirom da sam na neki način prozvan, znači ja sam bio zajedno u Briselu kao i kolega koji je rekao da smo tamo dobili kritike na ime korupcije, svakako da ono što je svima nama opšte poznato da je to već duže vreme, mogu da kažem postalo i tradicionalno u ovim prostorima, tako da se i građani Kosova prosto utopili u celu tu jednu sliku i ono što je bitno jeste da svakako nije

dovoljno samo konstatacija, nego dovoljne su i neke aktivnosti. Ono pored toga, kako rekoh da sam se osetio prozvanim, pošto je u više navrata pomenuto da su ljudi koji su u institucijama, nosioci tih aktivnosti, svakako da sam ja kao i svi mi ovde u ovoj sali deo institucije i nije mi nimalo prijatno kada čujem da je takva situacija ovde. Svakako da to nije od juče i da to neće moći da se reši preko noći. Ali, ono što je jako bitno, jeste da se to rešava zakonom, i ne samo zakonom, nego i svešču ljudi, tako da u borbi protiv korupcije treba da se uključe ne samo institucije, nego i što veći broj građana. Svakako da je veliki doprinos upravo i na medijima, koji mogu da kreiraju sliku koj će da da što veću popularnost onim ljudima, odnosno i motivaciju onim ljudima koji se bore protiv korupcije, jer prosto, sada imamo jednu situaciju da oni ljudi koji su protiv korupcije, ne samo deklarativno, nego koji su i u praktičnom smislu, imaju jednu dozu podsmeha od onih ljudi, odnosno ima jedan veliki rizik, nose rizik, ali nemaju nasuprot tome nikakvu podršku. Svakako da Parlament, kao najviša institucija, treba da nadje neke modele koji bi jasno motivisali one ljude koji su spremni i kadri i hrabri da udju u koštac sa jednim ovako jako ozbiljnim problemom. Svakako, korupcija nije samo slučaj na Kosovu, ne bih želeo da mi sada udjemo u jednu situaciju gde ćemo se svi osećati okrivljenim. Borba protiv korupcije jeste jedan proces koji mora da traje, i svakako ono što bi bilo jako poželjno jeste da mi u ovom mandatu taj procenat smanjimo. Svakako, ne očekujem da ćemo mi da ga ukinemo skroz, ali isto želim i da ohrabrim sve one ljude, rekoh to je bio i moj povod da se javim za reč, da sam ja bio u delegaciji koja je bila u Briselu, i da je ta konstatacija da je na Kosovu rasprostranjena korupcija. Svakako, to je više bilo deklarativno, jer ja nisam imao priliku da vidim pojedinačno, ponaosobno, osobu ili instituciju koja je okrivljena, tako da ne bih voleo da i onim ljudima, svakako da je mnogi veći broj onih poštenih ljudi koji žive na Kosovu, da se i oni osećaju kao da su deo takvog jednog lošeg načina i želim da orhabrujem sve one koji žele da se bore protiv korupcije i da im kažem da će ovaj parlament svakako znati da ceni to i da će podržati sve ono što je u skladu sa zakonom i sve ono što će da ima kao rezultat bolji život za sve građane koji žive na Kosovu. Zahavaljumem se!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar deputetja Safete Hadrgjonaj.

SAFETE HADRGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendimi im është se krahasuar me raportet e agjencioneve të pavarura të cilat me ligj janë të obliguara t'i raportojnë Kuvendit, që kanë qenë shumë jo përmbajtjesore, ky raport është relativisht më i mirë.

Në raport thuhet se qëllimi dhe puna e Agjencionit është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, të përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit, për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë e të përparuar në Kosovë që bazohet në shtetin e së drejtës.

Nëse nisemi nga ky fakt, atëherë lirisht mund të themi se Agjencioni kundër korrupsionit nuk ia ka arritur qëllimit për çka është themeluar, sepse shoqërinë kosovare e ka kapluar korrupsioni, e çka është më e keqja, korrupsioni gjatë kësaj kohe të raportimit ka qenë i instaluar në institucionet qeveritare, në gjyqësi dhe në ndërmarrjet publike.

Po nëse kemi parasysh faktet tjera se ky agjencion ka filluar punën me vonesë, pra më 12 shkurt të vitit 2007, është përballur me vështirësi nga më të ndryshmit, duke filluar nga mosalokimi i fondeve të kërkuara për të funksionuar normalisht, vështirësitë për të ruajtur pavarësinë dhe ajo çka është më kryesorja, mungesës së vazhdueshme të përkrahjes institucionale, gjë që është normale të mos pranohet veprimtaria e një agjencioni të tillë kur në institucione ishte e pranishme dukuria e korrupsionit. Atëherë, bazuar në të dhënat e raportit, mund të themi se ky Agjencion është përpjekur të kryej detyrën që ia ka ngarkuar ligji.

Në raport vërejmë se më së shumti raste të dyshuara për veprime korruptive ka në institucionet publike, ku nga 124 raste të dyshuara 29% të rasteve janë të zyrtarëve publikë në Qeverinë e Kosovës, kurse 28% të këtyre rasteve janë tek zyrtarët gjyqësorë, do me thënë tek zyrtarët publikë në gjykata, pra 57% të rasteve të dyshuara që gjatë vitit 2007 kanë ndodhur, do me thënë raste të dyshuara për korrupsion, janë tek pjesëtarët e shtetit dhe sistemi gjyqësor. Pra, nga këto shifra shihet qartë se korrupsioni është shumë i dukshëm.

Agjencioni kosovar Kundër Korrupsionit, bazuar në përgjegjësinë ligjore për zhvillimin e hetimeve administrative për çdo rast të dyshimit për korrupsion pas procedurave, dërgimin e këtyre informatave duhet ta bëjnë në Prokurorinë Publike për procedim të mëtutjeshëm. Këtë gjë Agjencioni e ka bërë pa dashur t'i theksoj shifrat të cilat i theksuan shumë kolegët e mi dhe drejtori i Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Mendoj se ky është një shqetësim për të cilin duhet të preokupohet edhe Kuvendi, edhe institucionet më të larta të shtetit, në mënyrë që në të ardhmen t'i përkushtohen kësaj çështjeje më me seriozitet. Kur korrupsioni nuk dënohet me ligj, do me thënë nuk dënohet në përputhje me ligjin, atëherë korrupsioni lulëzon. Në periudhën e raportimit, kjo gjë edhe ka ndodhur në Kosovë.

Nga raporti vërejmë se sipas llogarive të Agjencionit Kundër Korrupsionit në raste të dyshuara për veprimtari korruptive të përcjella në prokurori kanë shkaktuar dëme diku 30 milion domethënë, 28 milion në sektorin publik dhe 2 milion në sektorin privat dhe këto dëme janë me pasoja të mëdha për ekonominë dhe me pasoja të mëdha për qytetarët dhe jetën e tyre në Kosovë.

Kur analizojmë edhe raportet të auditimit për vitet 2005 e 2006, është e qartë se nuk ka ekzistuar vullneti politik në luftë kundër korrupsionit.

Në raport thuhet se disa zyrtarë të lartë nuk i kanë deklaruar pasuritë e tyre, por a janë marrë masa ndëshkuese siç e kërkon ligji ndaj këtyre zyrtarëve, ne nuk kemi informatë.

Atëherë, kjo që thuhet këtu është më tepër përshkrim i gjendjes pa rezultate konkrete si dhe hapja e mundësisë për të vazhduar edhe më tutje me mosdeklarimin e pasurisë.

Një punë e mirë që ka bërë Agjencioni Kundër Korrupsionit konsideroj që janë veprimet konkrete në lidhje me Ligjin për prokurimin publik, ku është rekomanduar anulimi i disa tenderëve të institucioneve qeveritare që në këtë drejtim shumë pak është punuar në të kaluarën, ku kanë pësuar shumë nga operatorët e përgjegjshëm ekonomikë.

Vlerat e përlllogaritura të tenderëve të anuluar kanë qenë 7 milion euro, kurse 5 milion të tenderëve kanë qenë ata tender të cilët janë zhvilluar në Qeveri, do me thënë procedura është zhvilluar në Qeveri dhe 2 milion tek ndërmarrjet publike. Kështu që shumë operatorë ekonomikë kanë pësuar dëme dhe me këtë çështje shumë pak është marrë në të kaluarën. Kështu që unë mendoj që Agjencioni këtu ka bërë një punë të mirë.

Agjencioni Kundër Korrupsionit ka pasur një buxhet prej 412 mijë 952 euro, të cilin e ka shpenzuar vetëm 88.11%. Edhe pse Agjencioni ka disponuar me mjete, ato nuk janë shpenzuar racionalisht me arsyetimin se nuk është lejuar nga Qeveria punësimi i punëtorëve të planifikuar prej 30, do me thënë iu ka lejuar të punësojnë vetëm 15 punëtorë, gjë që ka bërë që buxheti të mos shfrytëzohet në kategorinë paga dhe mëditje dhe kjo ka qenë arsyeja që ka mbetur i pa shfrytëzuar dhe llogaritni një agjencion me 15 punëtorë sa mund ta kryejë veprimtarinë e tij.

Thashë edhe njëherë se pa vullnetin politik lufta kundër korrupsionit nuk është e arritshme. Për vite të tëra Kosova ka qenë nën presionin e kësaj dukurie dhe si refleksion i kësaj, sipas vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare, siç kanë qenë UNDP-ia, Banka Botërore dhe organizata të tjera, qytetarët e Kosovës në fund të vitit 2007 ishin më të varfër se më parë, më pesimistë për të ardhmen e tyre, prandaj është krejt e natyrshme se ish Qeveria nuk u shikua si alternativë dhe besimi u drejtua tek opozita e atëhershme që po ngrihej si e vetmja shpresë për një të ardhme më të mirë të qytetarëve.

Pajtohem me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për përkrahje të këtij raporti, e bindur në gatishmërinë e Qeverisë së tanishme për ta goditur korrupsionin jo me fjalë, por me reforma të thella në drejtësi, në legjislacion, në administratë, në uljen e varfërisë, në uljen e evazionit fiskal dhe të ekonomisë informale dhe me arsimim e kualifikim më të mirë të resurseve njerëzore, sidomos në administratën publike, e bindur se vetëm në këtë mënyrë i hapë rrugën Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare si shtet i pavarur.

Agjencia Kundër Korrupsionit me Qeverinë e tanishme do të ketë pavarësinë e veprimit sipas ligjit, pavarësinë financiare dhe stafin e mjaftueshëm për të kryer funksionin e saj në mënyrë normale që është vepruar në këtë drejtim, besoj që rezultatet janë konkrete, të cilat i theksoi edhe drejtori i Agjencionit Antikorrupsion. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, deputete Hadrgjonaj!
Fjalën e ka kërkuar anëtari i Kryesisë, zoti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ata pak qeveritarë që kanë durimin të rrinë këtu në Parlamentin e Kosovës, po edhe ata që s'janë këtu, gjithashtu do t'i përshëndesim.

Ne, natyrisht, kur flasim për një fenomen të tillë, bisedonim pak përpara me profën dhe kërkojmë falje që ndonjëherë s'po jemi të disiplinuar këtu dhe në kualifikimin që dha përfaqësuesi i Aleancës Kosova e Re se është një fenomen shoqëror, ne thamë gati po del se është fenomen natyror edhe fatkeqësi elementare, të cilës s'mund t'i shmangemi. Sidoqoftë, në këto raste natyrisht nuk e kam ndërmend të flas i ngjyrosur me pozitë - opozitë, natyrisht partia që i përkas unë është pjesë e pozitës, ka qenë edhe përpara, dhe shqetësimi ynë për këto fenomene ka qenë permanent, kështu që edhe sot natyrisht nuk do të bëjë as nuk e kam ndërmend të bëjë ode për struktura të caktuara, sepse si u tha këtu, pak a shumë, nuk ka strukturë publike që do të ishte immune tërësisht nga tendenca korruptive.

Është një fat i mirë në qoftë se një establishment bazohet në njerëz të formuar që kanë një edukatë para se të hyjnë në pushtet, por gjithashtu është fakt, në qoftë se nuk është fat, është fakt, që në fakt pushteti është një sprovë shumë e vështirë për secilin prej nesh.

Së këndejmi, ne nuk mund të deklarojmë imun asnjë institucioni publik, duke filluar nga kompanitë publike e deri te shtëpitë publike informative, por kryesore duhet të bëhen, kryesore duhet të krijohen mekanizmat mbikëqyrës. Njëri nga ata mekanizma është pikërisht Agjencia Kundër Korrupsionit dhe në qoftë se ka vlerësime të atilla, çfarë tha miku im i vjetër zotëri Murati, se kemi dëgjuar në Bruksel se këtu lulëzon korrupsioni, atëherë do të duhej të ishte i vetëdijshëm se ky Parlament është përgjegjës për një gjë të tillë dhe nuk do të duhej të silleshim ne në atë formën se kinse po e pranojmë dhe ndoshta, ndoshta me një farë lloj gjysmë gëzimi se shlyqyr që e tha dikush.

Nga ana tjetër, unë kam përshtypje se ndonjëherë pa marrë parasysh a janë miqtë tanë, armiqtë tanë, e kam fjalën armiq në kuptimin e perspektivës së Kosovës, e dimë, ka pengesa aty këtu. Shpeshherë lihen këto karta rezervë, në qoftë se vjen një moment që për interesa të caktuara Kosovës nuk i ndihmohet, atëherë thuhet ne i kemi thënë se keni korrupsion. Unë nuk e besoj se ka korrupsion më shumë se sa në disa vende të tëra, rajone që janë në Bashkimin Evropian. Të paktën merreni Policinë e Kosovës. S'ka shans të ketë në rajon polici më korrekte se Policia e Kosovës.

Është e vërtetë se gjykatësit nuk janë të vendosur dhe gjithashtu mund të ketë elemente korruptive, por të pajtohemi se shoqëria jonë ende i mbron tërësisht, gjykatësit janë tërësisht të pambrojtur.

Por, nga ana tjetër, për këtë arsye ne e kemi pranuar me kënaqësi asistencën e EULEX-it për këtë lëmi. Kështu që, në këtë aspekt, zonja dhe zotërinj, edhe zotëri kryesues, mos ta marrim si top pingpongu çështjen e korrupsionit, se këtu rruhet sedra e Kosovës edhe kalkulohet perspektiva e Kosovës në aspektin e ndihmave të caktuara. Kështu që, në qoftë se unë them sot se për të fituar besimin e popullit jam i gatshëm të godas korrupsionin e tjetrit, nuk kemi bërë kurtho. Siç tha njëri, për besimet e veta, për idealet e

veta është në gjendje ta sakrifikojë kokën e tjetrit. Në qoftë se do, sakrifikojë kokën tënde, se të tjetrit ...

Për këtë arsye, më lejoni që edhe unë, gati më shumë për konkurrencë fola këtu, pasi foli zotëri Ibrahimimi dhe të tjerët, thashë po unë, pse nuk flasë. Për këtë arsye, po them, në qoftë se zotëri Preteni në cilësinë e drejtorit të Agjencisë shkon diku, do të duhej të shkonte me besimin e plotë se e ka mbështetjen totale të këtij Parlamenti, pa marrë parasysh a janë pozitë, opozitë, minoritarë ose mazhurarë, dhe jo vetëm kjo Agjenci, por gjithashtu, si tha zotëri Lutfi Haziri, me kënaqësi e citoj, për fat të keq nuk është këtu, të krijohen edhe mekanizma të tjerë që do ta luftojnë dhe do të themi ne në Bruksel, në qoftë se shkojmë herën tjetër, ose fundi i fundit, edhe në Bangladesh po të shkojmë, themi se na kemi mekanizma të cilat janë legal, të cilat i mbështesim, të cilat e luftojnë korrupsionin që është i pashmangshëm, por kryesore është ndjekja e korrupsionit, jo thjeshtë imuniteti, imuniteti ndaj tij në mënyrë paraprijëse Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu!
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, i nderuari zoti Kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Unë e mirëpres raportin e sotëm njëvjeçar të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit dhe dëshiroj ta falënderoj drejtorin për sjelljen e raportit.

Nga raporti është e qartë se ky Agjencion është i ri dhe se që nga fillimi ka pasur probleme ose një periudhë njëvjeçare ka kaluar kryesisht rreth funksionalizimit të këtij Agjencioni dhe se buxheti të cilin e ka poseduar, nuk ka qenë i mjaftuar. Prandaj, menjëherë shpreh mendimin tim, sikurse edhe kolegët e tjetër, se duhet mbështetur financiarisht, do të thotë, duhet ngritur buxhetin e Agjencionit. Por, në mënyrë që të mbështesë punën e Agjencionit, unë kam disa propozime për të cilat mendoj se do ta ndihmojnë vetë Agjencionin dhe rezultatet e tij.

E para, është se brenda periudhës njëvjeçare Agjencioni duhet të përmbushë dispozitën ligjore, sipas të cilës, Agjencion nxjerr raport vjetor për thyerjet serioze dhe të zakonshme të ligjit, të rregulloreve dhe të parimeve të etikës. Sikur ta kishim një analizë të asaj se sa janë thyer ligjet të cilat kanë të bëjnë me këtë lëmi, ose rregulloret, atëherë do të ishte më lehtë që të bëjmë ndryshimet e ligjeve ekzistuese ose plotësimet e ligjeve ekzistuese. Në qoftë se këto ligje janë të mjaftueshme, atëherë duhet dhënë informatën se janë të mjaftueshme dhe se po funksionojnë.

E dyta, është se sipas Ligjit kundër korrupsionit, gjithashtu Agjencioni duhet të përgatit një strategji kundër korrupsionit për Qeverinë dhe brenda 12 muajve, nga fillimi i funksionimit të Agjencionit, duhet të konfirmojë strategjinë ose të propozojë ndonjë ndryshim të strategjisë ekzistuese.

Nga raporti, prej të dhënave nuk e dimë se çka është duke ngjarë në këtë drejtim.

E treta, për të cilën konsideroj se është më e rëndësishmja, është se unë kisha dashur ta kem një vizion të Agjencionit, çfarë do të bëjë Agjencioni për 5 vitet e ardhshme, cilat do të jenë strategjitë dhe mekanizmat të cilat do t'i shfrytëzojë Agjencioni dhe, mos të harrojmë se ky nuk ka të bëjë vetëm me luftimin e korrupsionit, por edhe me parandalimin e korrupsionit, ose të dhëna të tjera, cilat janë shkaqet në bazë të të dhënave të cilat i ka mbledhur Agjencioni, ose edhe vetë pasojat ekonomike. Kisha dashur të kemi një raport më të detajuar se mendoj që do të na ndihmonte më shumë edhe neve që ta kemi një pasqyrë më të qartë.

Në fund, një fakt është i rëndësishëm se duhet gjithashtu të forcohet edhe sistemi i drejtësisë. Unë kam një propozim për Kuvendin që të mendojë formimin e Gjykatës dhe Prokurorisë Speciale, në këtë aspekt, e cila do të ishte e mbrojtur dhe e paguar mirë deri në funksionalizimin e plotë të sistemit të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Sylja!

Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryeses!

Ministra të pranishëm,

Deputetë të nderuar,

Me themelimin e Agjencionit Antikorrupsion kemi shpresuar se kjo dukuri e cila ishte bërë shqetësuese për zhvillimin institucional demokratik, do të pengohet në mënyrë të dukshme dhe pritjet tona kanë qenë të mëdha, sepse tani kishim një agjencion, i cili merrej drejtpërdrejt me këtë dukuri, e cila kishte lëshuar rrënjën në tërë porët e jetës shoqërore dhe në Kosovë nuk ishte befasi që njerëzit të cilët punonin në institucione, brenda natës bëheshin të pasur derisa pjesa dërmuese e shoqërisë varfërohej çdo ditë e më shumë. Andaj, themelimi i këtij Agjencioni krijoi shpresa se kësaj dukurie do t'i ndalej hovi.

Ne sot po shqyrtojmë raportin vjetor të këtij agjencioni, një raport i cili flet mbi themelimin, mbi veprimtarinë e tij, për mungesë të buxhetit dhe rrjedhimisht edhe të stafit të tij, për çka edhe do të pajtohem. Por, ky raport nuk përmban në veti ato pritjet tona dhe të qytetarëve për të parë vërtet luftën kundër korrupsionit, për çka është themeluar ky agjencion dhe për çka është ndarë ky buxhet nga Kuvendi i Kosovës.

Ne kemi një raport shifror mbi punën e Agjencionit dhe ne si deputet duhet ta deshifrojmë për ta kuptuar këtë punë të tyre. Por, edhe në qoftë se arrijmë ta bëjmë këtë deshifrim, nuk arrijmë t'i kuptojmë rezultatet e kësaj pune, sepse kemi vetëm shifra dhe jo materie, ndërsa Agjencioni arsyetohet se Ligji nuk ia lejon ta bëjë këtë punë publike dhe ne si Kuvend vijmë para një dileme, a i ka kryer ky agjencion me të vërtetë detyrat e veta dhe me çka ta masim këtë, dhe ku qëndron fajti, për mosefektet deri më tani që Agjencioni nuk ka qenë serioz dhe ka dërguar lëndë që nuk duheshin dërguar në Prokurori, apo Prokuroria dhe Gjyqësori janë të përfshirë nga korrupsioni dhe ndikojnë dhe janë pengesë për luftimin e korrupsionit. Për të ardhur deri te një gjykim i tillë, para

nesh si deputetë dhe si Kuvend, agjencioni duhet të jetë transparent për të parë punën e tyre. Ne duhet të dimë se vërtet çka kanë punuar ata, cilat lëndë i kanë punuar dhe a ua ka hedhur poshtë Prokuroria me aq lehtësi.

Mendoj se është e nevojshme dhe e domosdoshme për të ndryshuar ligjin për të qenë transparent, përndryshe harxhohet kotë Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe rezultatet do të jenë po këto që i kemi sot edhe pas një viti, sepse Kuvendi nuk është i qartë për punën dhe gjetjet e Agjencionit. Andaj, gjetjet dhe lëndët që i dërgon Agjencioni Prokurorisë duhet të bëhen publike dhe Agjencioni duhet të mbajë përgjegjësi për këto lëndë që do t'i bëjë, sepse ai nuk guxon të bëhet institucion i thashë e thënave, por institucion që sjellë fakte para drejtësisë. Përndryshe, nuk ka kuptim të sillët një raport ku shkruan se “kam dërguar 47 informata në Prokurori, 6 janë hedhur, të cilat kanë të bëjnë me Gjyqësorin, dhe për të tjerat nuk ka përgjigje”. Pse ne duhet paguar këtë agjencion, kur puna e tij me një lehtësi hidhet nga Prokuroria pa e dhënë asnjë arsye. Andaj, ndryshimi i ligjit dhe bërja transparente e punës së Agjencionit krijon mundësi që Kuvendi të ushtrojë ndikimin mbi Prokurori dhe Gjyqësor, që ata ta luftojnë korrupsionin, jo të bëhen kupola të korrupsionit dhe mbrojtës të tij.

Funksionimi i ligjit dhe barabarësia qytetare para tij krijon mundësi të ndërtimit dhe të funksionimit të shtetit demokratik dhe stabil. Andaj, është punë e mirë që zyrtarët e lartë duhet të deklarojnë pasurinë dhe mendoj se kjo është një fillim i mirë, por duhet kuptuar se derisa të gjithë qytetarët nuk e deklarojnë pasurinë dhe prejardhjen e tyre, zyrtarët e korruptuar do të gjejnë forma të mbulimit të pasurisë së paligjshme dhe ky agjencion do të dështojë në këtë aspekt. Andaj, është mirë që të krijohet mundësi e regjistrimit dhe e prejardhjes së pasurisë së gjithë qytetarëve, sepse të gjithë duhen të jenë të barabartë para ligjit dhe kështu do të pamundësohej shmangia ndaj ligjit, e cila shmangie krijon korrupsionin.

Mendoj se duhet përkrahur Agjencionin duke ia plotësuar edhe nevojat e shumta, por në rend të parë duhet ndryshuar ligji dhe puna e tij të jetë transparente para Kuvendit dhe qytetarëve. Përndryshe, ky raport me shifra, pa materie të ditur, do të krijojë dilema dhe ne nuk guxojmë t'i besojmë sy mbyllazi askujt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Hyseni!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Hajdin Abazi.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm.

Unë pajtohem me këtë raport dhe e përshëndes edhe për faktin se jam pak familjar me këtë agjencion nga brenda dhe i di peripetitë të cilat i ka ky agjencion në punën e tij, jo vetëm ky agjencion, por edhe organizatat e tjera, mekanizmat e tjerë, qofshin qeveritarë, qofshin joqeveritarë, ku nuk mungojnë edhe kërcënimet nganjëherë.

Andaj, po them, ky agjencion, ngase është qeveritar, ngase është punë e Qeverisë, duhet të mbështetet me resurse, duhet të alokohen fondet, duhet të mbështetet edhe më me

shumë resurse njerëzore të specializuara për luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit. Shpresoj se kjo Qeveri do të veprojë konform sloganit të tyre, do të thotë, do t'i ndihmojë jo vetëm me fjalë, por edhe konkretisht.

Por, mendoj se edhe ligji, sidomos ligji shumë i përfolur mbi qasjen në dokumentet zyrtare, duhet të jetë i tillë ngase ka tendenca, sidomos kohën e fundit, por edhe në të kaluarën, ky ligj të mbetet sekret, sidomos ndaj mediave dhe të mos qarkullojë informata në publik për çka është i interesuar publiku të dijë. Dhe, ky ligj, për shkak të mangësive që i ka, duhet të shndërrohet në ligj për shpalosjen e informatës për interes publik, do me thënë, të quajturin disclosure act që e kemi gjithkund në botë.

Për shkak se shumë sende ngatërrohen këtu, kam parasysh institucionet qeveritare, bile pak më parë më ra ndërmend një rast, sa isha në Qeveri duke punuar, dikush nga këshilltarët e lartë kish bërë shpenzim marramendës telefoni dhe atë informatë, dikush nga shërbyesit civil e kishte dhënë në media dhe media e kishte publikuar, ky tregim është i para disa viteve, dhe të nesërmen menjëherë, sekretari permanent i ministrisë ua dërgon një memo gjithë shërbyesve civil duke ua rikujtuar se kemi të bëjmë me sekretin e punës, të cilin e ka nënshkruar me kontratë të punës. Do me thënë, është ngatërruar ajo qëllimisht se çka është sekrete e çka është informatë për t'u publikuar. Shpeshherë dëgjojmë se pagat, mëditjet janë çështje private që nuk është ashtu, për shkak se pagat, mëditjet dhe shpenzimet e shërbyesve civilë, mendoj të gjithë atyre që marrin nga buxheti i Kosovës, është shumë publike për shkak se financohen nga taksat e publikut. Do me thënë, këtu duhet ta kenë qartë edhe drejtorët nëpër ndërmarrjet, korporatat publike se të ardhurat e tyre, shpenzimet e tyre nuk janë private, ato ndërmarrje nuk janë private, andaj janë publike dhe çdo gjë duhet të publikohet. Kjo pastaj do të lidhet me tenderë, informatat duhet të publikohen të tëra, nuk ka sekrete kur është në pyetje financa publike.

Unë edhe njëherë po e përsëris dhe po e përsëris punën e Agjencionit ndonëse ka mund të bëhet shumë më shumë, po të kishte pasur ndihmë ky Agjencion, ndihmë konkrete. Aq sa e kemi ndihmuar, aq është punuar, e shpresoj se tash e tutje, nëse dëshirojmë që me të vërtetë korrupsionin ta luftojmë sinqerisht, duhet t'i japim pak më shumë ndihmë këtij agjencioni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Tali!

Para se të fillojë zoti Hajdin Abazi, kisha dashur t'ju pyes, në fakt ta marr mendimin e juaj për një pauzë njëorëshe, meqë kemi të lajmëruar edhe 10 diskutues. Ndërkohë, presim të përgatitet një pako e ligjeve që do t'i shqyrtojmë nesër në një seancë dhe derisa ato të përgatiten, ne bëjmë pauzën dhe para mbarimit të kësaj seance mund t'i marrim nëpër kutit tona materialet e kësaj seance. Ndoshta edhe me këtë qëllim justifikohet shtyrja për një orë, mbas diskutimit të zotit Abazi.

HAJDIN ABAZI: Përsëndetje, zoti kryesues!

Përsëndetje ministra të pranishëm,
Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se Raporti që na ka sjellë Agjencioni Antikorrupsion i Kosovës është një akt i cili duhet të na bëjë të mendojmë mirë sepse kemi një rast për të parë se sa në të vërtetë shoqëria jonë është e infektuar nga kjo sëmundje dhe sa kemi bërë ne që të shërohem nga kjo sëmundje. Rezultati ose konstatimi i përgjithshëm është se në të vërtetë kemi bërë shumë pakë. Këtu e thanë edhe disa parafolës që, vërtet, shkalla e korrupsionit është e lartë dhe unë dua ta kujtoj këtu vetëm një fakt se vetëm auditimi ka konstatuar se në të gjitha ministritë dhe në Kryeministri gjatë vitit të kaluar janë manifestuar me qindra gabime, deformime, shkelje të ligjit, që do të thotë se është një përmasë tepër e madhe. Prandaj, këtu ka pasur mundësi të bëhet shumë më tepër dhe këtu duhet të involvohet një segment tepër i rëndësishëm që mund ta japë kontributin e vet. Ky segment, pa cilin nuk do të mundet kurrë të luftohet korrupsioni, lidhet me një emër, e ai është drejtësia, përkatësisht gjykatat. Mirëpo, çfarë ndodhë. Ndodhë në të vërtetë këtu një absurd, se edhe vetë gjykatat janë të involvuara në këtë fenomen.

Nga numri i përgjithshëm në bazë të përqindjes shihet se këtu edhe gjykatat janë të përfshira me 28%, menjëherë pas institucioneve qeveritare. Ndërkaq, nëse ne do të zbrisim nga rastet të cilat janë paraqitur në Prokurori, atëherë ndërron vendi dhe gjykatat dalin në radhë të parë me 29.7%, ndërkaq institucionet qeveritare zbresin me 27.6%. Kjo për mua është tepër shqetësuese, sepse instanca e fundit ku ne duhet të drejtohem për t'u ndarë drejtësia, për t'u luftuar ky fenomen i shëmtuar dhe i dëmshëm për shoqërinë, vetë aty manifestohet ky fenomen.

Si mundemi ne të kërkojmë tash nga gjykatat ose çfarë mund të presim që gjykatat do të bëjnë në luftimin e këtij fenomeni, kur gjykatat në të vërtetë qëndrojnë në top listë. Kjo është shqetësuese dhe unë shtroj pyetje: Pse ndodhë kjo, kush e bën këtë dhe çfarë do të bëjmë që ta pengojmë këtë?

Konsideroj se sado që pushteti ynë ngrihet mbi tri shtylla dhe gjyqësia është një shtyllë e veçantë dhe e pavarur, duhet të ekzistojë një organ që do ta mbikëqyrë dhe do ta kontrollojë edhe gjyqësinë, sepse nëse aty manifestohet fenomeni i korrupsionit, atëherë ai nuk duhet të jetë imunë dhe gjykatësit duhet në radhë të parë të shkojnë në përgjegjësi ose elementet e gjykatave, përkatësisht personeli i caktuar që është involvuar këtu.

Unë e ndaj po ashtu mendimin me parafolësit se Agjencioni Antikorrupsion nuk ka mund të bëjë në mënyrë të mjaftueshme dhe është e vetëkuptueshme sepse është një institucion i ri. Mirëpo, nëse ne shohim, ky institucion e ka kapacitetin njerëzor çka i duhet më pak se përgjysmë, i duhet edhe njëherë aq të shtohet numri i tyre që të mund të jenë më efikas. Dhe, unë do ta shfrytëzoj rastin këtu që t'i apeloj edhe ne këtu si kolegë, por edhe Qeverisë, që të planifikojë për vitin e ardhshëm për të shtuar numrin e domosdoshëm të personelit të këtij agjencioni, ashtu që ai të mund të jetë më adekuat.

Le të kujtojmë se Agjencioni Antikorrupsion sipas përllogaritjeve të tyre e ka mbrojtur buxhetin e Kosovës nga dëmtimi në vlerë prej 30 milion eurosh, ndoshta edhe më shumë. Mirëpo, mjetet e alokura që i janë bërë këtij agjencioni në vitin e kaluar, janë tepër simbolike dhe tepër modeste që me të vërtetë ky agjencion është shembull se si duhet dikush të funksionojë në mënyrë jo vetëm ligjore, jo vetëm me dashamirësi, por edhe me

patriotizëm dhe, po e theksoj këtë, me patriotizëm qytetarë dhe institucional për ta kryer detyrën e vet sepse, le ta sjellin vetëm një shembull sa për të kujtuar. Kemi edhe Agjencionin për Rregullatorin Energjetik dhe po ta bëjmë një krahasim midis këtyre dy agjencioneve, atëherë Agjencioni Antikorrupsion duhet vërtet të marrë një mirënjohje nga ky Kuvend dhe të përkrahet me të gjitha mjetet. Duhet ta përkrahim, duhet t'i dalim në ndihmë, sepse i vetmi është ky agjencion në situatën e tashme, i cili prek atë plagë prej të cilës vuan e gjithë shoqëria.

Prandaj, që të jetë funksion ky Agjencion, që të kenë motiv, duhet ne të shqyrtojmë edhe çështjen e ngritjes së pagave të tyre për t'i bërë më të dinjitetshme, që mos të ndodh të ikin ekspertët sikurse që ka ndodhur që kanë ikur nga ky Agjencion, po përkundrazi, përveç motivit që e përmenda patriotik, të kenë edhe motivin e pagesës, të kenë edhe motivin se për punën që e bëjnë nuk u nënshtrohen vetëm rreziqeve, por njëherësh kanë edhe një mirënjohje nga shoqëria, përkatësisht nga institucionet, dhe nëse ne këtu duam ta bëjmë, atëherë duhet ta bëjmë. Duhet të planifikojmë që në vitin e ardhshëm ky Agjencion, ose nëse jo në vitin e ardhshëm, do të kisha apeluar edhe tash, në qershor, kur të rishqyrtohet buxheti, të shihen mundësitë që përkrahet më tepër, sepse nëse ky Agjencion do të jetë veprues, do të jetë një roje ku të tjerët do ta dinë se ne duhet ta zbatojmë ligjin, sepse kemi dikë që do të na ndjekë, kemi dikë që do të na përcjellë dhe to t'i shqyrtojë rastet.

Prandaj, si një preventivë, duke shfrytëzuar rastin për ta përgëzuar për punën që ka bërë dhe duke shpresuar për një punë edhe më të madhe, unë apeloj që të ketë një përkrahje më të madhe financiare, por edhe me personal që të mund të jenë më efikas. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Abazi!

Edhe njëherë po e hedh, si të them, propozimin e një pauze deri në orën 15,00. Mirë, atëherë vazhdojmë punën në orën 15,00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Shikoni, një pjesë e deputeteve femra janë të ftuara të ministres, po më duket, në një drekë. Premtuan që do të kthehen deri në orën 15,30. Nëse doni, i presim edhe nja 10 minuta, sepse ne nuk kemi kuorum as për të diskutuar.

Në sallë janë të pranishëm 39 deputetë, na duhet edhe një deputet për të pasur kuorum për të diskutuar.

Duke qenë se edhe ashtu s'po arrijmë të krijojmë kuorum për të vazhduar diskutimin, një propozim prej disa shfave të grupeve parlamentare ishte që vazhdimi i kësaj mbledhjeje të jetë nesër në orën 12,00, pastaj në orën 15,00 është seanca për grupin e ligjeve që na presin. Ne na duhet edhe 2 -3 vetë për kuorum. Janë 12 diskutues të paraqitur. Është një propozim për të vazhduar, ndoshta është mirë të vazhdojmë, sepse e kemi këtë pikë të bartur prej seancës së kaluar. Edhe sot nëse e bartim, po bëhet shumë e gjatë. Ndërkohë,

edhe grupi i grave që kanë qenë në një drekë premtuan se po vinë dhe mund të vazhdojmë punën.

Mirë, atëherë e ftojme deputetin Numan Baliq, që ta marrë fjalën.

NUMAN BALIĆ: Dozvolite da vas selamim i da kažem nekoliko reči koji se vežu za ovo pitanje. Naravno, ovdje imam jednu primedbu, smatrao sam da bi bilo mnogo efikasnije da sam govorio pre pauze, ali hajde, nije se to desilo.

Rećiću nekoliko stvari koji se tiču za Kosovsku agenciju protiv korupcije, za borbu protiv korupcije, i ono što smatram da je važno u cjelom ovom pitanju koje se tiče fenomena korupcije i borbe protiv korupcije.

Bojim se i mislim da to mišljenje delim sa mnogim građanima Kosova da je pitanje korupsije previše rabljeno, da je previše upotrebljavano, da je možda vrlo često neadekvatno upotrebljavano i da da možda često postoji konfuzije oko same korupcije i njenog objašnjenja i njenog značaja.

Mislim da u mnogim stvarima u kosovskom društvu, ne samo da se radi o korupciji, nego da je ona ili prisutna ili je vrlo usko vezana sa pitanjima masovne zloupotrebe, krađe i oštećenjem društvene imovine. To su ozbiljni fenomeni koji nas teraju sve da o ovom pitanju ozbiljno razmišljamo i da nađemo načine, da najprije počevši od ovog izveštaja Agencije, potom svih mehanizama koji postoje, vladinih i ostalih, da nađemo pravi odgovor na ono što nam je readiti.

U izveštaju koji smo dobili od Agencije za privatizaciju, podaci stoje veoma drugačije ili sasvim drugačije od onoga kako je izlagao premijer ili pojedini zvaničnici Vlade.

Vrlo smo često čuli, bili smo u prilici da u mnogim javnim nastupima od premijera čujemo da su šampioni korupcije PTK, KEK, Aerodrom i tako dalje, i tako dalje. Međutim, na osnovu izveštaja Agencije za privatizaciju izlazi da najveći broj slučajeva koji su pokrenuti su upravo pokrenuti i vezani su za slučajeve unutar Vlade Kosova. 36 prijavljenih slučajeva, najveći broj. Druga na mjestu po broju prijavljenih slučajeva je ona koja se tiče sudsko policijskog odjela, odnosno sudije. Treća na toj tabeli famoznoj je lokalna vlast, ne mojmo zaboraviti opštine, opštinske zvaničnike, predsedike opština, jer se i tamo rade nepravilnosti i zloupotrebe. Četvrte su tek PTK, KEK, železnice i tako dalje. Dakle, u najmanju ruku trebamo biti pristojni i stvari poredjati onako kako jeste. I sada želim da dam jedno tumačenje koje se nadam da ga delim sa vama. U javnosti i posebno u medijima postoji jedna tendencija da se stvara jedna zbunjenost oko korupcije, i zamjena teza, pa se vrlo često za korupciju optužuju oni koji su najmanje krivi ili se podgrejavaju neke aferi ili neki slučajevi. U modi je da se iznosi slučaj, da je neki portir tamo u bolnici, u Kliničkom centru ili bilo gdje pustio nekoga da uđe i čovjek koji možda uzeo 5 ili 10 eura, ili neki policajac koji je prekoračio ovlašćenja ili možda neki natavnik koji je sada na kraju školske godine da bi dao dvojku nekom lošem učeniku pojeo dvije kokoške i 20 piva, nešto što je zaista sasvim drugačije.

Molim vas, nemojmo stvarati zabunu oko toga šta je prava korupcija i šta je nanošenje zla privatnoj imovini. Šanse za korupciju i zloupotrebe su najveće tamo gde ima najviše para. Ovde ima ljudi iz Vlade, i oni koji nisu u Vladi, dakle Vlada raspolaže sa milijardu eura. Pa, neko će reći, ovo su izvještaji iz 2007. sedme godine, to je bila prošla Vlada. Dobro, bila je prošla Vlada, ali najveći broj, zamenjeni su ministri, ali najveći broj zvaničnika je tamo i dalje na tome mjestu, i mi dobro znamo kako se dešavaju masovne zloupotrebe sa narodnim novcem. Tako da uzroke glavne korupcije trebamo tražiti na onim mjestima gde postoji mogućnost za zloupotrebu, za korupciju, za mito i za sve ono što neki ljudi prosto kažu kradje ili hajnat. Dakle, ono što je dobro poznato u našem naredu i sa kojim se trebamo ozbiljno suočiti.

Moj prijedlog i prijedlog o kome bi, naravno, trebali svi da razmišljamo, jeste da je izveštaj Agencije dobar, mijere koje se pravlja su dobre, ali Agencija protiv korupcije ne može ništa uraditi bez podrške Vlade. Vlada je prva stepenica koja mora podržati. Na kraju krajeva, Kryeministri, në një ndër paraqitjet famoze, vetë ka thënë që prioriteti i parë i Qeverisë është lufta kundër korrupsionit.

Ako je borba protiv korupcije prvi prioritet, onda nemojmo prenebregavati činjenicu da je Vlada, upravo Vlada prvi izvor korupcije i da se on mora suočiti sa ministarstvima, sa visokim zvaničnicima, sa stalnim sekretarima, i one koji su daleko pobjegli i misle da su daleko od ruke pravde. Dakle, sa svima onima koji su radili ne za 10 eura i 20 eura, nego za pola miliona, ili pet miliona ili mnogo više miliona eura. Naravno, da su ovde bitni sudovi, policija, sve poluge vlasti, naravno da su važne i lokalne vlasti, kao što sam malo primjetio, naravno da su važni, te kako su važni PTK i KEK, koji je postao definitivno fenomen Kosova. KEK je kosovski fenomen sa kojim se moramo posebno suočiti, ali nije dovoljno reći da je neko šampion u korupciji i ići samo zato da slijedimo politički marketing, predstavljanje pred medijima i nešto što nema nikakve efikasnosti.

Dakle, da završim ovu raspravu. Da bi se obavila efikasna borba protiv korupcije, to mora pokrenuti Vlada. Da bi to obavila Vlada, ona ane može biti korumpirana, oni ljudi koji se bave korupcijom, ne mogu voditi borbu protiv korupcije. Da bi se to dovršilo to kraja, moramo imati efikasan policijski sudski sistem, moramo imati zaštićene i poštene sudije. Sudije koje će biti zaštićene i koji su poštjeni, i naravno, moramo imati čitav sistem vlasti.

I naravno, da ne zaboravim na kraju da kažem, da mi mnogo često govorimo o tome, da Parlament ima poziciju da nadgleda i kontrolioše Vladu. To je stvarna uloga i odgovorna uloga Parlamenta. Zar nismo svi mi, uglavnom to samo formalno rekli. Kada ćemo konačno da Parlament promjenimo u tijelo koje će stvarno biti kontrolni mehanizam i da Parlament bude taj koji će inicirati, započeti i dovršiti procedure odgovornosti i stavljanje pred pravde i zatvoriti i suditi one koji su odgovorni za, za malo da kažem prostitutciju, za korupciju. Dakle, one koji zaista trebaju odgovarati. Ima jako puno veze, evo gospodin Koci se slaže sa mnom. Nažalost, ima jako puno veze, prema tome, dozvolite mi da završim, mislim da trebamo svi zajedno u najboljim namerama podržati borbu protiv korupcije, ali da ta borba protiv korupcije više ne ostane samo na riječima, nego da konačno vidimo neku od krupnih riba, pa makar to bio i ja, koji će biti u

zatovor, a ne da više nalazimo neke sekundarne i periferne osobe koje zaista nisu odgovorne za to. Hvala vam ljepa!

KRYESUESI: Faleminderit, deputeti Baliq!

Edhe njëherë më duhet t'ju informoj se në përputhje me Rregulloren ne nuk mund të punojmë, se i kemi vetëm 36 deputetë, ndërkaq në anën tjetër po rritet numri i të paraqiturve për diskutim. Rregullorja thotë qartë që kur bie numri i deputetëve nën 1/3, s'mund të vazhdojë seanca. Nëse pajtoheni të vazhdojmë, me shpresë që gratë që janë në një drekë do të na bashkohen shpejt. Fjalën e ka deputeti Ramë Buja, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

RAMË BUJA: Zoti kryesues,

Në Rregullore thuhet shumë qartë, nëse 1/3 e deputetëve nuk janë prezentë në sallë, nuk mund të zhvillohet as debat. Ne mos të bëjmë lojë, ju lutem, kemi 36 deputetë.

KRYESUESI: Të njëjtën gjë e thashë edhe unë. Ju tash Rregulloren po e dini, mund të bëjmë një pauzë 10 minuta sepse s'mund të vazhdojmë. Kemi paralajmërim se do të vijë një grup deputetësh, që ishte këtu, që edhe shefi i Grupit të AKR-së.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Jo rrallë herë e kam thënë dhe po bindeni, po më duket, që ky Kuvend është në një krizë mjaftë të madhe të veprimit të vet, është shumë e vërtetë. Edhe me Rregullore të Punës thuhet që kur ka seanca të Kuvendit të Kosovës, pushojnë aktivitetet e tjera të deputetëve. Ne tash kemi një numër ose një pjesë mjaft të madhe të këtij Kuvendi të cilët kanë shkuar në një aktivitet tjetër, prandaj nuk na mbetet asgjë tjetër përpos që të marrë fund ky sesion, sepse Rregullorja.... Ne këtu nuk po flasim me telefona, po flasim se sa njerëz janë në sallë. Pavarësisht kësaj, nëse ne po e themi vazhdimisht se duhet t'i respektojmë Rregulloren dhe rregullat, atëherë nuk na mbetet asgjë tjetër përpos që t'i ndërprejmë punimet sepse nuk ka kuorum për të vazhduar më tutje.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli.

E do fjalën edhe shefi i Grupit të LDK-së dhe ai i LDD-së?

LUTFI HAZIRI: Rregullorja është e qartë, zoti kryesues. Ka ndodhur një aktivitet tjetër, grupi joformal i deputeteve është në drekë pune diku dhe kemi mungesë të deputetëve. Nëse Rregullorja është e saktë, nuk ke nevojë çka t'i pyesësh të pranishmit. Ose duhet të vendoset për një orar tash, ose duhet gjetur mënyrën për përfundimin e seancës. Seanca nuk mund të shtyhet në pafundësi.

KRYESUESI: Faleminderit! Një propozim është që nesër kjo pikë të jetë si pikë e fundit në seancën që e kemi të rregullt për shqyrtimin e ligjeve të Ahtisarit.

Propozoj edhe 20 minuta pushim.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, prezent kemi më shumë se një të tretën e deputetëve dhe kemi kuorum për të zhvilluar debatin. Në radhë për diskutim është deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se sot Parlamenti i Republikës së Kosovës është duke shqyrtuar një raport të një agjencioni të pavarur, shumë të rëndësishëm për ndërtimin e mëtutjeshëm të një shteti ligjor demokratik.

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit sot solli raportin e vet dhe po shqyrtohet ky raport. Dua ta përgëzoj drejtorin e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, zotin Hasan Pretenin për një raport konciz, me shifra, konkret, konform mundësive të tij dhe të Agjencionit që ai e udhëheq për një kohë relativisht të shkurtër, që nga krijimi i këtij Agjencioni.

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit është themeluar vitin e kaluar dhe ka për qëllim luftën kundër një dukurie tashmë që ka marrë përmasa jo vetëm në Republikën e Kosovës.

Duke u thirrur në Ligjin kundër korrupsionit, ky Agjencion detyrë primare ka fuqizimin e rendit dhe të ligjit. Si Agjencion i pavarur, i themeluar dhe i votuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, vërtet duhet të jetë Agjencion i pavarur dhe është rol i këtij Kuvendi të nderuar që t'i japë mbështetje të fuqishme këtij Agjencioni.

Shumë kolegë deputetë këtu potencuan edhe shifra të ndryshme, bënë edhe krahasime të ndryshme.

Pasojat e dëmtimit në buxhetin e Kosovës për vitin e kaluar, sipas raportit të Agjencionit, janë 30 milion euro. Konsiderohet se në vitin e kaluar 7 milion euro ka qenë shifra e keqpërdorimeve dhe abuzimeve me tenderë. Mirëpo, nuk më shqetëson shumë ajo shifër sa më shqetëson e dhëna tjetër. Abuzimet me tendere, shkeljet e procedurave, nepotizmi dhe ndikimet nga jashtë në “tenderomaninë” shumë të përfolur në Kosovë, vetëm gjatë 3 muajve të këtij viti janë diku 2.5 milion euro. Kjo do të thotë se metastazat e këtij kanceri të shoqërisë dhe të funksionimit të ligjit dhe demokracisë në Kosovë janë bartur edhe në këtë Qeveri vetëm për 3 muajt e parë, po thotë kjo shifër sipas raportit të Agjencionit 30%. Ju lutem, kolegë deputetë, kjo është shumë serioze.

Në deklaratimet që i ka pasur kryetari i këtij Agjencioni, thjeshtë kam përshtypjen se është sabotuar nga sistemi gjyqësor, nga prokuroria dhe nga gjykatat. Në qoftë se lëndët janë proceduar tek sistemi gjyqësor, i cili e ka rolin e vet, dhe që raportohet për 6-7 raste të korrupsionit mu në atë sistem, atëherë ne si të zgjedhur të popullit, si deputetë, duhet ta themi fjalën tonë.

Kemi edhe raste të tjera që janë potencuar në këtë raport, por krejt në fund.

Ne kemi përgjegjësi si Parlament, sepse prej këtij organi më të lartë legjislativ të vendit, janë formuar edhe ekzekutivi i vendit dhe institucionet tjera. Ta luftojmë këtë dukuri tejet negative e cila po ndikon edhe në buxhetin e Kosovës, edhe në zhvillimin ekonomik dhe në qoftë se flitet në Kosovë vetëm për korrupsion dhe shikohet vetëm zi për shoqërinë kosovare e institucionet, atëherë edhe investitorët e mundshëm potencial që priten tani të vijnë në shtetin e ri të Kosovës, thjeshtë po kam drojë se po e pengojmë vetë zhvillimin e shtetit e të vetvetes dhe perspektivën e vendit tonë.

Duke i dhënë një përkrahje të fuqishme këtij Agjencioni të ri, i cili ka filluar mirë, përkundër vështirësive enorme, që nuk po dua t'i cek tani, unë kam një kërkesë drejtuar Qeverisë së Kosovës që, në rishikimin e buxhetit tani në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, t'i shikojë mundësitë që ky Agjencion, tejet i rëndësishëm, të përkrahet në linjë buxhetore dhe të shikohet t'i rritet buxheti në mënyrë që të ndikojë edhe në stimulimin e atyre njerëzve edhe në ngritjen e kapaciteteve. Tek e fundit, kjo është një nga kriteret kryesore të objektivave politike për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, përgjegjësia për buxhet është e Parlamentit. Fjalën e ka Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Vetë mospranimi i shumicës së Kabinetit qeveritar, por edhe i shumicës së deputetëve – flet më së miri se sa ne po i kushtojmë rëndësi dhe se cila është qasja jonë në raport edhe me këtë raport, por në veçanti me fenomenin tashmë të njohur dhe të quajtur korrupsion.

Jam shumë i vetëdijshëm se krijimi i Agjencionit Antikorrupsion në Kosovë i pati rritur shpresat e kosovarëve se më në fund kësaj dukurie që kishte përfshirë të gjitha institucionet e Kosovës do t'i gjendej ilaçi. Gjithsesi, në këtë rast edhe mua nuk më mbetet asgjë tjetër përpos t'i bashkëngjitem korit të gjithë atyre që lavdëruan punën e Agjencionit dhe të “arriturat” e tij.

Mirëpo, në të vërtetë, raportin që sot po e shqyrtojmë flet krejt të kundërtën e asaj që është reale. Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë hequr në krahasim me shkallën e lartë të korrupsionit në Kosovë, andaj me të drejtë do të duhej shtruar pyetjen se cili duhet të jetë veprimi në të ardhmen.

Kujtoj se nuk duhet të jesh shumë i mençur sot për t'u bindur me shkallën e lartë të korrupsionit dhe kam bindjen se, shumë më mirë se secila agjenci në Kosovë e edhe se kjo Agjenci, secili qytetar i Kosovës për çdo ditë e sheh dhe po e prekë korrupsioni.

Ajo që më së shumti më bën përshtypje, është se me asnjë fjalë, e as raporti i Agjencionit, nuk e përmend çështjen e vendosjes së institucioneve shtetërore nëpër ndërtesa private, pa leje ndërtimi dhe natyrisht të ndërtuara kryesisht me korrupsion dhe me interes për dikë.

Kjo gjë tashmë dihet dhe nuk ka se si t'i thuhet ndryshe ku në vend se të merren masa ligjore ndaj tyre, ato ose përrurohen nga ana e zyrtarëve të lartë, ose vendosen institucionet e larta të shtetit me qira në to.

Ku mbetet pastaj në këtë mes privatizimi, që të gjithë ne e dimë se si ka shkuar dhe sa ka qenë aktiv kjo Agjenci në këtë çështje. Tenderët, që me të drejtë edhe nga mediat edhe nga opinioni janë quajtur si “tenderomani”, të gjithë ne e dimë se cila rrugë është dashur të shfrytëzohet për t'u fituar. E vlen ta shikoni se kush ka financuar fushatën e partive politike në tri palë zgjedhjet dhe të bëni krahasim me kompani të cilat kanë fituar tenderët nga ministritë përkatëse, varësisht se cila parti ka qenë në krye të asaj ministrie.

Të nderuar kolegë, habit fakti kur ky institucion kaq lehtë e kalon këtë raport në raport me korrupsionin në të gjitha segmentet e jetës në Kosovë, e cila jetën e varfër të qytetarit të Kosovës po e bën edhe më të varfër, cila është shkalla e korrupsionit në shëndetësi, në gjyqësi, në dogana, në polici, në shërbime publike, madje edhe në vetë këtë institucion që ka qenë dhe vazhdon të jetë objekt i hetimeve. Të mos flas për KEK-un, PTK-në dhe Aeroportin, të cilën gjë ne të gjithë e dimë.

Seriozisht, edhe ne këtu që po flasim, e dimë shumë mirë se gjendja është më tepër se alarmante. Vlen të lexohen raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe statistikat e përditshme të Shërbimit Policor të Kosovës të cilat flasin për arrestimet e zyrtarëve të ndryshëm për korrupsion. Do të duhej pra trajtuar si të tilla, kur ato flasin për shkallë të lartë të veprimeve korruptive.

Sikur çdo qytetar i Kosovës, edhe unë jam shumë i rezervuar nëse ekziston vullneti politik për ta luftuar këtë të keqe që po na e zë frymën.

Pas këtyre fjalëve të mira tona sot, besoj se secili qytetar i Kosovës do ta ndjej veten më të lirë dhe më të gëzueshëm, se “Kosova nuk paska problem me korrupsionin dhe se ai për ne është i huaj dhe i panjohur”. Faleminderit shumë për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur të kemi parasysh kompetencat që ia jep ligji Agjencisë Antikorrupsion. Jo të gjithë këtë hapësirë, që nganjëherë thuhet është fushëveprimtari që e përfshin Agjencinë. Do të thotë, Agjencioni është diçka më i kufizuar, prandaj mendoj se është mirë të konsultohen ligjet në fuqi. Fjalën e ka Gani Buçinca. Meqë, si duket, nuk është këtu, atëherë fjalën e merr deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Pozdravljam sve prisutne! Hvala na datu reč!

Kada je u pitanju ova Agencija za antaikorupciju, ja mislim da je pravo vreme bilo možda i vreme od pre godinu dana, kada je ova Agencija osnovana. Da smo svi sa tom Agencijom paralelno radili, mi bi danas imali velike uspehe.

Čuli smo iz izveštaja da je i sama Agencija imala velike uspehe i moramo da je pohvalimo, ali moramo da znamo da je ova Agencija odgovorna Skupštini i bez rada i bez našeg doprinosa ta Agencija neće moći da funkcioniše ovde na Kosovu. Ma koliko

mi opisivali situaciju kakva je po javnim preduzećima, kakva je na carini, kakva je u svakom našem nivou – da li je to centralni ili lokalni nivo, mi svoj doprinos mora da damo tamo gde se nalazimo.

Ja danas kažem, pošto znam šta je korupcija, da je korupcija korisna samo pojedincima. Korupcija puni džepove pojedinaca, a ide na štetu naroda i osiromašuje narod a od toga nema niko globalni interes.

Mi strateški moramo da se dobro rasporedimo. Ja danas, kao poslanica, imam jedan konkretan predlog. Kada sam ja u pitanju, pošto sam dugogodišnja radnica KEK-a, moralno i materijalno dajem do znanja da ću maksimalno da pomognem Agenciji da počne da radi u KEK-u, jer krajnje je vreme. Mi znamo da to javno preduzeće nije vršilo transformaciju. Kosovo, do danas, znamo da je imalo privremene institucije. Danas je KEK, kada nismo imali privatizaciju, niti tender, niti ništa u KEK-u – KEK je praktično privatizovan od jednog broja ljudi koji su se obogatili, što tvrdim opet materijalno i moralno i sa ovakvim tvrdnjama i sa ovakvom političkom voljom moramo svi da pristupamo ako hoćemo nešto da promenimo ovde na Kosovu i ako hoćemo da imamo jednu državu koja će imati dobar ekonomski i socijalni program i gde ćemo napuniti budžet naše države. Toliko! Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kjo temë, e cila është shumë e përfolur në Kosovë, në pjesën e opinionit publik po duket se nuk po trajtohet në formën e seriozitetit, ashtu siç kërkohet nga ana e vetë deputetëve.

E kam marrë fjalën për faktin se nga ky raport, padyshim se secili që e trajton me kujdes, nxjerr shqetësime të cilat duhet të vihen në pah. Së pari, është për t'u përshëndetur angazhimet dhe përpjekjet serioze të këtij Agjencioni për ta kryer punën e vet, në bazë të ligjit. Mirëpo, në qoftë se e kemi parasysh dhe e lexojmë ndërmjet rreshtave këtë raport, atëherë vjen në pah dhe në konsideratë se kjo Agjenci ballafaqohet me vështirësi shumë të mëdha. Mirëpo, në anën tjetër, e konfirmon paaftësinë e institucioneve të vendit për ta luftuar këtë dukuri apo këtë fenomen që në shoqërinë kosovare tash ka marrë përmasa, që një deputet këtu e shprehu shumë qartë – ka shtruar metastaza. Në anën tjetër, është për keqardhje se ne, si shoqëri kosovare, në raport ndaj këtij fenomeni, thuaja se kemi krijuar imunitet dhe gjithçka çka flitet për korrupsion, keqpërdorime dhe keqmenaxhim – këtu është bërë diçka shumë relative.

Kur kemi parasysh raportet e organizatave ndërkombëtare, që raportojnë për një shkallë shumë të lartë të informalitetit apo ekonomisë së zezë dhe korrupsionit, atëherë është diçka alarmuese. Këtu u tha nga shumë deputetë se pa një mbështetje të madhe, pa një punë sistematike dhe strukturore të institucioneve të vendit, është vështirë të presim rezultate të dëshiruara për të cilët shumë po përfillet.

Është shprehur në këtë raport mungesa e kooperativitetit me organet e gjyqësisë, prokurorisë, që shihet se është evidente. Këtu, kur nevojitet më së shumti një mbështetje politike këtij institucioni dhe kur më së shumti nevojitet një qasje më serioze, ta kemi parasysh se Qeveria e Kosovës, nga fillimi në punën e saj ka shprehur një politikë mjaft agresive me moton – luftën ndaj korrupsionit dhe zero tolerancë. Mirëpo, si duket kohëve të fundit, ky agresivitet apo kjo qasje agresive ndaj këtij fenomeni, ka ra në zbehje, prandaj këtu shihet se nevojitet një qasje që të mbahet në intensitet puna dhe angazhimi institucional karshi kësaj dukurie.

Në anën tjetër, flitet shumë për dëmtimet të cilat janë bërë në këtë raport. Shifrat 30 milionëshe për vitin 2007, që janë shifra të identifikuara nga ana e Agjencionit e mos të flasim për pjesë tjera për të cilat nuk ka pasur informatë apo nuk ka pasur një qasje që të kemi një transparencë apo të kemi thjeshtë një punë e cila do të qite në pah për krejt këto keqpërdorime apo efekte të cilat janë shfaqur.

Dhe, në anën tjetër, kujtoj se ky raport është shumë modest. Pse është modest? Ne jemi dëshmitarë të asaj që shumë media vendore, të shkruara dhe elektronike, në mënyrë shumë transparente dhe me faktografi kanë bërë të qartë për aktet e korrupsionit të cilat janë shfaqur në shumë institucione. Mirëpo, në anën tjetër, nuk kemi asnjë veprim konkret, i cili do të sinjalizonte se me të vërtetë në Kosovë po afrohet një qasje serioze në luftim të kësaj dukurie.

Prandaj, ato që i thanë deputetët deri më tash dhe shprehën si drojë në kontekstin që të ndihmohet kjo Agjenci në të gjitha format për ta kryer punën e vet, do t'ia kisha shtuar edhe këtë se, në qoftë se mungon një qasje sistematike, mungon një qasje gjithëpërfshirëse institucionale, atëherë rezultatet të cilat të gjithë po i presim – do të jenë larg dëshirës sonë. Prandaj, këtu mbetet vetëm të konfirmohet angazhimi i të gjithë ne që po e shprehim sot që të ndihmohet kjo Agjenci dhe të arrihen rezultatet të cilat, të paktën po i presim ne dhe së paku opinionin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dola me qëllim sepse jemi lodhur duke i pritur deputetët tjerë dhe Qeverinë a mos po vinë ta plotësojnë kuorumin, por thashë edhe ta them atë çka mund të them dhe ta përfundojmë këtë seancë.

I nderuari, zotëri ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, kur po shqyrtojmë Raportin e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, në jetën tonë të përditshme fjala korrupsion po përdoret aq shumë sa që tash tingëllon edhe si emërtim simpatik, edhe pse kuptimi i saj i mirëfilltë në thelb do të thotë: prishje, ndyrje, fëlliqe, qelbim.

Sidoqoftë, korrupsioni, edhe në këtë raport, të paraqitur nga Agjencia Antikorrupsion, me keqardhje duhet ta pranojmë se ekziston edhe këtu, te ne.

Prandaj, nuk duhet të lejojmë që Kosova, si vend i quajtur – në tranzicion apo në mungesë të institucioneve të efektshme, me probleme sociale, që korrupsioni të lulëzojë në të gjitha zërat e jetës dhe të bëhet pengesë serioze për zhvillimin e vendit.

Askush nuk mund të deklarojë mundësinë e fitores në këtë luftë të vështirë dhe komplekse, të filluar edhe tani me ligj nga Agjencioni Antikorrupsion, nëse kjo nuk bëhet detyrë primare e Qeverisë, subjekteve politike, deputetëve, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, sindikatave, qytetarëve të zakonshëm – pra të gjithë shoqërisë së vendit tonë.

Ne kemi shumë raste, në të kaluarën, të korrupsionit në Kosovë edhe nga vendorët edhe nga ndërkombëtarët. Ju kujtohen shumë raste të tilla. Ndoshta pa të keq ose me të keq, e merr një shembull nga Xho Trashler që u përvetësuan 4.5 milion sa çel e mbyll sytë.

Veç kësaj, korrupsioni ka prekur rënd edhe sistemet tjera jetike në Kosovë, siç janë, për shembull, arsimi dhe shëndetësia. Korrupsioni është gjithëpërfshirës - edhe nëpër shkolla, sidomos në universitet ka profesor që marrin të holla për nota dhe ka të tjerë që për 50 euro iu punojnë nxënësve edhe tema të diplomave. Ndërkaq, shumë fakultete tash, disa herë u ka dalë nami i zi për korrupsion në provime, e sidomos gjatë procedurave të pranimit në fakultete.

Në administratën lokale, korrupsioni përfshin jo pak struktura – entin urbanistik, kadastrën, ndërmarrjet publike dhe institucione tash krejt të përballura me fjalën – tender.

Një aspekt tjetër i korrupsionit apo i plaçkitjes në Kosovë, është vjelja e obligimeve të ndryshme të taksave. Ta zëmë, te faturat për rrymën, ujin ose telefonin ato në shumë raste mund të jenë katërfishi i obligimit real që ka qytetari të paguajë. Ankimet për këso raste të faturave dhe fryrjet e këtyre faturave zakonisht përfundojnë në shportat e mëdha të administratës së këtyre institucioneve.

Në vendin tonë, prej gati 9 vitesh, shiten me mijëra ton cigare në vit. Pjesa më e madhe pa akciza dhe dogana. Po kështu ndodh me naftën, me benzinën. Ky biznes, që ka dëmtuar rënd buxhetin e vendit, është fusha ku më së miri kanë bashkëpunuar vendorët – ndërkombëtarët – politikanët. Përplot emra të njohur të politikës dhe të biznesit kosovar, sot janë të përfshirë në këto afera të biznesit të cigares.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve, të tokave, të ndërtesave – është edhe një sfidë e madhe tjetër për ju zotëri drejtor i Agjencisë dhe Agjencia të cilën ju e udhëhiqni.

Nuk duhet t'i mbyllim sytë as ne, as Agjencioni, sepse sot korrupsioni është sistemuar në jetën e përditshme edhe të institucioneve publike dhe ato private.

U kuptuam se kemi nevojë për reformim të gjyqësisë dhe të policisë, por duhet të ketë edhe një bashkërendim të punëve në mes të Agjencionit, për shembull, me Auditorin gjeneral. Ne tani presim një raport tjetër, i cili shumë dallon nga ky raport ku ka me mijëra tenderë të keqpërdorur dhe të paraqitur në atë raport.

Prandaj, përkrahja për këtë institucion duhet të jetë më e veçantë dhe jo vetëm simbolike me fjalë.

Do ta përmbyll me një citat të paraqitur në një spot televiziv nga Kombet e Bashkuara: “me korrupsionin të gjithë paguajmë”. Pra, nga kjo del se kundër korrupsionit duhet të përfshihemi të gjithë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë e kam humbur pak dëshirën të flas për këtë temë, për shkak të pritjes – pritjes, por do t’i them disa fjalë.

Mendoj se edhe tema është e atillë që ndoshta s’kemi qenë aq serioz ndaj këtij problemi, prandaj e përsëritës ministrin që është këtu prej fillimi, zotin Mahir dhe mendoj se kjo temë kërkon një shqyrtim pak më serioz.

Agjencioni ka marrë vlerësime pozitive prej të gjithëve dhe unë mendoj se raportin, të cilin e kanë bërë, e kanë bërë që ta kuptojmë edhe gjendjen, ku ka edhe shifra. Prandaj, pos bazës, që është infrastruktura ligjore për të luftuar kundër korrupsionit dhe themelimit të Agjencionit, në opinionin tonë, jo vetëm prej njerëzve të rëndomtë, por edhe prej funksionarëve - mendohet se e kemi kryer punën.

Përveç prej raportit, i cili është sot këtu para nesh, ne kemi mund ta kuptojmë gjendjen në këtë lëmi edhe përmes raporteve tjera që i kanë bërë organizatat joqeveritare, institucionet dhe fondacionet tjera. Për çfarëdo hulumtimi, që bëhet për dukuri negative sidomos, korrupsioni është në nivelin shumë të lartë. Prandaj, mendoj se nuk merren parasysh ato hulumtime, kurse duhet, sepse janë identifikuar edhe vendet, duke filluar prej mjekësisë, gjyqësisë, institucioneve, KEK-ut dhe, sikur që përmenden këtu, edhe fusha të tjera.

Ajo që mua më shqetëson më së shumti, është se mendojmë që ligjet i aprovuam, ekziston agjencia dhe me kaq është përfunduar. Faktikisht, duhet të fillohet që tash. Mendoj se pak është punuar në vetëdijesimin e opinionit dhe është obligim i të gjithëve që të japim kontributin në zbulimin e këtyre dukurive negative. Preokupimi im më i madh është papërgjegjësia institucionale e atyre që duhet të merren me këtë. Prej Agjencionit në raport kemi edhe disa paraqitje dhe ndaj kujt janë paraqitur, por po mendoj përgjegjësia edhe e prokurorisë, e gjyqësisë dhe e të tjerëve, duhet të jetë në nivel më të lartë.

Unë mendoj se jo vetëm për këtë ligj që e kemi në lidhje me luftën kundër korrupsionit, por në tërësi duhet të bëjmë pyetje – ku është fuqia e ligjit dhe a ekziston një fuqi tjetër e cila është më e madhe se ligji. Kur është fenomeni i korrupsionit në pyetje, unë mendoj se ekzistojnë edhe fuqi tjera, qoftë të grupit ose të individëve se si mund t’i shpjegojmë

veprimet e ndërtimeve të cilat s'ka kush që i ndalë. Bash dhe kam parë një vend të qetë, një lagje të qetë, me shtëpi njëkatëshe, e në mes të tyre një objekt tetëkatëshe. Prandaj, vetë rasti që dikush e ka dhënë pëlqimin për këtë ndërtim dhe që s'i plotëson kushtet teknike, tregon se aty diçka ka, dikush e ka lejuar dhe me siguri në mënyrë jo të rregullt.

Pastaj, këtu përmendim prokurimin, tenderët, por unë mendoj se askush nuk e merr seriozisht ta shqyrtojë sistemin e prokurimit. Unë mendoj se në sistemin e prokurimit diçka nuk është në rregull, e ndoshta dikujt i konvenon, por aty ka shumë konflikte interesash. Unë s'po dua ta përmendi lëmin të cilën unë e njoh mirë, që duhet të jetë ndaras mbikëqyrja, implementimi dhe financimi. Te ne, këto çështje janë të përziera.

Pra, unë jam për ta përkrahur Agjencinë dhe veprimtarinë e saj që të krijohen kushte më të mira për punën e saj, por gjithashtu duhet të bëhet shumë edhe për edukimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve, që është përgjegjësi e jonë nëse dom ta krijojmë shtetin e këtë e kemi filluar dhe bashkëngjitja jonë Bashkësisë Evropiane është e vështirë në qoftë se e lëmë korrupsionin ta kaplojë shoqërinë tonë.

Ajo, që mua po ashtu më shqetëson, është mbrojtja institucionale e atyre që paraqesin korrupsion. Unë mendoj se në këtë shoqërinë tonë nuk ekziston mbrojtje e njeriut, mbrojtja e grupit, sepse institucionet nuk i kanë veprimet e përgjegjshme. Faleminderit, se po shoh se nuk është interesimi për të dëgjuar!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Hydajet Hyseni – Kaloshi. Le të përgatitet Rita Hajzeraj.

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Pakoja e ligjeve të Ahtisarit nuk e përmban dhe nuk e përfshin këtë ligj, për fat të mirë, dhe ne sot mund të diskutojmë për të. Do të ishte mirë ta kishim këtë mundësi edhe për ligjet e tjera.

Unë e përshëndes praktikën e re që po e instalojmë që Agjencioni Kundër Korrupsionit të raportojë në Kuvend dhe meqë është raporti i parë, as që ka mund të pritet ndoshta aq sa kemi dëshiruar. Do të më pëlqente edhe mua ta lavdëroj më shumë raportin dhe do të dëshiroja që ai të ishte i tillë, por – thënë sinqerisht – kam pritur më shumë. S'kam pritur tepër, por diçka më shumë kam pritur.

Nuk më duket e mjaftueshme nëse një raport, që përfshin një materie aq të rëndësishme, mbushë faqet me takimet, monitorimin e mediave e tjera, madje pa specifikuar çka kanë pasur ato shkrime në media.

Megjithatë, më shqetëson një përfundim dhe një përshtypje që del edhe nga raporti, mbase edhe nga debati.

Duket sikur Agjencioni e ka kryer punën për mrekulli dhe kjo u tha shumë herë. Auditi po ashtu e bën punën për mrekulli, prokuroria po, qeveria po dhe askush s’e konteston seriozisht. Atëherë, gjithçka është në rregull, kurse korrupsioni megjithatë lulëzon!

Po të shikojmë disponimin e qytetarëve, po të dëgjojmë përfaqësuesit e biznesit – do të dëgjoni shpesh kontastimin: na mbyti korrupsioni, na mbytën tenderët, bordet, prokurimi. Është droja sikur është krijuar një kostelacion vërtet tepër i rrezikshëm.

Pa mohuar efektet pozitive, që ka pasur starti i suksesshëm dhe premtues i Qeverisë, të cilin unë dua ta nënvizoj edhe si obligim për të vazhduar atë kurs me dinamikë jo të zvogëluar, megjithatë Agjencia do të duhej të luante rol më të rëndësishëm, më të ndjeshëm në këtë hapësirë. Agjencioni nuk do të duhej të merrej me raste periferike, siç ishte ajo edhe në vitin e kaluar edhe sivjet, në radhë të parë me faktin se cili deputet ka qenë pedant për ta mbushur një formular në datën e dhënë dhe është konsideruar se me kaq mbaroi puna, duke damkosur mandej ndonjëherë pa asnjë të drejtë deputetët që vetëm ndonjë muaj më parë kishin mbushur dhe dhënë të gjitha të dhënat për pasurinë e tyre, kurse është heshtur pastaj se çka po ndodhë me makrot, me ata peshkaqenët e mëdhenj – ku luhet me miliona tjera. Është shumë e rrezikshme kjo mjegullnajë për të orientuar vëmendjen nganjëherë te rastet që janë vërtet kurrgjë dhe për të mbuluar problemet – sindromet e mëdha.

Për shembull, nuk u tha këtu, kurse në opinion flitet se ka pasur influenza serioze edhe në ngulfatjen e funksionimit të Agjencionit Kundër Korrupsionit. A është e vërtetë? Nëse është e vërtet, pse nuk thuhet. Cili është raporti midis Agjencionit dhe Këshillit kundër korrupsionit? Po Këshilli kundër korrupsionit a ka ndonjë përgjegjësi? Edhe atë e kemi zgjedhur ne dhe e kemi zgjedhur jo vetëm sa për sy e faqe. Pastaj, Agjencinë e ka zgjedhur ky Kuvend. Nëse Agjencia ka pasur vështirësi për të informuar opinionin – a ka mund ta informojë më shumë Kuvendin – Komisionin përkatës? Dhe aty, megjithatë, të dihet e vërteta. Nëse flitet për keqpërdorime të mëdha, për miliona, pse të mos thuhet me emër dhe hapur, ku janë, ku kanë qenë.

Duhet një transparencë e madhe. Së paku në nivelin që ka Top-Channel. Një media në Shqipëri ka bërë më shumë se sa shumë institucione. Ne, për fat të keq, nuk e kemi asnjë medium të tillë. Mediat tona, vazhdojnë të merren nganjëherë me gjëra banale: se “deputetët paskan përfituar shumë, se do “llap-topa” që iu janë dhënë në shërbim para dy vitesh u qenka vazhduar mundësia që t’i përdorin” - deputetët që s’kanë zyre, s’kanë kushte elementare për të punuar, dhe nuk merren me ata që gëlltisnin, si të thuash, magazina të tëra me kompjuterë e me gjithë pronarë, ndonjëherë, e tjera.

Është e pashmangshme të bisedohet për relacionin Agjencioni – Prokuroria. Por, mendoj s’mund të kalohet edhe aq lehtë fakti që është përmendur në raport. Agjencioni ia prezanton 5 raste Prokurorisë së Prizrenit, prej tyre 4 refuzohen. Te unë krijohet dilemë e madhe, çka ka ndodhur aty? Nëse Agjencioni i ka dorëzuar parashtrësia të pabazuara, duhet përgjegjësi për të. Nëse ato kanë qenë të bazuara dhe i janë kthyer, dikush duhet të përgjigjet.

Çka po ndodhë me gjyqësinë tonë, zonja e zotërinj – me prokurorinë tonë? Jo vetëm se është krijuar mundësia që të jetë një gjyqësi dhe prokurori e varur në fakt dhe e pavarur nga institucionet, që është varianti më i rrezikshëm i mundshëm, po krijohet tash mundësia, unë e thashë pak si me shaka atë pakon e Ahtisarit, po pikërisht me Pakon e Ahtisarit po krijohet mundësia që të deformohet edhe më shumë funksionimi i gjyqësisë. Me linjat etnike të zgjedhjes dhe të përfaqësimit në organet më të larta të gjyqësisë, pasojat do të jenë të rënda. Po pamundësohet sistemi, për të cilin është punuar vite të tëra nga partnerët tanë, edhe nga USAID-i Amerikan dhe Zyra Amerikane për procesin e transformimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe gjyqësisë e prokurorisë dhe mundësimi i transformimit në këto fusha – të drejtësisë tranzicioinale dhe të verifikimit, proces të cilin e kanë kryer të gjitha vendet në regjion – në tranzicion. Kosova, në njëfarë mënyre, po bën përpjekje për të ikur prej këtij procesi të domosdoshëm. Pasojat do t'i paguajnë qytetarët.

Unë mendoj se ky Kuvend duhet të kërkojë jo vetëm prej të tjerëve përgjegjësi. Duhet edhe të angazhohej në agjenci se ka njerëz me kapital politik dhe me guxim intelektual që kanë guximin dhe përgjegjësinë për t'u konfrontuar edhe me makrot e korrupsionit. Por, edhe Kuvendi s' duhet të amnistojë vetveten, por duhet të marrë rolin e faktorit vendimtar që do t'iu bëjë apel qytetarëve dhe të gjejë format dhe instrumentet që e vërteta të dalë në shesh dhe betejën kundër korrupsionit ta konsiderojmë si betejë të rëndësishme politike kombëtare – vendimtare edhe për të ardhmen e Kosovës dhe shtetësisë së saj. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Po unë jam i obliguar të them se Parlamenti e ka rolin e legjislativit dhe nuk merr as rolin e pushtetit ekzekutiv, as të gjyqësorit. Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, le të bëhet gati për fjalë deputeti Emrush Xhemajli.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Me shumë kujdes u përpoqa t'i përcjell prononcimet e kolegëve të mi rreth raportit vjetor të Agjencisë Antikorrupsion.

Është interesant të thuhet se kishte inflacion deklarimesh që herë e turrnin e herë e stërgjasnin esencën e gangrenës në institucionet e Kosovës, e ky është korrupsioni institucional.

Ju po e kuptoni se unë e deklarova korrupsionin institucional, e kjo do të thotë se korrupsioni është kthyer në sistem në institucionet tona. Pra, ai ka gjetur hapësira komode brenda institucioneve dhe jo ligjërisht është bërë ligji më i fuqishëm brenda institucioneve. Është interesant që këtu të shohësh njerëz se si i qasen këtij raporti vjetor. Bëhet fjalë për vitin e kaluar dhe për një qeveri tjetër nga kjo e sotmja.

Pavarësisht nga këto pozicione, trajtohet edhe raporti nga ana e deputetëve. Problemi është shumë i thjeshtë. Korrupsion nuk po ndodhë në Hënë, ai burimin e ka këtu, brenda këtij kompleksi ku ndodhemi ne dhe Qeveria e Kosovës.

E them këtë nga bindja se çdo gjë që lidhet me paranë, pra mundësitë fillojnë këtu dhe realizohen brenda këtij kompleksi. Këtë mund ta vërtetoni sa po të kaloni në anën tjetër të rrugës dhe të pyesni qytetarët dhe imagjinoni rëndësinë dhe efektivitetin e punës së një Agjencioni Antikorrupsion përball këtij kompleksi ku ne ndodhemi.

E them përfundimisht se, korrupsioni ndodhet në qelizën e çdo shkalle të institucioneve dhe këtë gangrenë mund ta luftojnë vetëm ata që s'janë pjesë e saj, që janë ballëhapur dhe që kanë kapital kombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Emrush Xhemajli, le të bëhet gati Esat Brajshori.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Përsëritje të gjithëve!

Këtu, pas gjithë kësaj çka u tha, unë do të veçoj vetëm disa gjëra që i kam vërejtur në raport. Me dy fjalë, raporti është punuar me shumë pedanteri, por ka pasqyruar një punë të kufizuar për shkak të kushteve të vështira në të cilat ka punuar.

Si Agjenci kryesore për luftimin e korrupsionit, duhet të ketë kushte të punës. Në raport konstatohet se Agjencioni Antikorrupsion është në një objekt ku ruhet nga një kompani private. Unë tash nuk po e kontestoj rregullsinë e kësaj kompanie private, e cila e ruan agjencinë. Ajo mund të jetë shumë e mirë, por nuk mundet një agjenci, që kryen një punë shumë të ndjeshme, të ruhet nga kompanitë private. Kjo duhet të ruhet nga Shërbimi Policor i Kosovës ose të përfshihet deri sa të gjendet një zgjidhje për objektin dhe të bie në kuadër të Kosovës, në një objekt ku është i akomoduar mirë dhe i ruajtur mirë.

E dyta, u tha këtu dhe është shumë e vërtetë që personeli është i paguar dobët dhe ka ndoshta një lloj arsyeje për ankesat që i ka bërë kryetari i Agjencisë për ikje nga ky institucion i kuadrit.

Rasti më i interesant është se kjo Agjenci e ka hetuar KEK-un. Tash me kalimin e kohës, duke e hetuar, është zbuluar se në KEK janë rrogat më të mira dhe një prej këtyre kuadrove ka shkuar e ka ikë në KEK. Merreni, lexojeni raportin dhe del kështu. Prandaj, duhet të bëhet çmos që të ndërrojë ky raport i stimulimit të kuadrit për punë efektive.

Ndërkaq, hallka më e dobët në krejt sistemin tonë ka dalë edhe prej këtij raporti se është sistemi i drejtësisë përkatësisht prokuroritë dhe gjykatat. Ju e keni parë rastin tepër skandaloz. Prokuroritë dhe gjykatat rastet tjera i kanë anashkaluar, ndërkaq në raport, del se si iu kanë përgjigjur agjencisë vetëm për ato raste që kanë të bëjnë me gjykatat dhe me prokuroritë. Po ky është skandal i llojit të vet, që thotë gjithçka se si e kemi punën ne në fushën e drejtësisë, në fushën e prokurorisë dhe të gjyqësisë, sidomos.

Kështu që, mbetet shumë për t'u bërë dhe unë them se edhe pse është një Agjencia e re është munduar të punojë, prandaj duhet t'i krijojmë kushte në segmente që i mbulojmë që të jetë i suksesshëm në luftimin e një plage të shëmtuar në shoqëri – korrupsionit. Ju falënderoj edhe një herë!

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët të kthehen në sallë. Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori, le të bëhet gati për fjalë deputeti i fundit që e ka kërkuar fjalën Gani Buçinca.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritës ministrin prezent, përsëritës kolegët,

E di se janë të lodhur dhe kjo lodhje vjen si rezultat i vetë, pa keqkuptime, përgjegjësisë së deputetëve për ta trajtuar këtë materie shumë të rëndësishme, këtë punë shumë të rëndësishme të Agjencionit Antikorrupsion.

Më bëri përshtypje se si ky Kuvend i është qasur analizës së raportit të Agjencionit Antikorrupsion për vitin 2007. Lehtësisht thuhet se korrupsioni e ka ngulfatur shoqërinë tonë dhe askush nuk skuqet për këtë, edhe pse kjo ndodh këtu, në shoqërinë tonë, por edhe nga fakti tjetër se shumica e kolegëve të mi – deputetë më tepër janë të përqendruar të shohin njëri-tjetrin duke hyrë e dalë, duke bërë sfilata koti se sa të përqendrohen në materien në të cilën duket se Agjencioni Antikorrupsion ka punuar shumë.

Pra flitet dhe debatohet për një çështje sikur është në periferi të shoqërisë sonë e nuk është mu në embrion të saj për korrupsionin që ka prekur çdo pore të shoqërisë, ashtu, sikur që tha dikush këtu, që është kthyer në sistem veprues.

Agjencia Antikorrupsion ka bërë punë aq sa ka bërë, por për mua është me rëndësi të di se sa është i kontrolluar nga politika e ditës qoftë dje, qoftë sot, kur dihet se njerëzit më të korruptuar janë njerëzit e veshur me pushtet. A mund të jetë e pavarur kjo Agjenci nëse kontrollohet nga politika? Ja, që ta zëmë se, këto fakte që i ka ofruar Agjencioni Antikorrupsion janë fakte të padiskutueshme, atëherë kush u dënua për korrupsion dhe këtu e kam fjalën për “peshqit e mëdhenj” normal, për njerëzit e politikës.

U fol këtu se mediat duhet të bëjnë më tepër në drejtim të zbulimit të korrupsionit që ndodh në shoqërinë tonë dhe kjo është interesante. Mirë, mediat duhet ta bëjnë punën e tyre dhe mendoj që në një përmasë ato janë duke e bërë. Po, pse duhet hidhet topi gjetiu kur, është pikërisht ky Kuvend që duhet të kontrollojë zbatimin e ligjeve dhe implementimin e tyre. Tjetër gjë është se a mund të luftohet korrupsioni nga vetë njerëzit e korruptuar, siç janë, në raste të tilla gjykatat dhe prokuroritë për të cilat Agjencioni Antikorrupsion ka sjellë shumë fakte. Faleminderit për vëmendjen, e di se jeni të lodhur!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka folësi i fundit për sot, prej deputetëve, Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti Kryetar,

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

E kam humbur radhën, jo me fajin tim, por për shkak të neglizhencës dhe për shkak të dobësive në organizimin e kësaj seance. Megjithatë, edhe në jetë gjithmonë jam vonuar edhe pse trenin e fundit e kam zënë, por gjithmonë të klasës së parë!

Kështu, me ju thënë të drejtën, më erdhi mirë që isha vonuar se i dëgjova edhe disa “perla” këtu, në kuptimin negativ të fjalës dhe më nxitën e më motivuan edhe më shumë për të diskutuar.

Unë, që në fillim mund të them se raportin e Agjencionit do ta mbështes për faktin se, duke u bazuar në kohën kur është formuar, kushtet në të cilat ka vepruar, stafin të cilin e ka pasur në dispozicion, mendoj që është një raport i mirë dhe Agjencioni e ka bërë një punë të mirë. Ka bërë një punë të mirë dhe do ta mbështes edhe për faktin se nuk duhet të kemi iluzione se luftën ndaj korrupsionit do ta fitojë Agjencioni Antikorrupsion.

Lufta ndaj korrupsionit është një luftë e cila do të kërkojë shumë energji nga shumë institucione të Kosovës dhe duhet të bëhet një luftë komplementare ndërmjet të gjitha institucioneve të Kosovës.

Korrupsioni si fenomen është prezent edhe në Bruksel, edhe në Uashington, por edhe në këtë Ballkanin tonë, i cili shpesh anatemohehet dhe merret për të keq nga institucionet evropiane. Në një masë të mirë, korrupsionin në Kosovë, pas luftës, e kanë nxitur edhe vetë ish-zyrtarët e administratës ndërkombëtare në bashkëpunim me zyrtarët vendorë. Në këtë drejtim, ne nuk duhet të jemi përjashtim.

Këtu u fol pak për fenomenin e korrupsionit, u fol pak gjatë këtyre debateve. Fenomeni i korrupsionit nuk është fenomen nacional, por është social. Dhe, në këtë kuptim, edhe ne shqiptarët, nuk jemi imun ndaj këtij fenomeni shoqëror. Ky fenomen paraqitet në ato shoqëri ku ekziston varfëria dhe ku është pak prezent shteti me institucione të veta.

Ju të gjithë e dini se të gjitha shtetet e Lindjes gjatë periudhës së tranzicionit i ka përcjellë fenomeni i korrupsionit. Edhe ne, si shoqëri, jemi në një proces të tranzicionit, në një periudhë të tranzicionit, siç e tha edhe profesori i nderuar, zoti Ibrahim, dhe nuk jemi asnjë përjashtim në këtë drejtim.

Mirëpo, përveç procesit të tranzicionit, që e kalojmë ne si shoqëri, ne jemi edhe një shoqëri post-konfliktuale, mjaft e traumatizuar dhe një shoqëri në thelb e varfër dhe një shoqëri ndaj të cilës shkelen të drejtat elementare njerëzore në mënyrë gjenerale. Sidomos gjatë kësaj periudhe pas lufte, janë shkelur të drejtat sociale dhe e drejta në pronë. Duke u shkelur të drejtat sociale në Kosovë të qytetarët e Kosovës, pa përjashtim, dhe duke u shkelur e drejta në pronë e qytetarëve të Kosovës, është krijuar një pasiguri e madhe të qytetarët dhe kjo pasiguri ka qenë edhe shkas për krijimin e një morali të ri shoqëror që plaçkitja është shkathtësi, është virtyt e jo një vlerë, për shkaqe të sigurisë. Dhe, ky është një fenomen që është duke na përcjellë dhe do të na përcjellë edhe në të ardhmen.

Një prej fenomeneve që nxit korrupsionin në Kosovë, padyshim, janë edhe pagat e ulëta. Pagat janë stimuluese për një ndershmëri në punë. Këtë fenomen ne duhet ta trajtojmë në mënyrë komplementare. Duhet të ndalet evazioni fiskal i brendshëm dhe i jashtëm, duhet të rritet buxheti i Kosovës dhe të punojmë me seriozitet për ngritjen e nivelit të

pagave në mënyrë që baza psikologjike dhe pasiguria sociale të jenë prej faktorëve që e nxisin fenomenin e korrupsionit.

Një prej arsyeve tjera që ky fenomen lulëzon në shoqërinë kosovare, është edhe mostransparenca në institucionet edhe politike, edhe në institucionet publike.

Për mostransparencë dhe mospërgjegjësi në punë, për mosdhënien e llogarive për drejtuesit dhe menaxherët e firmave, po ua jap shembullin konkret. Tri autobote me material të rrezikshëm kalojnë doganën e Hanit të Elezit dhe deri sot askush nuk thirret në përgjegjësi, askush nuk ulet në pozitë për shkak të përgjegjësisë që kanë kaluar dhe askush nuk dyshon se ato kanë kaluar pikërisht për shkak të fenomenit të korrupsionit.

Fenomenet e tilla, mosdhënia e llogarisë para punëtorëve, para qytetarëve në këto ndërmarrje publike, në asnjë ndërmarrje publike menaxhmenti nuk jep llogari para punëtorëve të vet. Shkeljet më drastike dhe korrupsioni më i madh është në ndërmarrjet publike për arsye se shpërndarja e parave bëhet krejt sipas simpatie, sipas dëshirave, sipas njohtësive, jashtë çdo norme dhe çdo rregulli elementar dhe ka shkelje drastike të të drejtave të njeriut brenda organizatave.

Po ju them se fenomeni i korrupsionit do të jetë prezent edhe më tutje. Një gjë që mund ta theksoj për qeverinë e kaluar është se fenomeni i korrupsionit në Kosovë është favorizuar nga politika e qeverisë që e lamë pas dhe ka pasur mbështetje të fuqishme politike.

Unë shpresoj se në këtë legjislacion ekzekutivi nuk do të ketë mbështetje politike ndaj këtij fenomeni, mirëpo do ta bëjmë ne të gjithë së bashku, edhe me ekzekutivin edhe me Parlamentin detyrën tonë dhe do t'i aktivizojmë gjykatat duke bërë një reformë të thellë në sistemin gjyqësor, t'i largojmë të gjithë ata njerëz, që nuk janë pak, nëpër institucione që janë instaluar gjatë këtyre 8 vjetëve dhe të fillojmë me zbatimin e ligjit dhe duke zbatuar ligjin me përpikëri dhe duke mos i dhënë mbështetje politike fenomenit të korrupsionit, ne me siguri do ta sjellim në atë nivel që sot korrupsioni është në Evropë.

Unë në fund desha të cek se e përshëndes dhe përgëzoj për punën që e ka bërë Agjencioni dhe pikërisht për guximin qytetar që e ka pasur drejtori i Agjencionit dhe për vullnetin e mirë që ka treguar dhe këtë fenomen ta luftojë në kuadër të mundësive të veta. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Gjylnaze, emrin nuk ua ka përmendur, por pasi e kërkonti fjalën, mund ta merrni. Fjalën e ka, për replikë, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

Zoti Kryetar, unë e dëgjova me shumë vëmendje deputetin Buçinca. Ai ka dy përgjegjësi – është publike dhe qytetare. Publike është për fjalën e thënë, që ai e akuzoi qeverinë e kaluar se politika është e përzier në korrupsion. E dyta është, nëse ai ka fakte për këtë, le t'i thotë tani, dhe nëse ka fakte tjera, le t'i çojë, gjithashtu, natyrisht dokumentet përkatëse. Ka përgjegjësi qytetare, sidomos si deputet, t'i dërgojë në prokurori dhe unë e inkurajoj ta bëjë këtë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar për kundër replikë, Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti Kryetar i Parlamentit dhe ju deputetë, Unë jam shumë koshient për përgjegjësinë time edhe si deputet, edhe për fjalën, për përgjegjësinë morale, politike dhe juridike.

Po ripërsëris edhe njëherë. Kreu i Qeverisë së kaluar dhe krejt Qeveria e kaluar e ka amnistuar korrupsionin në Kosovë dhe i ka dhënë mbështetje të fuqishme politike. Për këto deklarata, në rast se ka ndokush tjetër, shihemi në gjykatë.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe njëherë ftoj deputetët që janë jashtë sallës, le të kthehen në sallë, kurse fjalën përfundimtare e ka drejtori i Agjencisë, zoti Preteni.

(Reagime nga deputetët)

Mirë, për replikë, fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Kryetar, nuk e kam ndërmend të replikoj. Deputeti e ka përgjegjësinë e vet. Unë kam qenë zëvendëskryeministër dhe ministër i Pushtetit Lokal. Zoti Buçinca, ti kur i futë krejt me një thes, funksionarët e një kabineti qeveritar, politikanët që kanë ushtruar një detyrë të caktuar, duhet pasur shumë kujdes, sepse fjala e vërtetë publike ka peshën e vet dhe kjo duhet mandej të shkojë deri në fund për të dëshmuar. Unë kam qenë njëri prej atyre që kanë pasur përgjegjësi të madhe publike dhe drejtimi i gishtit tuaj në një kabinet qeveritar pa fakte, por vetëm duke shfrytëzuar pozitën e deputetit në këtë sallë, është keqpërdorim edhe i ulëses edhe i përgjegjësisë që e ke, edhe i titullit që e mban sot. Faleminderit!

Diskutim i bashkangjitur me shkrim

SALA BERISHA SHALA: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit, Anëtarë të Qeverisë, Të nderuar deputetë,

Përveç përgjigjes së obligimit ligjor ndaj Kuvendit, që ka Agjensioni Kundër Korrupsion, e mira e këtij debati rreth raportit në fjale qëndron edhe në atë se qytetarët që e përcjellin këtë debat do të ndjehen paksa më të lehtësuar, me fjalë tjera fitohet një përshtypje pozitive kur në nivelin më të lartë diskutohen çështjet e tilla shqetësuese dhe ngulfatëse për qytetarët, siç është në këtë rast fenomeni „korrupsion”.

Duke e parë këtë fenomen në shume dimensionë si të dëmshëm, si nga aspekti ekonomik, social, politik, etj., shtrohet dilema:

A mundet Kosova të ketë ekonomi të qëndrueshme?

Deri dje kjo pyetje është shtruar shpesh në çështjet e tjera të cilat kanë qenë të ndërlidhura me statusin përfundimtar të vendit. Natyrisht, se kjo ka ndikim direkt në

dinjitetin dhe ne cilësinë e jetës së qytetareve tanë. Mirëpo, sot mendoj se shtrohet pyetje tjetër.

A mundet Kosova ta përballoj „lëngatën” e fenomenit „korrupsion” ?

Kjo është një sfidë për te gjithë, duke filluar nga institucionet qeveritare, joqeveritare e deri tek qytetari me i rëndomtë. Për dallim nga vendet tjera që kane kaluar fazën e tranzicionit, korrupsioni në Kosovës i ka te veçantat e veta.

Mendoj se administrata publike është fushëbeteja prej së cilës varet rezultati i luftës antikorrupsion. Niveli më i lartë i paraqitjes së korrupsionit në Kosovë janë pikërisht ndërmarrjet Publike, të cilat duke qenë vazhdimësi e menaxhimit me logjikë dhe inercion monist, mandej menaxhimi i tyre përmes bordeve të përziera (vendor dhe ndërkombëtar) kanë bërë shpesh që keqpërdorimet të mbeten pa llogaridhënie, sjelljet korruptive të pa adresë. Andaj, në këtë vazhdë , cili do te ishte obligimi ynë si parlament? Mendoj se obligimi ynë parësor është bërja e ligjeve, që duhet te qartësojnë obligimet, kompetencat e përgjegjësitë, siç është p.sh. Ligji për ndërmarrjet publike, apo edhe amandamentimi i ligjeve tjera në fuqi, të cilët gjate interpretimit apo moszbatimi i tyre favorizojnë kushte për korrupsion.

Sipas hulumtimeve të bëra nga mekanizma të ndryshëm, ka dal se institucionet më të korruptuara janë KEK, PTK, Aeroporti,etj, duke u pasuar kështu për shkallë të lartë korrupsioni, edhe nga disa institucione ndërkombëtare siç është UNMIK dhe disa agjensione tjera të lidhura me të.

Korrupsioni nuk është i lidhur vetëm me të ashtuquajtur ryshfet në sektorin publik, ryshfet ne administratë publike ndërkombëtarë, shpërdorim i detyrës zyrtare etj, por ky fenomen është i lidhur shpeshherë edhe me perceptimin e qytetarit se vetëm me ryshfet kryhen shërbimet publike, andaj këtu na del edhe nevoja e vetëdijesimit te qytetarëve siç ishte e parapare dhe e cekur ne raportin e Agjensionit antikorrupsion. Mandej, mungesa e ligjeve, mungesa e Strategjisë antikorrupsion, në të cilën strategji do duhej veç tjerash të parashihen masa që i përgjigjen nivelit të zhvillimit ekonomik, social dhe politik, etj.

Qeveria e Kosovës, duke qenë e vetëdijshme se korrupcioni është kërcënim serioz ndaj zhvillimit të vendeve të varfra siç është Kosova, urgjentisht duhet ta bëj forcimin e shtetit ligjor, ta plotësojë infrastrukturën ligjore, hartimin-zbatimin e Strategjisë antikorrupsion, në të kundërtën përveç tjerash rrezikon ta humb mbështetjen financiare ndërkombëtare.

Të gjitha specifikat që dallojnë korrupsionin në Kosovë, se a do jenë fati apo fatkeqësia, mbetet të shihet. Shpresoj se Kosova do ta marrë kafen e duhur në luftën antikorrupsion. Andaj, secili në obligimin e vet: Parlamenti në bërjen e ligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit te tyre, Qeveria në zbatimin korrekt te ligjeve, përkatësisht ne respektimin e tyre, deri tek vetëdijesimi dhe gatishmëria e qytetarit t'i denoncoje sjelljet korruptive, etj. Nuk ka mundësi te luftohet kjo dukuri vetëm përmes një Agjensionit, sado qe te jete ne nivel ai. Pra, lufta antikorrupsion është SFIDË PËR TE GJITHË!
Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Mendoj se nuk ka fjalë tjetër. Natyrisht, keqpërdorimi i pozitës, edhe ai është korrupsion. Fjalën ia kemi dhënë drejtorit të Agjencionit, zotit Preteni. Urdhëroni, zoti Preteni!

(Ndërhyrje)

Unë, po ua lexoj Rregullën 22 pika 5 nën g): “Në fund të diskutimeve, propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor ka të drejtë të përgjigjet dhe pastaj Kryetari i Kuvendit mbyll diskutimin”.

Zoti Preteni, mund ta merrni fjalën. Urdhëroni!

HASAN PRETENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri Kryetar, zotëri ministër,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni që t’ju falënderoj për përkrahjen dhe ju siguroj se rezultatet e punës së Agjencionit do të jenë në proporcion me mbështetjen tuaj.

Në fillim të prezantimit të raportit, potencova se jam dhe jemi të hapur si Agjencion t’i pranojmë të gjitha kritikën për punën ose mospunën e bërë. Mirëpo, ju kisha lutur që të kuptohet dhe të kursehem nga ajo se nuk mund të përgjigjem për punën, me të cilën, ju nuk më keni ngarkuar, ose ligji nuk më ka ngarkuar.

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit është një organ i administratës, nuk është as polici, as prokurori, as gjyqsor.

Ju siguroj se deri më tani nuk ka pasur asnjë kërcënim nga zyrtarët e lartë për punën e Agjencionit. Flasim për raportin 2007. Në vitin 2008 ka qenë një kërcënim fizik, për të cilin e kemi njoftuar publikun dhe ju siguroj se në çdo moment kur do të kemi kërcënime të tilla, publiku do të informohet. Nuk ka politikë në Agjencion dhe në Komision kam pranuar një kënaqësi shumë të madhe të cilën e kam shprehur për herë të parë para Komisionit për buxhet dhe financa që në momentin kur nga ky Parlament jam zgjedhur për drejtor të Agjencionit më ka gëzuar fakti se për pozicionin dhe zgjedhjen time kanë votuar më shumë se 80% të deputetëve. Më ka dhënë një kurajo shumë të mirë që nuk jam identifikuar me asnjë parti politike as me një grup të partive politike, domethënë as me pozitën, as me opozitën. Një fakt i tillë më gëzon edhe sot sepse në praktikë kemi dhënë prova se nuk jemi të kyçur, nuk jemi të lidhur e nuk do të jemi dhe, derisa të drejtoj unë këtë Agjencion, politika nuk do të jetë e pranishme.

E vetmja mundësi dhe i vetmi kusht që kemi paraparë edhe për punësimin e zyrtarëve në Agjencion janë, përveç përgatitjes profesionale dhe kushteve që kërkohen për vendet e punës, që këta kandidatë duhet të kenë një të kaluar të pastër dhe në anën tjetër nuk duhet të jenë aktivistë të partive.

Agjencioni, rastet i dërgon në prokurorinë, por në rastet, sepse është një disproporcion në mes terminologjisë, e këtu u përmend disa herë korrupsioni se çka nënkuptojmë. Është e

vërtetë se ka një disproporcion, them kushtimisht, në mes asaj se sa përcaktohet me Ligjin e kundër korrupsionit dhe si është i sanksionuar me Kodin penal. Në të gjitha ato raste kur pas hetimeve tona administrative, hetimet tona paraprake vlerësojmë dhe gjejmë në Kodin penal sanksion për këtë veprim, ne e përcjellim në prokurori. Mirëpo, në rastet kur nuk e gjejmë një lidhje kauzale në mes tyre, ne i gjykojmë veprimet në aspektin moral. Nepotizmi nuk është i sanksionuar, por Agjencioni i vlerëson sepse kemi dalë dhe gjithmonë do të dalim, kemi dalë edhe për Shërbimin Policor të Kosovës dhe për disa institucione tjera sepse vlerësojmë se është akti i parë që të vjen deri te korrupsioni dhe e kemi gjykuar vetëm në aspektin moral e nuk kemi mundësi dhe të drejtë t'ia dërgojmë prokurorisë, sepse nuk do ta gjykojnë – me Kod penal nuk është paraparë si veprim penal.

Tjetër, tek zyrtarët e agjencioneve, por edhe te zyrtarët e institucioneve, ofrojmë opinione. Ai parandalimi prej 7 milionësh është si ndërprerje si parandalim i kryerjes së veprimeve korruptive që ka rezultuar, në bazë të asaj që Agjencioni ka pasur elemente, ka pasur informata, kemi ofruar opinion te institucioni i cili e ka publikuar tenderë dhe ka hasur në mirëkuptim. Është ndalë ai veprim korruptiv dhe të gjitha ato raste. Vitin e kaluar kanë qenë 7 milion, tani jo vetëm për 3 muaj, por thashë shumë indikative vetëm brenda 2 javët e fundit, 3 raste janë parandaluar duke i ofruar dhe prezantuar opinionit sepse nuk kemi ekzekutivin dhe nuk mund ta ndërprejmë, por si rezultat të opinionit dhe ofrimit të mendimeve tona, veprimet janë kryer. Kemi raste kur i dorëzojmë në Shërbimin Policor të Kosovës dhe vlerësojmë se negativiteti po ndodh. Nuk mund të presim ta dërgojmë në prokurori, duhet të vepohet menjëherë. Po dëmtohet mali dhe po krijohet një negativitet në vazhdimësi, kemi përcjellë informatën në polici, policia me dinamikën e vet ka qenë shumë më e suksesshme. Kemi raste kur janë përfshirë ndërkombëtarët. Këto informata i kemi përcjellë tek Policia e UNMIK-ut, te Qendra e Inteligjencës Financiare ose te Njësi të vepron ose ka vepruar më herët në kuadër të Guarda di Financës.

Te statistikën, Kosova dhe Agjencioni ka për obligim, konform ligjit që t'i përcjellë të dhëna statistikore institucioneve që e punojnë këtë. Ju siguroj se në Kosovë, që dy vjet e fundit asnjë institucion ndërkombëtar nuk ka bërë sondazhe se a ka korrupsion a jo. Dihet pozicioni dhe kjo është sepse nuk kemi pasur pozicionin e shtetit. Vitin e kaluar, Transintereshënell ka botuar listën prej 180 shteteve që janë testuar se a ka korrupsion në ato shtete a jo, Kosova nuk figuron sepse nuk kemi qenë në pozicionin e shtetit. Jemi krahasuar diku dhe në pozicionin 93 ka qenë Shqipëria. Dihet se NDP-i, USAID-i dhe Riinvesti, të gjitha institucionet punojnë kështu sondazhe të tilla në Kosovë dhe normalisht se dihet që ka korrupsion dhe e përcaktojnë. Raporti i fundit ka qenë, edhe i NDP-i javën e kaluar, mirëpo tek organizata ndërkombëtare është një që është përfolur, kur thotë se Kosova është në vendin e katërt, mirëpo ai është anuluar dhe nuk ka qëndruar një testim i tillë.

Ligjet e reja. Agjencioni tani punon konform Ligjit kundër korrupsionit. Ju, deputetë të nderuar, më 2 nëntor të vitit të kaluar keni aprovuar një ligj për parandalimin e konfliktit të interesit, kurse më 26 prill të këtij viti keni aprovuar Ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë. Deri më tani këto dy lëmi kanë qenë të rregulluara me kaptina të

veçanta në Ligjin kundër korrupsionit. Tani kemi ligje të veçanta. Edhe në këto ligje nuk e di fazën përfundimtare, por me 27 amendamente e di që ka kaluar, mirëpo, rreth transparencës do të ketë elemente edhe tek numri i zyrtarëve që do të obligohen ta deklarojnë pasurinë, por edhe te transparenca, do të thotë, te publikimi i pasurisë që ata e deklarojnë. Me ligjet ekzistuese, ju lutem, të mos kërkohet diçka nga Agjencioni sepse një gjë të tillë nuk e kemi pasur të lejuar, kurse tash ne e kemi punuar dhe pritet procedurë administrative dhe ligjin e miratuar të amendamentuar do ta përcjellim në Qeveri, e cila do të sjellë në Kuvend dhe të gjitha ato elemente ju mund t'i ndryshoni dhe ligji ekzistues–Ligji kundër korrupsionit normalisht që duhet të amendamentohet.

Është thënë këtu edhe një element shumë me rëndësi që momentet kur korrupsioni po fillon të gjykohet ose kur po ka nga ana e policisë ose nga Agjencioni veprime konkrete të burgosjes dhe të masave konkrete, mu atëherë Agjencioni vërshohet nga informatat. Vlerësoj se nuk mungon identifikimi dhe nuk mungojnë informatat për korrupsion, mungon ai akti i fundit – veprimi konkret, sepse të gjithë ne, edhe policia e prokuroria gjithçka të gjithë ne informatat i përcjellim në prokurori.

Dëmet 30 milionë, nuk janë dëme të krijuara 30 milionë. Këtë duhet ta vlerësojë gjykata. Ne 47 informata i kemi vendosur secili çmimin e informatës. 47 informata të përcjella në prokurori kanë peshën 30 milionë, është punë e Gjyqësorit se a do t'i vlerësojë si veprime korruptive apo jo.

De deklarimi i pasurisë, të gjitha informatat në agjencion, ligji na obligon që të jenë konfidenciale. Ne nuk guxojmë t'i publikojmë të dhënat dhe informatat që i kemi në Agjencion, jo gjatë mandatit tonë, por edhe 15 vjet pas përfundimit të mandatit. Kjo është pjesë e ligjit.

Kur informatat bëhen publike? Ne i kemi përcjellë 47 informata në prokurori. Në momentin kur prokuroria fillon hetimin e këtyre, ne atëherë publikojmë – dhe themi se pas këtij rasti ka qëndruar Agjencioni. Do me thënë, informata jo, kjo pjesa e hetimeve po.

Edhe te deklarimi i pasurisë, gjithmonë, nëse nuk kërkohet ndërmarrje e masave, ato deklarime të pasurisë janë publike.

KRYETARI: Zoti Preteni, nëse mundeni, përfundone se u zgjat pak shumë.

HASAN PRETENI: Po, e përfundova, zoti Kryetar. Edhe raportet e auditorëve janë publike. Është punë e prokurorisë të ndërmarrë masa. 165 shkrime në media të shkruara kanë qenë vitin e kaluar, prapë është punë e prokurorisë.

Të nderuar deputetë,

Asnjë informatë, ju siguroj, për korrupsion që arrinë në Agjencion, nuk do të mbetet në Agjencion por do të marrë epilogun. I inkurajoj të gjithë ata që kanë informata për korrupsion që mos të hezitojnë të bashkëpunojnë e të na kontaktojnë. Ne do të punojmë edhe me përbërjen e këtij Parlamenti kemi informata, kemi zyrtarë të cilët e kanë

informuar Agjencionin dhe në fillim të këtij viti, si rezultat i një informate nga një deputet i Kuvendit të Kosovës, është stopuar një tender në vlerë prej 5 milionë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas asaj që thotë Ibrahim Makolli, mund të them se Rregulloren e Punës së Kuvendit e interpreton Kryetari i Parlamentit.

(Ndërprerje e incizimit – pengesa teknike në incizim)

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës